Shërbim i lëvizshëm në sterë: Një stacion i lëvizshëm ndërmjet stacioneve bazë dhe stacioneve të lëvizshëm në sterë, ose ndërmjet stacioneve të lëvizshëm në sterë.

Shërbim i lëvizshëm tokësor në sterë: Një shërbim i lëvizshëm satelitor në të cilin stacionet e lëvizshme tokësore ndodhen në sterë.

Shërbim i lëvizshëm detar: Një shërbim ndërmjet stacioneve bregdetare dhe stacioneve të anijeve, ose ndërmjet stacioneve të anijeve, ose ndërmjet stacioneve që përdoren për komunikimet në bord. Në këtë shërbim mund të marrin pjesë edhe stacionet e anijeve të shpëtimit dhe stacionet e emërgjencës me tregim radiosinjalizues të pozicionit.

Shërbimi i lëvizshëm detar satelitor: Një shërbim i lëvizshëm satelitor në të cilin stacionet e lëvizshëm tokësore ndodhen në bordin e anijeve. Në këtë shërbim mund të marrin pjesë edhe anijet e shërbimit dhe stacionet e emergjencës me tregim radiosinjalizues të pozicionit.

Shërbimi i lëvizshëm aeronautik: Një shërbim i lëvizshëm ndërmjet stacioneve aeronautike dhe stacioneve të avionave, ose ndërmjet stacioneve të avionave, në të cilin bëjnë pjesë stacionet e avionave të shpëtimit. Për frekuencat e përcaktuara për fatkeqësi dhe emergjencë, në këtë shërbim mund të marrin pjesë edhe stacionet e emergjencës me tregim radiosinjalizues të pozicionit.

Shërbimi i lëvizshëm aeronautik (R)*: Një shërbim i lëvizshëm aeronautik i rezervuar për komunikimet që lidhen me sigurinë dhe drejtimin e fluturimeve, kryesisht përgjatë korridoreve ajrore civile kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shërbimi i lëvizshëm aeronautik (OR**): Një shërbim i lëvizshëm aeronautik për komunikacionet, përfshirë ato të lidhura me koordinimin e fluturimeve, kryesisht jashtë korridoreve ajrore civile kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shërbimi i lëvizshëm aeronautik satelitor: Një shërbim i lëvizshëm satelitor në të cilin stacionet e lëvizshme tokësore ndodhen në bordin e avionave. Në këtë shërbim mund të marrin pjesë edhe stacionet e emergjencës me tregim radiosinjalizues të pozicionit.

Shërbimi i lëvizshëm aeronautik satelitor (R)[1]: Një shërbim i lëvizshëm aeronautik satelitor i rezervuar për komunikimet që lidhen me sigurinë dhe drejtimin e fluturimeve, kryesisht përgjatë korridoreve ajrore civile kombëtare dhe ndërkombëtare.

Shërbimi i lëvizshëm aeronautik satelitor (OR)[2]: Një shërbim i lëvizshëm aeronautik satelitor për komunikacionet, përfshirë ato të lidhura me koordinimin e fluturimeve, kryesishtjashtë korridoreve ajrore civile kombëtare dhe ndërkombëtare.***Shërbimi radioteleviziv:*** Një shërbim radiokomunikacioni në të cilin transmetimet janë të dëstinuara për marrjen e drejtpërdrejtë të

[1] (R): route - korridor
[2] (OR): off-route –jashtë korridori

tyre nga publiku i gjerë. Ky shërbim mund të përfshijë transmetimet audio, transmetimet televizive dhe lloje të tjera transmetimi.

Shërbimi radioteleviziv satelitor: Një shërbim radiokomunikacioni në të cilin sinjalet e transmetuara ose të ritransmetuara nga stacionet hapësinore janë të destinuara për marrjen e drejtpërdrejtë nga publiku i gjerë. Në shërbimin radioteleviziv satelitor, termi "marrje e drejtpërdrejtë" përmbledh marrjen individule dhe marrjen në komunitet.

Shërbimi i radiopërcaktimit: Një shërbim radiokomunikacioni për qëllime radiopërcaktimi.

Shërbimi i radiopërcaktimit satelitor: Një shërbim radiokomunikacioni për qëllime radiopërcaktimi që përdor një ose më shumë stacione hapësinore. Ky shërbim mund të përfshijë gjithashtu lidhjet fider, të nevojshme për operimin e tij.

Shërbimi i radionavigacionit: Një shërbim radiopërcaktimi për qëllime radionavigacioni.

Shërbimi i radionavigacionit satelitor: Një shërbim radiopërcaktimi satelitor që përdoret për qëllime radionavigacioni. Ky shërbim mund të përfshijë gjithashtu lidhjet fider të nevojshme për operimin e tij.

Shërbimi i radionavigacionit detar: Një shërbim radionavigacioni i denstinuar për të ndihmuar dhe siguruar operimin e anijeve.

Shërbimi i radionavigacionit detar satelitor: Një shërbim radionavigacioni satelitor në të cilin stacionet tokësore ndodhen në bordin e anijeve.

Shërbimi i radionavigacionit aeronautik: Një shërbim radionavigacioni i denstinuar për të ndihmuar dhe siguruar operimin e avionave.

Shërbimi i radionavigacionit aeronautik satelitor: Një shërbim radionavigacioni në të cilin stacionet tokësore ndodhen në bordin e avionave.

Shërbimi i radiovendndodhjes: Një shërbim radiopërcaktimi për qëllime radiovendndodhje.

Shërbimi i ndihmës meteorologjike: Një shërbim që përdoret për vëzhgimet dhe ekplorimet meteorologjike, përfshirë dhe ato hidrologjike.

Shërbimi i eksplorimit tokësor satelitor: Një shërbim radiokomunikacioni ndërmjetstacioneve tokësore dhe një ose më shumë stacioneve hapësinore, ku mund të përfshihen dhe lidhjet ndërmjet stacioneve hapësinore, në të cilin:

- nga sensorët aktivë ose pasivë në satelitët e Tokës përfitohet informacion në lidhje me karakteristikat e Tokës dhe fenomeneve natyrore në të, përfshirë të dhëna mbi gjendjen e mjedisit;
- informacion i ngjashëm mblidhet nga bordet ajrore ose platformat me bazë tokësore;
- një informacion i tillë mund t'u shpërndahet stacioneve tokësore të sistemit në fjalë;
- mund të përfshihet dhe kërkimi i platformave.

Në këtë shërbim mund të përfshihen gjithashtu lidhjet fider të nevojshme për operimin e tij.

Shërbimi meteorologjik satelitor: Një shërbim i eksplorimit të tokës me satelit për qëllime meteorologjike.

Shërbimi frekuencë standarde dhe sinjale kohore: Një shërbim radiokomunikacioni për qëllime shkencore, teknike dhe të tjera, që siguron transmetimin e frekuencave specifike, sinjaleve kohore, ose të dyja, me saktësi të lartë dhe të destinuara për marrje masive.

Shërbimi frekuencë standarde dhe sinjale kohore me satelit: Një shërbim radiokomunikacioni që përdor stacionet hapësinore dhe stacionet e Tokës me qëllim të njëjtë me atë të shërbimit frekuencë standarde dhe sinjale kohore. Në këtë shërbim mund të përfshihen gjithashtu lidhjet fider të nevojshme për operimin e tij.

Shërbimi i kërkimeve hapësinore: Një shërbim radiokomunikacioni në të cilin anijet kozmike ose objekte të tjera në hapësirë përdoren për kërkime shkencore ose teknologjike.

Shërbimi amator: Një shërbim radiokomunikacioni për qëllime vetë trajnimi, ndërlidhje dhe vëzhgime teknike të bëra nga amatorët, domethënë nga personat e autorizuar, të interesuar në teknikat radio, vetëm për qëllime personale dhe jo për interesa fitimprurëse.

Shërbimi amator me satelit: Një shërbim radiokomunikacioni që përdor stacionet hapësinore në statelitët e Tokës për qëllime të njëjta me ato të shërbimit amator.

Shërbimi i radioastronomisë: Një shërbim i destinuar për radioastronominë.

4. KATEGORITË E SHËRBIMEVE DHE PËRCAKTIMEVE

Shërbimet PARËSORE ose dytësore: Në Planin Kombëtar të Radiofrekuencave shërbimet parësore janë shtypur me gërma të mëdha, shërbimet dytësore janë shtypur me gërma të vogla.

Stacionet e një shërbimi dytësor:

a) nuk duhet të shkaktojnë intereferenca të dëmshme tek stacionet e shërbimeve parësore, të cilave u janë dhënë frekuencat ose do t'u jepen më vonë;

b) nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga intereferencat e dëmshme prej stacioneve të një shërbimi parësor, të cilit tashmë frekuencat i janë dhënë ose do t'i jepen më vonë;

c) megjithatë, mund të kërkojnë mbrojtje nga interferencat e dëmshme prej stacioneve të shërbimit të njëjtë dytësor ose shërbimeve të tjera dytësore, të cilëve tashmë frekuencat u janë dhënë ose do t'u jepen më vonë;

Kur një brez tregohet në një shënim të tabelës si përcaktim për një shërbim "në bazëdytësore", në një sipërfaqe më të vogël se një rajon, apo në një vend të caktuar, ky është një shërbim dytësor.
Kur një brez tregohet në një shënim të tabelës si përcaktim për një shërbim "në bazëparësore", në një sipërfaqe më të vogël se një rajon, apo në një vend të caktuar, ky është një shërbim parrësor vetëm për këtë zonë ose vend.

Përcaktime shtesë

- Kur një brez tregohet në një shënim të tabelës si "gjithashtu e përcaktuar" për një shërbim në një sipërfaqe më të vogël se një rajon, apo në një vend të caktuar, ky është një përcaktim shtesë psh. një përcaktim i cili është shtuar në këtë zonë ose vend tek shërbimi ose shërbimet të cilat tregohen në tabelë.
  Në qoftë se shënimi nuk përfshin ndonjë kufizim në shërbim ose shërbimet në fjalë përveç kufizimit të veprimit vetëm në një fushë të veçantë ose vend, stacionet e këtij shërbimi apo këtyre shërbimeve do të kenë barazi të drejtën për të operuar me stacionet e shërbimit tjetër parësor ose shërbimeve të treguar në tabelën.

- Në qoftë se kufizime janë vendosur në një përcaktim shtesë përveç kufizimit që vepron vetëm në një fushë të veçantë ose vend, kjo tregohet në shënimin e tabelës.

Përcaktime alternative

- Kur një brez tregohet në një shënim të tabelës si "e përcaktuar" për një shërbim në një sipërfaqe më të vogël se një rajon, apo në një vend të caktuar, ky është një përcaktim alternativ psh. një përcaktim i cili e zëvendëson në këtë zonë ose vend tek shërbimi ose shërbimet të cilat tregohen në tabelë.

- Në qoftë se shënimi nuk përfshin ndonjë kufizim në stacionet e shërbimit ose shërbimeve në fjalë, pavarësisht nga kufizimi për të vepruar vetëm në një fushë të veçantë ose vend, këto stacione të një shërbimi ose shërbimeve të tilla do të kenë një barazi të së drejtës për të operuar me stacionet e shërbimit parësor apo shërbimeve, të treguara në tabelën, të cilat grupi është ndarë në zona të tjera apo vende.

- Në qoftë se kufizimet janë vendosur në stacionet e shërbimit në të cilën një përcaktim alternative është bërë, përveç kufizimit që vepron vetëm në një vend të caktuar apo zonë, kjo tregohet në shënim.

Dispozita të ndryshme

- Kur është e treguar në këtë Rregullore se shërbimi ose stacionet në një shërbim të mund të veprojnë në një subjekt të veçantë të brezit frekuencor për të mos shkaktuar interferenca të dëmshme në një tjetër shërbim, ose në një tjetër stacion në të njëjtin shërbim, kjo do të thotë gjithashtu se shërbimi i cili është subjekt të mos shkaktojë interferenca të dëmshme nuk mund të kërkojë mbrojtje nga interferencat e dëmshme shkaktuar nga shërbimi tjetër ose stacion tjetër në të njëjtin shërbim.

- Kur është e treguar në këtë Rregullore se shërbimi ose stacionet në një shërbim të mund të veprojnë në një subjekt të veçantë të brezit frekuencor të mos kërkojë mbrojtje nga një shërbim tjetër ose nga një stacion në të njëjtin shërbim, kjo do të thotë gjithashtu se shërbimi i cili është subjekt i mos kërkesës së mbrojtjes nuk duhet t'i shkaktojnë interferencë të dëmshme shërbimit tjetër ose stacionit tjetër në të njëjtin shërbim.

- Me përjashtim nëse është përcaktuar ndryshe në një shënim, termi "shërbim fiks", i paraqitur në Pjesën IV të këtij neni, nuk do të përfshijnë sistemet që përdorin përhapjen e shpërhapjes jonosferike.

5. STACIONET DHE SISTEMET RADIO

Stacion: Një ose disa transmetues ose marrës, ose një kombinim i transmetuesve dhe marrësve, përfshirë pajisjet ndihmëse, të nevojshme në një pozicion për të kryer një shërbim radiokomunikacioni, ose shërbim radioastronomie.
Çdo stacion duhet të klasifikohet në shërbimin në të cilin ai operon përgjithnjë ose përkohësisht.

Stacion tokësor: Një stacion për realizimin e radiokomunikacionit tokësor. Në këto përcaktime, me përjashtim të atyre të përmendura, çdo stacion është një stacion tokësor.

Stacion tokësor për ndihmat meteorologjike: Një stacion në shërbimin e ndihmave meteorologjike, për qëllime përdorimi kur nuk është në lëvizje.

Stacion i lëvizshëm për ndihmat meteorologjike: Një stacion në shërbimin e ndihmave meteorologjike, për qëllime përdorimi kur është në lëvizje ose gjatë ndalesave në pika të paspecifikuara.

Stacion në Tokë: Një stacion i vendosur ose në sipërfaqen e Tokës ose brenda shtresës dërrmuese të atmosferës së Tokës me synim komunikimin:

- me një ose më shumë stacione hapësinore; ose

- me një ose më shumë stacione të të njëjtit lloj nëpërmjet një ose më shumë satelitëve pasqyrues ose objekteve të tjera në hapësirë.

Stacion hapësinor: Një stacion i ndodhur në një objekt që është përtej, synohet të hidhet përtej, ose ka qënë përtej, shtresës dërrmuese të atmosferës së Tokës.

Stacion i anijeve të shpëtimit: Një stacion i lëvizshëm në shërbimin e lëvizshëm detar ose në shërbimin e lëvizshëm aeronautik i rezervuar vetëm për qëllime sigurie dhe i vendosur në një anije shpëtimi, avion shpëtimi ose në mjete të tjera shpëtimi.

Stacion fiks: Një stacion në shërbimin fiks.

Stacion i lëvizshëm: Një stacion në shërbimin e lëvizshëm me synim për t'u përdorur në lëvizje ose gjatë ndalesave në pozicione të papërcaktuara.

Stacion i lëvizshëm tokësor: Një stacion tokësor në shërbimin e lëvizshëm satelitor me synim për t'u përdorur kur është në lëvizje ose gjatë ndalesave në pozicione të papërcaktuara.
Stacion në sterë: Një stacion në shërbimin e lëvizshëm që nuk përdoret kur është në lëvizje.

Stacion tokësor në sterë: Një stacion në shërbimin fiks satelitor ose, në disa raste, nëshërbimin e lëvizshëm satelior, i vendosur në një pikë të përcaktuar fikse ose brenda një zone të përcaktuar në sterë për të ofruar një lidhje fider për shërbimin e lëvizshëm satelitor.

Stacion bazë: Një stacion në sterë për shërbimin e lëvizshëm në sterë.

Stacion bazë tokësor: Një stacion tokësor në shërbimin fiks satelitor ose, në disa raste, në shërbimin e lëvizshëm satelitor në sterë, i vendosur në një pikë fikse të përcaktuar ose brendanjë zone të përcaktuar në sterë për të ofruar një lidhje fider për shërbimin e lëvizshëm satelitor në sterë.

Stacion i lëvizshëm në sterë: Një stacion i lëvizshëm për shërbimin e lëvizshëm në sterë, që lëviz në sipërfaqe brenda kufive gjeorgafikë të një shteti ose kontinenti.

Stacion i lëvizshëm tokësor në sterë: Një stacion i lëvizshëm në shërbimin e lëvizshëm satelitor në sterë, që lëviz në sipërfaqe brenda kufijve gjeografike të një shteti ose kontinenti.

Stacion bregdetar: Një stacion në sterë për shërbimin e lëvizshëm detar.

Stacion tokësor bregdetar: Një stacion tokësor në shërbimin fiks satelitor ose, në disa raste, në shërbimin e lëvizshëm detar me satelit, i vendosur në një pikë fikse në sterë për të siguruarnjë lidhje fider për shërbimin e lëvizshëm detar me satelit.

Stacion anije: Një stacion i lëvizshëm në shërbimin e lëvizshëm detar i vendosur në bordin e një anije, që nuk është e ankoruar përgjithmonë, i ndryshëm nga një stacion anije shpëtimi.

Stacion tokësor anije: Një stacion i lëvizshëm tokësor në shërbimin e lëvizshëm detar me satelit, i vendosur në bordin e një anije.

Stacion aeronautik: Një stacion tokësorë në sterë për shërbimin e lëvizshëm aeronautik. Në raste të caktuara, një stacion aeronautik mund të vendoset, për shembull, në bordin e një anije ose në një platformë mbi det.

Stacion aeronautik tokësor: Një stacion tokësor në shërbimin fiks satelitor, ose, në disa raste, në shërbimin e lëvishëm aeronautik me satelit, i vendosur në një pikë fikse të përcaktuar në sterë për të siguruar një lidhje fider për shërbimin e lëvizshëm aeronautik me satelit.

Stacion avioni: Një stacion i lëvizshëm në shërbimin e lëvizshëm aeronautik, i ndryshëm nga një stacion në avion shpëtimi, i vendosur në bordin e një avioni.

Stacion tokësor avioni: Një stacion i lëvizshëm tokësor në shërbimin e lëvizshëm aeronautik me satelit i vendosur në bordin e një avioni.

Stacion radiopërcaktimi: Një stacion në shërbimin e radiopërcaktimit.

Stacion i lëvizshëm radionavigacioni: Një stacion në shërbimin e radionavigacionit me destinacion për t'u përdorur kur është në lëvizje ose gjatë ndalesave në pozicione të papërcaktuara.

Stacion radionavigacioni në sterë: Një stacion në shërbimin e radionavigacionit me destinacion për të mos u përdorur kur është në lëvizje.

Stacion i lëvizshëm radiovendndodhje: Një stacion në shërbimin e radiovendndodhjes me destinacion për t'u përdorur kur është në lëvizje ose gjatë ndalesave në pozicione të papërcaktuara.

Stacion tokësor radiovendndodhje: Një stacion në shërbimin e radiovendndodhjes me destinacion për të mos u përdorur kur është në lëvizje.

Stacion radio gjetje–drejtimi: Një stacion radiopërcaktimi që përdor radio gjetje–drejtimin.

Stacion* radiosinjalizimi:*** Një stacion në shërbimin e radionavigacionit emisionet e të cilit destinohen për t'i mundësuar një stacioni të lëvizshëm të përcaktojë prezencën ose drejtimin e tij kundrejt stacionit radiosinjalizues.

Stacion i emergjencës me tregim radiosinjalizues të pozicionit: Një stacion në shërbimin e lëvizshëm emisionet e të cilit synojnë të mundësojnë operacionet e kërkimit dhe shpëtimit.

Stacion satelitor i emergjencës me tregim radiosinjalizues të pozicionit: Një stacion tokësor në shërbimin e lëvizshëm satelitor emisionet e të cilit synojnë të mundësojnë operacionet e kërkimit dhe shpëtimit.

Stacion i frekuencës standarde dhe sinjal kohor: një stacion në shërbimin e frekuencës standarde dhe sinjalit kohor.

Stacion amator: Një stacion në shërbimin amator.

Stacion radioteleviziv: Një stacion në shërbimin e radiotelevizionit.

Stacion radioastronomie: Një stacion në shërbimin e radioastronomisë.

6. BASHKËPËRDORIMI I FREKUENCAVE

Interferencë: Efekti i energjisë së padëshiruar për shkak të një apo një kombinimi të *emetimeve, rrezatimeve* ose induktimeve në marrje në një sistem të *radiokomunikacionit*, manifestuar nga çdo degradim i performancës, keqinterpretim, ose humbje e informacionit të cilat mund të eleminohen në mungesë të një energjie të tillë të padëshiruar.

Interferencë e lejuar: Interferencat e vëzhguara ose parashikuara të cilat janë në Pajtim me interferencat e matshme dhe kriteret e bashkëpërdorimit të përcaktuara në Rregulloret Radio ose Rekomandimet e ITU-R ose në marrëveshje të veçanta siç parashikohet në Rregulloret Radio.

Interferencë e pranuar: Interferencat në një nivel më të lartë se ai i përcaktuar si interferencë e lejuar dhe që për të cilën është rënë dakord midis dy ose më shumë administrative pa rënë ndesh me administratat e tjera.

Interferencë e dëmshme: Interferenca e cila rrezikon funksionimin e një shërbimi të radionavigacionit ose shërbime të tjera të sigurisë ose degradon seriozisht, pengon, ose në mënyrë të përsëritur ndërpret një shërbim të radiokomunikimit që operon në përputhje me Rregulloret Radio (CS).

Raporti i mbrojtjes (R.F.): Vlera minimale e raportit të sinjalit të dëshiruar-i padëshiruar në marrje, zakonisht i shprehur në decibël, percaktuar në kushte të caktuara të tilla që një kualitet i specifikuar në marrje i një sinjali të dëshiruar është arritur në dalje të marrësit.

Zona e koordinimit: Kur është përcaktuar nevoja për koordinim, zona që rrethon një stacion tokësor që bashkëpërdor të njëjtin brez frekuence me stacionet tokësore, ose rrethon njëstacion transmetues tokësor që bashkëpërdor të njëjtin brez të frekuencave bidireksionale me stacionet marrëse tokësore, përtej të cilit niveli i interferencës së lejuar nuk do të tejkalohet dhe koordinimi për këtë arsye nuk është i nevojshem. (WRC-2000).

Konturet e koordinimit: Vijat që kufizojnë zonën e koordinimit.

Koordinimi në distancë: Kur përcaktohet nevoja për koordinim, distanca në një azimuth të dhënë nga një stacion tokësor që bashkëpërdor të njëjtin brez frekuence me stacionet tokësore, ose nga një stacion tokësor transmetues që bashkëpërdor të njëjtën brez të përcaktuar frekuencash bidireksionale me stacionet marrëse tokësore, përtej të cilit niveli i interferencave të lejuara nuk do të tejkalohet dhe koordinimi për këtë arsye nuk është e nevojshme (WRC-2000).

7. SHQIPËRIA PJESË E RAJONIT 1 TË ITU-së

Për ndarjen e frekuencave bota është e ndarë në tre Rajone, siç tregohet në hartën e mëposhtme.



Shënojmë se kur fjalët "rajone" ose "rajonale" janë pa kapital "R", ato nuk nënkuptojnë tri Rajonet si në hartën më sipër.

Rajoni 1: Rajoni 1, përfshin zonën e kufizuar në lindje nga linja A dhe në perëndim nga linja B, duke përjashtuar çdo territor të Republikës Islamike të Iranit i cili shtrihet ndërmjet këtyre kufijve. Ajo gjithashtu përfshin gjithë territorin e Armenisë, Azerbajxhanit, Federatës Ruse,

Gjeorgjisë, Kazakistanit, Mongolisë, Uzbekistanit, Kirgistanit, Taxhikistanit, Turkmenistanit, Turqisë dhe Ukrainës si dhe zonën në veri të Federatës Ruse e cila shtrihet ndërmjet linjave A dhe C.

Rajoni 2: Rajoni 2 përfshin zonën e kufizuar në lindje nga linja B dhe në perëndim nga linja C.

Rajoni 3: Rajoni 3 përfshin zonën e kufizuar në lindje nga linja C dhe në perëndim nga linjë A, me përjashtim të ndonjë territori si Armeni, Azerbajxhan, Federatën Ruse, Gjeorgji, Kazakistani, Mongolia, Uzbekistan, Kirgistan, Taxhikistan, Turkmenistan, Turqi dhe Ukrainë dhe zona në veri të Federatës Ruse. Ajo gjithashtu përfshin atë pjesë të territorit të Republikës Islamike të Iranit lënë jashtë këtyre kufijve.

SHTOJCA 2

SHËNIMET E RREGULLOREVE RADIO TË BASHKIMIT NDËRKOMBËTAR TË TELEKOMUNIKACIONEVE (ITU)

5.53 Administratat që autorizojnë përdorimin e frekuencave poshtë 8.3 kHz duhet të sigurojnë që ato të mos shkaktojnë interferencë të dëmshme për shërbimet e përcaktuara në frekuencat mbi 8.3 kHz. (WRC– 12).

5.54 Administratave që kryejnë kërkime shkencore duke përdorur frekuenca poshtë 8.3 kHz u kërkohet të njoftojnë administratat e tjera të cilat mund të jenë të shqetësuara, në mënyrë që këtyre kërkimeve t'u ofrohen të gjitha mbrojtjet e mundshme nga interferencat e dëmshme. (WRC– 12).

5.54A Përdorimi i brezit të frekuencave 8.3–11.3 kHz nga stacionet për shërbimet e ndihmës meteorologjike është i kufizuar vetëm në përdorimin pasiv. Në brezin 9–11.3 kHz, stacionet e ndihmës meteorologjike nuk do të pretendojnë mbrojtje nga stacionet e shërbimit të radionavigimit paraqitur për njoftim në Zyrë para 1 Janarit 2013. Për ndarjen midis stacioneve të shërbimeve të ndihmës meteorologjike dhe stacioneve për shërbimin e radionavigimit paraqitur për njoftim pas kësaj date, do të zbatohet versioni më i fundit i Rekomandimit ITU R RS.1881. (WRC–12).

5.54B *Përcaktim shtesë:* në Algjeri, Arabi Saudite, Bahrain, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Federatën Ruse, Iran (Republika Islamike e), Irak, Kuvait, Liban, Marok, Katar, Republikën Siriane Arabe, Sudan dhe Tunizi, brezi i frekuencave 8.3–9 kHz përcaktohet gjithashtu për radionavigim, shërbime fikse dhe të lëvizshme në bazë parësore. (WRC– 15).

5.54C *Përcaktim shtesë*: në Kinë, brezi i frekuencave 8.3–9 kHz përcaktohet gjithashtu për shërbimin e radionavigimit detar dhe shërbimin e lëvizshëm detar në bazë parësore.

5.55 *Përcaktim shtesë:* në Armeni, Federatën Ruse, Gjeorgji, Kirgistan, Taxhikistan, Turkmenistan, brezi 14–17 kHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e radionavigacionit. (WRC– 15)

5.56 Stacionet e shërbimeve që punojnë në brezat 14–19.95 kHz dhe 20.05–70 kHz dhe në Rajonin 1 gjithashtu në brezat 72–84 kHz and 86–90 kHz mund të transmetojnë frekuenca standarte dhe sinjale kohore. Stacione të tilla duhet të jenë në gjëndje të mbrohen nga interferencat e dëmshme. Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Federaten Ruse, Gjeorgji, , Kirgistan, Taxhikistan dhe Turkmenistan, frekuencat 25 kHz dhe 50 kHz do të përdoren për këtë qëllim nën të njëjtat kushte. (WRC–23

5.57 Përdorimi i brezave 14–19.95 kHz, 20.05–70 KHz dhe 70–90 kHz (72–84 kHz dhe 86–90 kHz në Rajonin 1) nga shërbimi i lëvizshëm detar është i rezervuar për stacionet radiotelegrafike bregdetare (vetëm AlA dhe FIB). Veçanërisht, përdorimi i emëtimeve të klasës J2B ose J7B është subjekt autorizimi për brezat e nevojshëm, që zakonisht nuk janë më të mëdha se ato të emetimeve të klasës AlA dhe F1B në brezat në fjalë.

5.58 *Përcaktim shtesë*: Në Armeni, Azerbajxhan, Federatën Ruse, Gjeorgji, Kirgistan, Taxhikistan dhe Turkmenistan, brezi i frekuencave 67–70 kHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e radionavigacionit. (WRC–23).

5.60 Në brezat 70–90 kHz (70–86 kHz në Rajonin 1) dhe 110–130 kHz (112–130 kHz në Rajonin1) sistemet impulsive të radionavigacionit mund të përdoren në kushtet e mos shkaktimit të interferencës së dëmshme në shërbimet e tjera të përcaktuara në këto breza.

5.62 Administratat të cilat vënë në veprim stacionet në shërbimet e radionavigacionit në brezat 90 – 110 kHz janë të detyruara të koordinojnë karakteristikat teknike dhe operuese në mënyrë të tillë që të pengojnë interferencat e dëmshme për shërbimet e ofruara nga këto stacione.

5.64 Vetëm klasat e emetimeve AlA dhe F1B, A2C, A3C, F1C ose F3C janë autorizuar për stacionet e shërbimit fiks në brezat e përcaktuar për këtë shërbim përmes 90 kHz dhe 160 kHz (148.5 kHz në Rajonin 1) dhe për stacionet e shërbimit të lëvizshëm detar në brezat e përcaktuar për këtë shërbim përmes 110 kHz dhe 160 kHz (148.5 kHz në Rajonin 1). Veçanërisht emetimet e klasës J2B ose J7B janë gjithashtu të autorizuara në brezat përmes 110 kHz dhe 160 kHz (148.5 kHz në Rajonin 1) për stacionet e shërbimit të lëvizshëm detar.

5.66 *Kategori të ndryshme shërbimi:* Në Gjermani, përcaktimi i brezit 115–117.6 kHz për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm detar është në bazë parësore (shiko Nr. 5.33) dhe shërbimin e radionavigacionit në bazë dytësore (shiko Nr.5.32).

5.67 *Përcaktim shtesë:* Në Kirgistan dhe Turkmenistan brezi 130–148.5 kHz është gjithashtu i përcaktuar në një bazë dytësore për shërbimin e radionavigacionit. Brenda dhe ndërmjet këtyre vendeve ky shërbim duhet të ketë të drejtë të barabartë për operim. (WRC–19).

5.67A Stacionet në shërbimin amator të cilët përdorin frekuencat në brezat 135.7–137.8 kHz nuk duhet të tejkalojnë fuqinë maksimale të rrezatuar prej 1W (e.i.r.p) dhe nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme në stacionet e shërbimit të radionavigacionit që operojnë në vendet e listuara në shënimin 5.67. (WRC–07).

5.67B Përdorimi i brezit 135.7–137.8 kHz në Algjeri, Egjipt, Irak, Libi, Republika Islamike e Sirisë, Sudan dhe Tunizi është i kufizuar në shërbimet fiks dhe shërbimet e lëvizshme detare. Shërbimet amatore nuk do të përdoren në brezin 135.7–137.8 kHz në vendet e lartpërmendur si dhe kjo duhet të merret në konsideratë nga vendet që autorizojnë përdorime të tilla. (WRC–19).

5.68 *Përcaktim alternativ:* Në Kongo (Republika e), Republika Demokratike e Kongos dhe Afrikë Jugore, brezi i frekuencave 160–200 kHz është përcaktuar për përdorim parësorë për sherbimet fikse (WRC–15).

5.69 *Përcaktim shtesë:* Në Somali, brezi i frekuencave 200–255 kHz është i përcaktuar gjithashtu për përdorim parësorë për shërbimin e radionavigacionit aeronautik.

5.70 *Përcaktim alternativ:* në Angola, Botsvanë, Burundi, Republika Qendrore e Afrikës, Kongo (Rep e), Esuatini, Etiopi, Kenia, Lesoto, Madagaskar, Malaui, Mozambik, Namibia, Nigeri, Oman, Republika Demokratike e Kongos, Afrika

Jugore, Tanzani, Çad, Zambia dhe Zimbabve, brezi 200–283.5 kHz është i përcaktuar për përdorim parësorë, për shërbimin e radionavigacionit aeronautik (WRC–19).

5.73 Në brezin 285–325 kHz (283.5–325 kHz në Rajonin 1), në shërbimet e radionavigacionit detar, stacionet e radioradarëve mund të transmetojnë gjithashtu informacione shtesë duke përdorur teknikat e brezit të ngushtë, me kusht që të mos shkaktohet asnjë ndërhyrje e dëmshme në stacionet e radioradarëve që operojnë në shërbimin e radionavigacionit (WRC–97).

5.74 *Përcaktim shtesë:* Në Rajonin 1, brezi i frekuencave 285.3–285.7 kHz është gjithashtu i përcaktuar në një bazë parësore për shërbimet e radionavigacionit detar (përveç radioradarëve).

5.75 *Kategori të ndryshme shërbimi:* Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Gjeorgji, Moldavi, Kirgizstan, Federaten Ruse, Taxhikistan, Turkmenistan, Ukraine dhe pjesa Rumune e Detit te Zi, brezi 315–325 kHz është i përcaktuar në një bazë parësore për shërbimin e radionavigacionit detar, me kushte që në hapësirën e Detit Balltik, dhënia e frekuencave në këtë brez stacioneve të reja për shërbimin detar ose radionavigacionit aeronautikduhet të jetë objekt i konsultimeve ndërmjet administratave përkatëse (WRC–07).

5.76 Frekuenca 410 kHz është përcaktuar për radio gjetje–drejtim në shërbimin e radionavigacionit detar. Shërbimet e tjera të radionavigacionit që punojnë në 405– 415 kHz nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme ndaj radio gjetje–drejtim në brezin 406.5–413.5 kHz.

5.77 *Kategori të ndryshme shërbimi*: në Australi, Kinë, komunitetet franceze ndërdetare të Rajonit 3, Korea (Rep e), Indi, Irani (Republika Islamike e), Japonia, Pakistani, Papua Guinea e Re, Republika Popullore Demokratike e Koresë dhe Sri Lanka, caktimi i brezit të frekuencës 415–495 kHz të shërbimit të radionavigacionit aeronautik është mbi baza parësore. Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Federata Ruse, Kazakistan, Letoni, Uzbekistan dhe Kirgistan, caktimi i brezit të frekuencës 435–495 kHz të shërbimit të radionavigacionit aeronautik është mbi baza parësore. Administratat në të gjitha vendet e lartpërmendura duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që stacionet e radionavigacionit aeronautik në brezin 435–495 kHz të mos shkaktojnë interferencë në marrje të stacioneve bregdetare gjatë transmetimeve nga stacionet e anijeve në frekuencat e përcaktuara për stacionet në anije mbi baza ndërkombëtare (WRC-19).

5.79 Përdorimi i brezave 415–495 kHz dhe 505–526.5 kHz nga shërbimi i lëvizshëm detar është i rezervuar për radiotelegrafi dhe mund të përdoret gjithashtu për sistemin NAVDAT në përputhje me versionin më të fundit të rekomandimit të ITU-R M.2010, duke iu nënshtruar marrëveshjes ndërmjet administratave të interesuara dhe të prekura. Stacionet transmetuese NAVDAT janë të limituara në stacionet bregdetare (WRC-19).

5.79A Kur të vendosen stacionet detare për shërbimin NAVTEX në frekuencat 490 kHz, 518 kHz dhe 4209.5 kHz, administratat rekomandohen që të koordinojnë karakteristikat operuese në përputhje me procedurat e Organizatës Internacionale Detare (IMO) (shiko Rezolutën 339 (Rev.WRC–97).

5.80 Në Rajonin 2, përdorimi i brezit të frekuencave 435–495 kHz nga shërbimi i radionavigacionit aeronautik është i kufizuar nga sinjalizuesit jo–të drejtuar duke mos implementuar transmetimet zë.

5.80A Fuqia e rrezatuar izotropike ekuivalente maksimale e stacioneve në shërbimin amator që përdorin frekuenca në brezin 472–479 kHz nuk duhet të kalojë 1 W. Administratat mund të rrisin këtë kufi të e.i.r.p. në 5 W në pjesë të territorit të tyre të cilat janë në një distancë mbi 800 km nga kufijtë e Algjerisë, Arabisë Saudite, Azerbajxhan, Bahrain, Bjellorusi, Kinë, Komoros, Xhibuti, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Federata Ruse, Iran (Republika Islamike e), Irak, Jordani, Kazakistan, Kuvajt, Liban, Libi, Marok, Mauritani, Oman, Uzbekistan, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Kirgistan, Somali, Sudan, Tunizi, Ukrainë dhe Jemen. Në këtë brez frekuencash, stacionet në shërbimin amator nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e shërbimit të radionavigacionit aeronautik (WRC–12).

5.80B Përdorimi i brezit të frekuencave 472–479 kHz në Algjeri, Arabi Saudite, Azerbajxhan, Bahrain, Bjellorusi, Kinë, Komoros, Xhibuti, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Federata Ruse, Irak, Jordani, Kazakistan, Kuvajt, Liban, Libi, Mauritani, Oman, Uzbekistan, Katar, Republika Arabe Siriane, Kirgistan, Somali, Sudan, Tunizi dhe Jemen është i kufizuar në shërbimet e lëvizshme detare dhe radionavigacion aeronautik. Shërbimi amator nuk duhet të përdoret në vendet e përmendura më sipër në këtë brez frekuencash dhe kjo duhet të merret parasysh nga vendet që autorizojnë një përdorim të tillë (WRC–12).

5.82 Në shërbimin e lëvizshëm detar, frekuenca 490 kHz do të përdoret ekskluzivisht për transmetim nga stacionet bregdetare të paralajmërimeve meteorologjike dhe të lundrimit dhe informacioneve urgjente për anijet, në kuptimin e telegrafisë direkte me brez të ngushtë. Kushtet për përdorimin e frekuencës 490 kHz përcaktohen në Nenet 31 dhe 52. Në përdorimin e brezit 415–495 kHz për shërbimin e radionavigacionit aeronautik, administratave u kërkohet të sigurojnë që të mos shkaktojnë interferencë të dëmshme në frekuencën 490 kHz. Në përdorimin e brezit të frekuencave 472–479 kHz për shërbimin amator, administratat duhet të sigurojnë që të mos shkaktohet interferencë e dëmshme në frekuencën 490 kHz (WRC– 12).

5.82C Brezi i frekuencave 495-505 kHz përdoret për sistemin ndërkombëtar NAVDAT siç përshkruhet më së shumti në versionin e fundit të Rekomandimit ITU-R M.2010. Stacionet transmetuese NAVDAT janë të kufizuara në sacionet bregdetare (WRC-19).

5.82D

Kur vendosen stacione bregdetare në sistemin NAVDAT në frekuencat 500 kHz dhe 4 226 kHz, kushtet për përdorimin e frekuencave 500 kHz dhe 4 226 kHz përshkruhen në Nenet 31 dhe 52. Administratat rekomandohen fuqimisht që të koordinojnë karakteristikat operuese të sistemeve NAVDAT në përputhje me procedurat e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO) (shih Rezolutën 364 (WRC-23)). (WRC – 23)

5.84 Kushtet për përdorimin e frekuencës 518 kHz nga shërbimi i lëvizshëm detar përshkruhen në Nenet 31 dhe 52. (WRC–07)

5.87 Përcaktim shtesë: Në Angola, Botzvanë, Esuatini, Lesoto, Malaui, Mozambik, Namibia dhe Nigeri, brezi i frekuencave 526.5–535 kHz është i përcaktuar gjithashtu për shërbimin e lëvizshëm për përdorim dytësor. (WRC-19)

5.87A Përcaktim shtesë*:* Në Uzbekistan, brezi i frekuencave 526.5–1606.5 kHz është i përcaktuar gjithashtu për shërbimin i radinavigacionit, për përdorim parësorë. Një përdorim i tillë është subjekt marrëveshjesh midis administrative të afektuara në përputhje me nenin 9.21 si dhe i kufizuar për radio sinjalizuesit

me bazë në tokë në operim nga data 27. Tetor 1997 deri në përfundim të funksionimit të tyre (WRC–97).

5.90 Në brezin 1605–1705 kHz, në rastet kur një stacion radioteleviziv i Rajonit 2 shqetësohet, hapësira e shërbimit të stacioneve të lëvizshme detare në Rajonin 1 duhet të kufizohet në atë mënyrë që ky shërbim të sigurohet nga përhapjet e valëve tokësore.

5.92 Disa vende të Rajonit 1 përdorin sisteme radio përcaktimi në brezat 1606.5–1625 kHz, 1635–1800 kHz, 1850–2160 kHz, 2194–2300 kHz, 2502–2850 kHz dhe 3500–3800 kHz, objekt i marrëveshjes së arritur në bazë të Nenit 9.21. Fuqia rrezatuese kryesore e këtyre stacioneve nuk duhet të tejkalojë vlerën 50 W.

5.93 Përcaktim shtesë: Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Federatën Ruse, Gjeorgji, Hungari, Kazakistan, Letoni, Lituani, Mongoli, Nigeri, Uzbekistan, Poloni, Kirgistan, Sllovaki, Taxhikistan, Çad, Turkmenistan dhe Ukrainë, brezat e frekuencave 1625–1635 kHz, 1800– 1810 kHz dhe 2160–2170 kHz janë përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin fiks dhe të lëvizshëm tokësor, objekt i marrëveshjes së arritur në bazë të Nr. 9.21. (WRC– 15).

5.96 Në Gjermani, Armeni, Austri, Azerbajxhan, Bjellorusi, Kroaci, Danimarkë, Estoni, Federatën Ruse, Finlandë, Gjeorgji, Hungari, Islandë, Irlandë, Izrael, Kazakistan, Letoni, Lihtenshtejn, Lituani, Maltë, Moldavi, Norvegji, Uzbekistan, Poloni, Kirgistan, Sllovaki, Republikën Çeke, Mbretëri e Bashkuar, Suedi, Zvicër, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Ukrainë, administratat mund të përcaktojnë deri në 200 kHz për shërbimin e tyre amatore në brezat e frekuencave 1715–1800 kHz dhe 1850–2000 kHz. Megjithatë, administratat kur përcaktojnë brezat e frekuencave brenda këtij diapazoni për shërbimet e tyre amatore, do të marrin të gjitha hapat e nevojshme për të shmangur interferencat e dëmshme nga shërbimet e tyre amatore në shërbimet fiks dhe të lëvizshëm të vendeve të tjera, pas konsultimeve paraprake me administratat e vendeve fqinje. Fuqia mesatare e çdo stacioni amator nuk duhet të kalojë 10 W. (WRC–15).

5.98 Përcaktim alternativ: Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Belgjikë, Kamerun, Kongo (Republika e), Danimarkë, , Eritrea, Spanjë, Etiopi, Federatën Ruse, Gjeorgji, Greqi, Itali, Kazakistan, Liban, Lituani, Republikën Arabe Siriane, Turqi, Kirgistan, Somali, Taxhikistan, Tunizi, dhe Turkmenistan brezi frekuencave 1810–1830 kHz është përcaktuar në një bazë parësore për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. (WRC– 23).

5.99 Përcaktim shtesë: Në Arabinë Saudite, Austri, Egjipt, Irak, Libi, Uzbekistan, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Çad, dhe Togo, brezi i frekuencave 1810–1830 kHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. (WRC–23).

5.100 Në Rajonin 1, autorizimi për përdorimin e brezit 1810–1830 kHz nga shërbimi amator në vendet e vendosura totalisht ose pjesërisht mbi paralelin 40° në veri duhet të jepet vetëm pas konsultimit me vendet e përmendura më sipër në Nr. 5.98 dhe 5.99 për të përcaktuar hapat e nevojshme që duhen marrë për të shmangur interferencën e dëmshme përmes stacioneve amatore dhe stacioneve të shërbimeve të tjera duke vepruar në përputhje me Nr. 5.98 dhe 5.99.

5.103 Në Rajonin 1, kur jepen frekuencat për stacionet e shërbimin fiks dhe të lëvizshëm në brezat 1850–2045 kHz, 2194–2498 kHz, 2502–2625 kHz dhe 2650–2850 kHz, administratat duhet të kenë parasysh kërkesat speciale të shërbimit të lëvizshëm detar.

5.104 Në Rajonin 1, përdorimi i brezit 2025–2045 kHz nga shërbimi i ndihmës meteorologjike është rezervuar për stacionet oqeano grafike mbiujore.

5.107 *Përcaktim shtesë*: Në Arabinë Saudite, Eritrea, Esuatini, Etiopi, Irak, Libi dhe Somali, brezi i frekuencave 2160–2170 kHz është i përcaktuar gjithashtu për shërbimet fiks, i lëvizshëm përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik (R) për përdorim parësor. Fuqia e stacioneve të këtyre shërbimeve nuk duhet të tejkaloj vlerën 50W. (WRC–19).

5.108 Frekuenca bartëse 2 182 kHz është një frekuencë ndërkombëtare për sinjale thirrje dhe fatkeqësie në radiotelefoni. Kushtet për përdorimin e brezit 2173.5–2190.5 kHz përshkruhen në Nenet 31dhe 52. (WRC–07).

5.109 Frekuencat 2187.5 kHz, 4207.5 kHz, 6312 kHz, 8414.5 kHz, 12577 kHz dhe 16804.5 kHz janë frekuenca ndërkombëtare për njoftime të fatkeqësive për thirrjen numerike selective. Kushtet për përdorimin e këtyre frekuencave përshkruhen në Nenin 31.

5.110 Frekuencat 2174.5 kHz, 4177.5 kHz, 6268 kHz, 8376.5 kHz, 12520 kHz dhe 16695 kHz përdoren për sistemin e lidhjes automatike (ACS), siç përshkruhet në versionin më të fundit të Rekomandimit ITU- R M.541. (WRC- 23)

5.111 Frekuencat bartëse 2182 kHz, 3023 kHz, 5680 kHz, 8364 kHz dhe frekuencat 121.5 MHz, 156.525 MHz, 156.8 MHz dhe 243 MHz mund të përdoren gjithashtu, në përputhje me procedurat në fuqi për shërbimet e radiokomunikimit tokësor, për veprimet e kërkimit dhe ndihmës në lidhje me mjetet hapësinore me komandim manual. Kushtet për përdorimin e frekuencave përshkruhen në Nenin 31. Të njëjtat aplikohen për frekuencat 10003 kHz, 14993 kHz dhe 19993 kHz, pra në secilin nga këto raste emetimet duhet të kufizohen në një brez ±3 kHz rreth frekuencës. (WRC–07).

5.112 *Përcaktim alternativ*: Në Sri Lanka brezi 2194–2300 kHz është përcaktuar në bazë parësore për shërbimin fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. (WRC– 19).

5.113 Për kushtet e përdorimit nga shërbimi radioteleviziv të brezave 2300–2495 kHz (2498 kHz në Rajonin 1), 3200–3400 kHz, 4750–4995 kHz dhe 5005–5060 kHz shih Nr. 5.16 deri në 5.20, 5.21 dhe 23.3 deri në 23.10.

5.114 *Përcaktim alternativ*: Në Irak brezi 2502–2625 kHz është përcaktuar në një bazë parësore për shërbimin fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. (WRC–19).

5.115 Frekuenca bartëse (referuese) 3023 kHz dhe 5680 kHz mund të përdoret gjithashtu në përputhje me Nenin 31, nga stacionet e shërbimit të lëvizshëm detar, në koordinim me operimet e kërkimit dhe ndihmës. (WRC–07).

5.116 Administratat janë të detyruara të autorizojnë përdorimin e brezit 3155–3195 kHz për sigurimin e kanaleve të përbashkëta në rang botëror për aparatet e dëgjimit pa tela me fuqi të vogël. Për t'iu përshtatur nevojave lokale, kanalet shtesë për këtë ndarje mund të caktohen nga administratat në brezat ndërmjet 3155 kHz dhe 3400 kHz. Duhet shënuar që frekuencat në shkallën 3000 kHz

deri 4000 kHz janë të përshtatshme për aparate dëgjimi të cilat janë vendosur të veprojnë në distanca të shkurtra brenda fushës së induksionit.

5.117 *Përcaktim alternativ*: Në , Liberi, Sri Lanka dhe Togo, brezi i frekuencave 3155–3200 kHz është përcaktuar në bazë parësore për shërbimin fiks dhe të lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. (WRC– 23).

5.123 *Përcaktim shtesë*: Në Botsvanë, Esuatini, Lesoto, Malaui, Mozambik, Namibia, Afrika Jugore, Zambia dhe Zimbabve, brezi i frekuencave 3900–3950 kHz është gjithashtu i përcaktuar për shërbimin radioteleviziv, për përdorim parësor, subjekt marrëveshjesh të siguruara në përputhje me neni 9.21. (WRC-19).

5.125 *Përcaktim shtesë*: Në Groenlandë, brezi 3950–4000 kHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin radioteleviziv. Fuqia e stacioneve radioteleviziv që veprojnë në këtë brez nuk duhet të tejkalojë vlerën e mjaftueshme për një shërbim nacional dhe në asnjë rast nuk duhet të tejkalojë 5 kW.

5.127 Përdorimi i brezit 4000–4063 kHz nga shërbimi i lëvizshëm detar është kufizuar për stacionet e anijeve që përdorin radiotelefoninë (shih Nr. 52.220 dhe Shtojcën 17).

5.128 Frekuencat në brezat 4063–4123 kHz and 4130–4438 kHz mund të përdoren në mënyrë të veçant nga stacionet në shërbimin fiks, duke komunikuar vetëm brenda kufirit të vendit në të cilin ndodhet, me një fuqi mesatare që nuk kalon 50W, me kusht që të mos shkaktohen interferenca të dëmshme në shërbimin e lëvizshëm detar. Përveç kësaj, në Afganistan, Argjentinë, Armeni, Bjellorusi, Botsvanë, Burkina Faso, Republika e Afrikës Qendrore, Kinë, Federata Ruse, Gjeorgji, Indi, Kazakistan, Mali, Nigeri, Pakistan, Kirgistan, Taxhikistan, Çad, Turkmenistan dhe Ukrainë, në brezat 4063–4123, 4130–4133 kHz dhe 4408–4438 kHz, stacionet në shërbimin fiks me fuqi mesatare që nuk e kalon 1 kW, mund të operojnë në kushte që të jenë vendosur të paktën 600 km larg nga bregu dhe të mos shkaktojnë interferenca të dëmshme në shërbimin e lëvizshëm detar. (WRC–19)

5.130 Kushtet për përdorimin e bartëses së frekuencës 4125 kHz dhe 6215 kHz përshkruhen në Nenet 31 dhe 52. (WRC–07).

5.131 Frekuenca 4209.5 kHz përdoret ekzkluzivisht për transmetimin nga stacionet bregdetare të sinjaleve meteorologjike dhe navigacionale dhe informacioneve urgjente të anijeve, në kuptimin e teknikave direkte me brez të ngushtë (WRC–97).

5.132 Frekuencat 4210 kHz, 6314 kHz, 8416.5 kHz, 12579 kHz, 16806.5 kHz, 19680.5 kHz, 22376 kHz dhe 26100.5 kHz janë frekuenca ndërkombëtare për transmetimin e Informacionit të Shpëtimit Detar (MSI) (shih Shtojcat 15 dhe 17).

5.132A Stacionet në shërbimin e radiopërcaktimit nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme në stacionet që veprojnë në shërbimet fikse dhe të lëvizshme ose të kërkojnë mbrojtje nga këto stacione. Aplikacionet e shërbimit të radiopërcaktimit janë të kufizuara për radarëtoqeanografike që veprojnë në përputhje me Rezolutën 612 (Rev.WRC–12) (WRC–12).

5.132B *Përcaktim alternativ*: në Armeni, Bjellorusi, Moldavi dhe Kirgistan, brezi i frekuencave 4438–4488 kHz është përcaktuar në bazë parësore për shërbimin fiks dhe për shërbimin e lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik (R) (WRC– 19).

5.133 Kategori të ndryshme të shërbimit: Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Federata Ruse, Gjeorgji, Kazakistan, Letoni, Lituani, Nigeri, Uzbekistan, Kirgistan, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Ukrainë, përcaktimi i brezit 5130–5250 kHz në shërbimin e lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik,është në bazë parësore. (shih. Nr. 5.33) (WRC–12).

5.133A *Përcaktim alternativ*: në Armeni, Bjellorusi, Moldavi, dhe Kirgistan, brezat e frekuencave 5250- 275 kHz dhe 26200–26350 kHz janë përcaktuar në bazë parësore për shërbimin fiks dhe për shërbimin e lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik (WRC– 19).

5.133B Stacionet në shërbimet amatore që përdorin brezin e frekuencave 5351.5–5366.5 kHz nuk duhet të tejkalojnë fuqinë maksimale të rrezatimit në vlerën 15W (e.i.r.p). Megjithatë në Rajonin 2, në Meksikë stacionet e shërbimit amator që përdorin brezin e frekuencës 5351.5–5366.5 kHz nuk duhet të tejkalojnë fuqinë maksimale të rrezatimit në vlerën 20 W (e.i.r.p).Në vendet e Rajonit 2 si në vazhdim: Antigua dhe Barbuda, Argjentina, Bahamas, Barbados, Belizë, Bolivia, Brazil, Kili, Kolombia, Kosta Rika, Kuba, Republika Domenikane, Dominika, El Salvador, Ekuador, Grenada, Guatemala, Guyana, Haiti, Honduras, Xhamaika, Nikaragua, Panama, Paraguaj, Peru, Santa Lusia, Santa Kits dhe Nevis, Sant Vinsent dhe në Grenadines, Suriname, Trinidad dhe Tobago, Uruguaj, Venezuelë si edhe në territore dhe qytetet ujore të Mbretërisë së Hollandës në Rajonin 2, stacionet e shërbimit amator që përdorin frekuencën 5351.5– 5366.5 kHz nuk duhet të tejkalojnë fuqinë maksimale të rrezatimit në vlerën 25 W (e.i.r.p). (WRC–19).

5.134 Përdorimi i brezave 5900–5950 kHz, 7300–7350 kHz, 9400–9500 kHz, 11600–11650 kHz, 12050–12100 kHz, 13570–13600 kHz, 13800–13870 kHz, 15600–15800 kHz, 17480–17550 kHz dhe 18900–19020 kHz nga shërbimi radioteleviziv është objekt i zbatimit të procedurës sipas Nenit 12. Administratat janë të detyruara të përdorin këto breza për të lehtësuar futjen e transmetimeve numerike të moduluara në përputhje me procedurat referuar Rezolutës 517 (Rev.WRC–19). (WRC–19)

5.136 *Përcaktim shtesë*: Frekuencat në brezin 5900–5950 kHz mund të përdoren nga stacionet e shërbimeve të mëposhtme, duke komunikuar vetëm brenda kufirit të vendit në të cilën ata janë pozicionuar: shërbimi fiks (në të tri Rajonet), shërbimi i lëvizshëm tokësor (në Rajonin 1), shërbimi i lëvizshëm, përveç i lëvizshëm areronautik (R) (në Rajonin 2 dhe 3), në kushte që të shmangen interferencat e dëmshme në shërbimin radioteleviziv. Për përdorimin e frekuencave në këto shërbime, administratave i kërkohet të përdorin minimumin e fuqisë së kërkuar dhe të marrin në konsideratë përdorimin sezonal të frekuencave nga shërbimi radioteleviziv, publikuar në përputhje me Rregulloret Radio. (WRC–07)

5.137 Me kusht që të mos shkaktohen interferenca të dëmshme për shërbimet e lëvizshme detare, brezat 6200–6213.5 kHz dhe 6220.5–6525 kHz mund të përdoren veçanërisht nga stacionet e shërbimit fiks, duke komunikuar vetëm brenda kufirit të shtetit në të cilin ata janë lokalizuar, me fuqi kryesore që nuk tejkalon 50 W. Në kohën e njoftimit të këtyre frekuencave, Byroja do të njoftojë për kushtet e mësipërme.

5.137A Frekuencat 6 337.5 kHz, 8 443 kHz, 12 663.5 kHz, 16 909.5 kHz dhe 22 450.5 kHz janë frekuencat rajonale për transmetimin e informacionit të sigurisë detare (MSI) përmes sistemit NAVDAT (shihni Shtojcat 15 dhe 17). (WRC-23)

5.138 Brezat e mëposhtëm: 6765–6795 kHz (frekuenca qendrore 6780 kHz), 433.05–434.79 MHz (frekuenca qendrore 433.92 MHz) në Rajonin 1 me përjashtim të vendeve të përmendura më sipër në Nr. 5280, 61 –61.50 GHz (frekuenca qendrore 61.25 GHz), 122–123 GHz (frekuenca qendrore 122.5 GHz) dhe 244 –246 GHz (frekuenca qendrore 245 GHz) janë dezinjuar për aplikime industriale, shkencore dhe shëndetësore (ISM). Përdorimi i këtyre brezave për zbatimet ISM duhet të jetë objekt i autorizimeve nga administratat përkatëse në marrëveshje me administratat e tjera, shërbimi i radiokomunikimit i të cilave mund të jetë i shqetësuar. Në zbatimin e këtij kushti, administratat duhet të marrin parasysh Rekomandimet përkatëse më të fundit të ITU–R.

5.140 *Përcaktim shtesë*: në Angola, Irak, Somali dhe Togo, brezi i frekuencave 7000–7050 kHz është përcaktuar gjithashtu për përdorim parësor për shërbimin fiks. (WRC– 15)

5.141 *Përcaktim alternativ*: në Egjipt, Eritrea, Etiopi, Guinea, Libi, Madagaskar dhe Nigeri brezi 7000–7050 kHz është përcaktuar për përdorim parësor për shërbimin fiks. (WRC– 12)

5.141A *Përcaktim shtesë*: Në Uzbekistan dhe Kirgistan, brezat e frekuencave 7000–7100 kHz janë përcaktuar gjithashtu për shërbimet fikse dhe të lëvizshme tokësore për përdorim dytësor. (WRC–03)

5.141B *Përcaktim shtesë*: Në Algjeri, Arabi Saudite, Australi, Bahrain, Botsvanë, Brunei Darusalam, Kinë, Komoros, Kore (Republika e), Diego Garcia, Xhibuti, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Eritrea, Guinea, Indonesia, Iran (Republika Islamike e), Japoni, Jordani, Kuvajt, Libi, Mali, Marok, Mauritani, Niger, Zelanda e Re, Oman, Guinea e Re Papua, Katar, Republika Arabe Sirisë, Republika Popullore Demokratike e Koresë, Singapor, Sudan, Sudani Jugor, Tunizi, Vietnam dhe Jemen, brezi i frekuencave 7100–7200 kHz është përcaktuar për shërbimin fiks dhe të lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik (R) në një bazë primare (WRC– 19)

5.142 Deri në 29 Mars 2009, përdorimi i brezit 7100–7300 kHz në Rajonin 2 nga shërbimi amator nuk duhet të imponojë kufizime në shërbimet radiotelevizive të parashikuara për përdorim brenda Rajonit 1 dhe 3. Pas 29 Mars 2009 përdorimi i brezit në 7200–7300 kHz në rajonin 2 nga shërbimi amator nuk duhet të imponojnë kufizime në shërbimet raditelevizive parashikuar për përdorim brenda rajonit 1 dhe 3. (WRC–03)

5.143 *Përcaktim shtesë*: Frekuenca në brezin 7300–7350 kHz mund të përdoret nga stacionet në shërbimin fiks dhe në shërbimin e lëvizshëm tokësor, duke komunikuar vetëm brenda kufijve të vendeve ku ato janë pozicionuar, me kusht që të mos shkaktojnë interferenca të dëmshme në shërbimin radioteleviziv. Kur përdoren frekuenca për shërbime të tilla, administratorët duhet të përdorin minimumin e fuqisë së kërkuar duke marrë në konsideratë përdorimin sezonal të frekuencave nga shërbimi radioteleviziv, publikuar në përputhje me Rregulloret Radio. (WRC–07)

5.143B Në Rajonin 1, brezi i frekuencave 7350–7450 kHz mund të përdoret nga stacionet e shërbimeve fiks dhe i lëvizshëm tokësor, duke komunikuar vetëm brenda kufijve të vendeve në të cilën ata janë pozicionuar, me kusht që të mos shkaktohen interferenca të dëmshme ndaj shërbimit radioteleviziv. Fuqia totale e rrezatuar për çdo stacion nuk duhet të tejkalojë vlerën 24 dBW. (WRC–12)

5.143C *Përcaktim shtesë*: Në Algjeri, Arabinë Saudite, Bahrain, Komoros, Xhibouti,Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Iran (Rep Islamike e), Jordani, Kuvait, Libi, Marok, Mauritania, Nigeri, Oman, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Sudan, Sudani Perëndimor,Tunizi dhe Jemen, brezat 7350–7400 kHz dhe 7400–7450 kHz janë përcaktuar gjithashtu dhe për shërbimin fiks për përdorim parësor. (WRC–12)

5.145 Kushtet për përdorimin e frekuencës bartëse 8291 kHz, 12290 kHz dhe 16420 kHz janë përshkruar në Nenet 31 dhe 52. (WRC–07)

5.145A Stacionet në shërbimin e radiopërcaktimit nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme në stacionet që veprojnë në shërbimet fikse ose të kërkojnë mbrojtje nga këto stacione. Aplikacionet e shërbimit të radiopërcaktimit janë të kufizuara për radarët oqeanografike që veprojnë në përputhje me Rezolutën 612 (Rev.WRC– 12) (WRC–12)

5.145B *Përcaktim alternativ:* Në Armeni, Bjellorusi, Moldavi, dhe Kirgistan, brezat e frekuencave 9305–9355 kHz and 16100–16200 kHz janë përcaktuar në bazë parësore për shërbimin fiks. (WRC– 19)

5.146 *Përcaktim shtesë:* Brezat e frekuencave 9400–9500 kHz, 11600–11650 kHz, 12050–12100 kHz, 15600–15800 kHz, 17480–17550 kHz dhe 18900–19020 kHz mund të përdoren nga stacionet e shërbimit fiks, duke komunikuar vetëm brenda kufirit të vendit në të cilën ata janë pozicionuar, me kusht që të mos shkaktohen interferenca të dëmshme ndaj shërbimit radioteleviziv. Në përdorimin e frekuencave për këtë shërbim, administratat janë të detyruara të përdorin fuqinë minimale të kërkuar dhe të marrin parasysh përdorimin sezonal të frekuencave nga shërbimi radioteleviziv, publikuar në përputhje me Radio Regulloret. (WRC–07)

5.147 Me qëllim që të mos shkaktohen interferenca të dëmshme ndaj shërbimit radioteleviziv, frekuencat në brezat 9775–9900 kHz, 11650–11700 kHz dhe 11975–12050 kHz mund të përdoren nga stacionet në shërbimin fiks, me kusht që të komunikohet vetëm brenda kufirit të shtetit në të cilin ato janë lokalizuar, duke përdorur për çdo stacion një fuqi rrezatuese totale që nuk kalon vlerën 24 dBW.

5.149 Në dhënien e frekuencave për stacionet e shërbimeve të tjera, për të cilat brezat:

13360–13410 kHz,
25550–25670 kHz,
37.5–38.25 MHz,
73–74.6 MHz në Rajonet 1 dhe 3,
150.05–153 MHz në Rajonin 1,
322–328.6 MHz,
406.1–410 MHz,
608–614 MHz në Rajonet 1 dhe 3,
1330–1400 MHz,
1610.6–1613.8 MHz,
1660–1670 MHz,
1718.8–1722.2 MHz,

2655–2690 MHz,
3260–3267 MHz,
3332–3339 MHz,
3345.8–3352.5 MHz,
4825–4835 MHz,
4950–4990 MHz,
4990–5000 MHz,
6650–6675.2 MHz,
10.6–10.68 GHz,
14.47–14.5 GHz,
22.01–22.21 GHz,
22.21–22.5 GHz,
22.81–22.86 GHz,
23.07–23.12 GHz,
31.2–31.3 GHz,
31.5–31.8 GHz në Rajonet 1 dhe 3,
36.43–36.5 GHz,
42.5–43.5 GHz,
48.94–49.04 GHz,
76–86 GHz,
92–94 GHz,
94.1–100 GHz,
102–109.5 GHz,
111.8–114.25 GHz,
128.33–128.59 GHz,
129.23–129.49 GHz,
130–134 GHz,
136–148.5 GHz,
151.5–158.5 GHz,
168.59–168.93 GHz,
171.11–171.45 GHz,
172.31–172.65 GHz,
173.52–173.85 GHz,
195.75–196.15 GHz,
209–226 GHz,
241–250 GHz,
252–275 GHz

janë përcaktuar, administratat janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur shërbimin radio astronomi nga interferencat e dëmshme. Emetimet nga stacionet ajrore mund të jenë në veçanti burime serioze të interferencës në shërbimin radio astronomi (shih Nr. 4.5 dhe 4.6 dhe Nenin 29) (WRC–07).

5.149A *Përcaktim alternativ:* në Armeni, Bjellorusi, Moldavi, dhe Kirgistan, brezi i frekuencave 13450–13550 kHz është përcaktuar në bazë parësore për shërbimin fiks dhe në bazë dytesore për shërbimin e lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik (R). (WRC– 19)

5.150 Brezat e mëposhtëm:
13553–13567 kHz (frekuenca qendrore 13 560 kHz), 26957–27283 kHz (frekuenca qendrore 27 120 kHz), 40.66–40.70MHz (frekuenca qendrore 40.68MHz), 902–928 MHz në Rajonin 2 (frekuenca qendrore 915 MHz), 2400–2500 MHz (frekuenca qendrore 2 450 MHz), 5725–5875 MHz (frekuenca qendrore 5 800 MHz), dhe 24 – 24.25 GHz (frekuenca qendrore 24.125 GHz) janë dhënë gjithashtu për zbatime ISM. Shërbimet e

radiokomunikimit që operojnë Brenda këtyre brezave duhet të pranojnë interferencat e dëmshme të cilat mund të jenë shkaktuar nga këto aplikime. Pajisja ISM që vepron në këto breza është objekt i zbatimit të Nr. 15.13.

5.151 *Përcaktim shtesë*: Brezat e frekuencave 13570–13600 kHz dhe 13800–13870 kHz mund të përdoren nga stacionet e shërbimeve fiks dhe i lëvizshëm, përvec shërbimit të lëvizshëm aeronautik (R) duke komunikuar vetëm brenda kufirit të shtetit në të cilin ato janë vendosur, me kusht që të mos shkaktohen interferenca të dëmshme në shërbimin radioteleviziv. Në përdorimin e frekuencave për këto shërbime, administratat janë të detyruara të përdorin fuqinë minimale të kërkuar dhe të marrin parasysh përdorimin sezonal të frekuencave nga shërbimi radioteleviziv, publikuar në përputhje me Radio Regulloret. (WRC–07)

5.152 *Përcaktim shtesë:* Në Armeni, Azerbajxhan, Kinë, Bregu i Fildishtë, Gjeorgji, Iran (Republika Islamike e), Kazakistan, Uzbekistan, Kirgistan, Federata Ruse, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Ukrainë, brezi 14 250 – 14 350 kHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin fiks. Stacionet e shërbimt fiks nuk duhet të përdorin një fuqi rrezatimi që kalon 24 dBW. (WRC–03

5.154 *Përcaktim shtesë:* Në Armeni, Azerbajxhan, Kinë, Bregu i Fildishtë, Gjeorgji, Iran (Republika Islamike e), Kazakistan, Uzbekistan, Kirgistan, Federata Ruse, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Ukrainë, brezi 14 250 – 14 350 kHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin fiks. Stacionet e shërbimt fiks nuk duhet të përdorin një fuqi rrezatimi që kalon 24 dBW. (WRC–03)

5.155 *Përcaktim shtesë:* Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Federatën Ruse, Gjeorgji, , Moldavi, , Uzbekistan, Kirgistan, Sllovaki, , Taxhikistan, Turkmenistan dhe Ukraine, brezi i frekuencave 21 850– 21 870 kHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimet e lëvizshme aeronautike (R). (WRC–23)

5.155A Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Federatën Ruse, Gjeorgji, , Moldavi, , Uzbekistan, Kirgistan, Slovaki, Taxhikistan,Turkmenistan dhe Ukrainë, përdorimi i brezit të frekuencave 21 850 – 21 870 kHz nga shërbimi fiks është kufizuar për ofrimin e shërbimeve që lidhen me sigurimin e fluturimeve ajrore.(WRC–23)

5.155B Brezi 21 870 – 21 924 kHz përdoret nga shërbimi fiks për ofrimin e shërbimeve që lidhen me sigurimin e fluturimeve ajrore.

5.156 *Përcaktim shtesë:* Në Nigeri, brezi i frekuencës 22720–23200 kHz është i përcaktuar gjithashtu për shërbimin e ndihmës meteorologjike (radio sondat), për përdorim parësor.

5.156A Përdorimi i brezit 23200 – 23350 kHz nga shërbimi fiks është kufizuar për ofrimin e shërbimeve të fluturimeve ajrore.

5.157 Përdorimi i brezit 23350 – 24000 kHz nga shërbimi i lëvizshëm detar është kufizuar për radiotelegrafinë ndërmjet anijeve.

5.158 *Përcaktim alternativ:* Në Armeni, Bjellorusi, Moldavi, dhe Kirgistan, brezi i frekuencave 24450 – 24600 kHz është përcaktuar në bazën parësore për shërbimet fikse dhe të lëvizshme tokësore. (WRC–19)

5.159 *Përcaktim alternativ:* Në Armeni, Bjellorusi, Moldavi, dhe Kirgistan, brezi i frekuencave 39 – 39.5 MHz është përcaktuar në bazë parësore për shërbimet fikse dhe të lëvizshme. (WRC–19)

5.159A Përdorimi i brezit të frekuencave 40-50 MHz për shërbimin e eksplorimit satelitor të Tokës (aktiv) do të bëhet në përputhje me kufizimet gjeografike dhe kushtet operative dhe teknike të përcaktuara në Rezolutën 677 (WRC-23). Dispozitat e këtij shënimi në asnjë mënyrë nuk ndërhyjnë në detyrimin e shërbimit të eksplorimit satelitor të Tokës (aktiv) për të operuar si shërbim i dytë në përputhje me Nr. 5.29 dhe 5.30. (WRC-23)

5.160 *Përcaktim shtesë:* Në Botsvana, Burundi, Rep Demokratike e Kongos dhe Ruanda, brezi i frekuencave 41–44 MHz është i përcaktuar gjithashtu për përdorim parësor për shërbimin e radionavigacionit aeronautik. (WRC–12)

5.161A *Përcaktim shtesë:* në Kore (Republika e), Shtetet e Bashkuara dhe Meksikë, brezat e frekuencave 41.015–41.665 MHz dhe 43.35–44 MHz janë gjithashtu të përcaktuara në bazë parësore për shërbimin e radiopërcaktimit. Stacionet në shërbimin e radiovendndodhjes nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme, ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet që operojnë në shërbimet fikse dhe të lëvizshme. Aplikimet e shërbimit të radiovendndodhjes janë të kufizuara për radarët oqeanografike që operojnë në përputhje me Rezolutën 612 (Rev.WRC–12). (WRC–19)

5.161B *Përcaktim alternativ:* në Shqipëri, Gjermani, Armeni, Austri, Bjellorusi, Belgjikë, Bosnje–Hercegovinë, Qipro, Vatikan, Kroaci, Danimarkë, Spanjë, Estoni, Finlandë, Francë, Greqi,Hungari, Irland, Island, Itali, Letoni, Maqedonia e Veriut, Lihtenshtajn, Lituani, Luksemburg, Malta, Moldavi, Monako, Mali i Zi, Norvegji, Uzbekistan, Hollandë, Portugali, Kirgistan, Sllovaki, Republika Çeke, Rumani, Mbretëria e Bashkuar, San Marino, Sllloveni, Suedi, Zvicër, Turqi dhe Ukrainë, brezi i frekuencave 42–42.5 MHz është përcaktuar në bazë primare për shërbimet fikse dhe të lëvizshme. (WRC–19)

5.162A *Përcaktim shtesë:* në Gjermani, Australi, Austri, Belgjikë, Bosnje dhe Hercegovinë, Kinë, Vatikan,, Korea (Republika e.), Danimarkë, Spanjë, Estoni, Federatën Ruse, Finland, Francë, Indonezi, Irlandë, Islandë, Itali, Japoni, Letoni, Lihtenshtajn, Lituania, Luksemburg, Maqedonia e Veriut, Monako, Mali i Zi, Norvegji, Hollandë, Poloni, Portugali, Republikën Popullore Demokratike të Koresë, Republika Çeke, Mbretëria e Bashkuar, Serbi, Sllloveni, Suedi dhe Zvicër, brezi i frekuencave 46–68 MHz është përcaktuar gjithashtu për shërbimin e radiovendndodhjes në një bazë dytësore. Ky përdorim është i limituar për operimin e radarëve për matjen e profilit të erërave në përputhje me Rezolutën 217 (Rishikuar WRC–23). (WRC–23)

5.163 *Përcaktim shtesë:* Në Armeni, Bjellorusi, Federatën Ruse, Gjeorgji, Kazakistan, Letoni, Moldavi, Uzbekistan, Kirgistan, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Ukrainë, brezat 47–48.5 MHz dhe 56.5–58 MHz janë gjithashtu të përcaktuar për përdorim dytësor për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm tokësor. (WRC– 19)

5.164 *Përcaktim shtesë:* Në Shqipëri, Algjeri, Gjermani, Austri, Belgjikë, Bosnje Hecegovinë, Botsvana, Bullgari, Bregu i Fildishtë, Kroaci, Danimarkë, Spanjë, Estoni, Esuatini ,Finlandë, Francë, Gabon, Greqi, Hungari, Irlandë, Izrael, Itali, Jordani, Liban, Libi, Lihtenshtein, Lituani, Luksemburg, Madagaskar, Mali, Maltë, Marok, Mauritani, Monako, Mali i Zi, Nigeri, Norvegji, Hollandë, Poloni, Republika Arabe Siriane, Sllovaki, Republiken Çeke, Rumani,

Mbretërinë e Bashkuar, Serbi, Sllloveni, Suedi, Zvicër, Çad, Togo, Tunizi dhe Turqi, brezi i frekuencave 47–68 MHz, në Afrikën e Jugut brezi i frekuencave 47–50 MHz dhe në Letoni brezi i frekuencave 48.5 – 56.5MHz dhe 58-68 MHz, janë gjithashtu të përcaktuar në një bazë parësore për shërbimin e lëvizshëm tokësor. Megjithatë, stacionet e shërbimit të lëvizshëm tokësor në vendet e përmendura në lidhje me çdo brez frekuence të referuar në këtë shënim, nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet ekzistuese ose të planifikuara të shërbimit radioteleviziv të vendeve të tjera përveç atyre të përmendura në lidhje me brezin e frekuencës. (WRC–19).

5.165 *Përcaktim shtesë:* Në Angola, Kamerun, Rep Demokratike e Kongos, Egjipt, Madagaskar, Mozambik, Nigeri, Somali, Sudan, Sudani perëndimor, Tanzani dheKad, brezi 47–68 MHz është përcaktuar gjithashtu për shërbimin fiks dhe i lëvizshëm përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik, për përdorim parësor. (WRC–19).

5.166A *Kategori të ndryshme shërbimesh:* në Austri, Qipro, Vatikan, Kroaci, Danimarkë, Spanjë, Finlandë, Hungari, Letoni, Hollandë, Republikën Çeke, Mbretërinë e Bashkuar, Sllovaki dhe Sllloveni, brezi 50.0-50.5 MHz është përcaktuar për përdorim parësor për shërbimin amator. Stacionet në shërbimin amator në këto vende nuk duhet të shkaktojnë interference të dëmshme, ose të kërkojnë mbrojtje nga, stacionet e radiotelevizive, stacionet e shërbimit fiks ose të lëvizshëm, që veprojnë në përputhje me Radio Rregulloret në brezin 50.0-50.5 MHz në vendet që nuk janë të listuara në këtë dispozitë. Për një stacion të këtyre shërbimeve, do të zbatohen gjithashtu kriteret e mbrojtjes në Nr. 5.169B. Në Rajonin 1, me përjashtim të vendeve të listuara në Nr. 5.169, radarët e profileve të erës që veprojnë në shërbimin e radiovendndodhjes nën Nr. 5.162A janë të autorizuar të operojnë në bazë të barazisë me stacionet në shërbimin amator në brezin 50.0-50.5 MHz. (WRC 19).

5.166B Në Rajonin 1, stacionet në shërbimin amator që funksionojnë për përdorim dytësor nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme, ose të kërkojnë mbrojtje nga, stacionet e shërbimeve radiotelevizive. Fuqia e fushës e gjeneruar nga një stacion amator në Rajonin 1 në brezin 50-52 MHz nuk duhet të kalojë një vlerë të llogaritur +6 dB(μV/m) në një lartësi prej 10 m mbi tokë për më shumë se 10% të kohës përgjatë kufirit të një vendi me stacion operimi të transmetimeve analoge në Rajonin 1 dhe vendet fqinje me stacione transmetimi në Rajonin 3 të listuara në Nr. 5.167 dhe 5.168. (WRC-19).

5.166C Në Rajonin 1, stacionet në shërbimin amator në brezin 50-52 MHz, me përjashtim të vendeve të shënuara në Nr. 5.169, nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme, ose të kërkojnë mbrojtje nga, radarët e profileve të erës që veprojnë në shërbimin e radiovendndodhjes nën Nr.5.162A. (WRC-19)

5.166D *Kategori të ndryshme shërbimesh*: në Liban, brezi 50-52 MHz është përcaktuar për përdorim parësor për shërbimin amator. Stacionet në shërbimin amator në Liban nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme, ose të kërkojnë mbrojtje nga, stacionet e transmetimit, stacionet e shërbimit fiks ose të lëvizshëm, që veprojnë në përputhje me Radio Rregulloret në brezin 50-52 MHz në vendet që nuk janë të listuara në këtë dispozitë. (WRC-19)

5.166E Në Federatën Ruse, vetëm brezi 50.080-50.280 MHz është përcaktuar për përdorim dytësore për shërbimin amator. Kriteret e mbrojtjes për shërbimet e tjera në vendet që nuk janë të përfshira në këtë dispozitë specifikohen në Nr.5.166B dhe 5.169B. (WRC-19)

5.169 *Përcaktim shtesë*: Në Botsvanë, Esuatini, Lesoto, Malavi, Namibia, Ruanda, Afrika Jugore, Zambia dhe Zimbabve, brezi 50–54 MHz është përcaktuar për përdorim parësor për shërbimin amator. Në Senegal, brezi 50- 51 MHz është përcaktuar për përdorim parësor për shërbimin amator. (WRC-19)

5.169A *Përcaktim shtesë:* në vendet e mëposhtme në Rajonin 1: Angola, Arabi Saudite, Bahrain, Burkina Faso, Burundi, Emiratet e Bashkuara Arabe, Gambia, Jordania, Kenia, Kuvajti, Mauritius, Mozambiku, Omani, Uganda, Katari, Sudani i Jugut dhe Tanzania, brezi 50-54 MHz është përcaktuar për përdorim parësor për shërbimin amator. Në Guinea-Bissau, brezi 50.0-50.5 MHz është përcaktuar për përdorim parësor për shërbimin amator. Në Xhibuti, brezi 50-52 Mhz është përcaktuar për përdorim parësor për shërbimin amator. Me përjashtim të vendeve të listuara në Nr. 5.169, stacionet në shërbimin amator që veprojnë në Rajonin 1 nën këtë shënim, në të gjithë ose në një pjesë të brezit 50-54 MHz, nuk duhet të shkaktojnë interference të dëmshme, ose të kërkojnë mbrojtje nga, stacionet e shërbimeve të tjera operative në përputhje me Radio Rregulloret në Algjeri, Egjipt, Iran (Republika Islamike e), Irak, Izrael, Libi, Palestinë*, Republikën Arabe të Sirisë, Republikën Popullore Demokratike të Koresë, Sudan dhe Tunizi. Fuqia e fushës e gjeneruar nga një stacion amator në brezin 50-54 MHz nuk duhet të kalojë një vlerë +6 dB(μV/m) në një lartësi prej 10 m mbi tokë për më shumë se 10% të kohës përgjatë kufirit të vendeve të listuara që kërkojnë mbrojtje. (WRC-19)

5.169B Me përjashtim të vendeve të listuara në Nr. 5.169. stacionet në shërbimin amator të përdorura në Rajonin 1, në të gjithë ose në një pjesë të brezit 50-54 MHz, nuk duhet të shkaktojnë interference të dëmshme, ose të kërkojnë mbrojtje nga, stacionet e shërbimeve të tjera përdorur në përputhje me Radio Rregulloret në Algjeri, Armeni, Azerbaixhan, Bjellrusi, Egjipt, Federatën Ruse, Iran (Republika Islamike e), Irak, Kazakistan, Kirgistan, Libi, Uzbekistan, Palestinë*, Republiën Arabe të Sirisë, Sudan, Tunizi dhe Ukrainë. Fuqia e fushës e gjeneruar nga një stacion amator në brezin 50-54 MHz nuk duhet të kalojë një vlerë +6 dB(μV/m) në një lartësi prej 10 m mbi tokë për më shumë se 10% të kohës përgjatë kufirit të vendeve të listuara në këtë direktivë. (WRC-19)

5.175 *Përcaktim alternativ*: Në Armeni, , Bjellorusi, Federatën Ruse , Kazakistan, , , Moldavi, , Uzbekistan, Kirgistan, , Taxhikistan,Turkmenistan dhe Ukrainë, brezat e frekuencave 68–73 MHz dhe 76–87.5 MHz janë përcaktuar për përdorim parësor për shërbimin radioteleviziv. Në Letoni dhe Lituani, brezat e frekuencave 68-73 MHz dhe 76-87.5 MHZ janë përcaktuar për përdorim parësor për shërbimin radioteleviziv dhe të lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. Në Mongoli brezi i frekuencave 76 – 87.5 MHz është alokuar për shërbimin radioteleviziv në bazë primare; stacionet e shërbimit radioteleviziv nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet fikse dhe të lëvizshme ekzistuese ose të planifikuara në vendet fqinje. Shërbimet për të cilat këto breza frekuencash janë përcaktuar në vendet e tjera dhe shërbimi radioteleviziv në vendet e përmendura më sipër janë objekt për marrëveshje me vendet fqinje përkatëse. (WRC–23)

5.177 *Përcaktim shtesë*: Në Armeni, , Bjellorusi, Federatën Ruse , Kazakistan, Uzbekistan, Kirgistan, , Taxhikistan, Turkmenistan dhe Ukrainë, brezi i frekuencave 73–74 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin radioteleviziv, objekt i marrëveshjes së marrë sipas Nr. 9.21. (WRC–23)

5.178 *Përcaktim shtesë:* Në Kolombi, Kubë, El Salvador, Guatemalë, Guinea, Honduras dhe Nikaragua brezi 73–74.6 MHz është i përcaktuar gjithashtu për përdorim dytësor, për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm. (WRC–12).

5.179 *Përcaktim shtesë:* Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Kinë, Federata Ruse, Gjeorgji, Kazakistan, Lituani, Mongoli, Kirgistan, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Ukraine, brezat 74.6–74.8 MHz dhe 75.2–75.4 MHz janë gjithashtu të përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e radionavigacionit aeronautik, vetëm për transmetuesit me bazë në tokë. (WRC–12)

5.180 Frekuenca 75 MHz është dhënë për sinjalizime. Administratat nuk duhet të japin frekuenca afër kufijve të brezave kufi të stacioneve të shërbimeve të tjera të cilat për shkak të fuqisë së tyre ose të pozicionit gjeografik mund të shkaktojnë një interferencë të dëmshme ose ndryshe të krijojnë një pengesë në sinjalizime. Duhen të gjitha përpjekjet për të përmirësuar më tej karakteristikat e marrësve në bordet e anijeve dhe për të kufizuar fuqinë e stacioneve transmetuese afër kufijve 74.8 MHz dhe 75.2 MHz.

5.181 *Përcaktim shtesë:* Në Egjipt, Izrael dhe në Repuklikën Arabe të Sirisë, brezi 74.8–75.2 MHz është përcaktuar gjithashtu për shërbimin e lëvizshëm për përdorim dytësorë, subjekt marrëveshjeje të përfituar nga neni 9.21. Me qëllim që të sigurohet mos shkaktimi i interferencave të dëmshme në stacionet e shërbimit të radionavigacionit aeronautik, stacionet e shërbimit të lëvizshëm nuk duhet të futen në këtë brez deri sa ky brez të mos kërkohet më për shërbimin e radionavigacionit aeronautik, nga cilado administratë e cila mund të identifikohet si e afektuar nga aplikimi i procedurës në përputhje me nenin 9.21. (WRC–03)

5.185 5.185 Kategori të ndryshme shërbimi: në Shtetet e Bashkuara, departamentet e jashtme Franceze dhe komunitetet në Rajonin 2 dhe Guajanë, shpërndarja e brezit të frekuencave 76-88 MHz për shërbimet fikse dhe të lëvizshme është në bazë primare (shihni Nr. 5.33). (WRC-23)

5.187 *Përcaktim alternativ*: Në Shqipëri, brezi 81–87.5 MHz është i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin radioteleviziv dhe përdoret në përputhje me vendimet e përmbajtura në Aktet Finale të Konferencës Speciale Rajonale (Gjenevë, 1960).

5.190 *Përcaktim alternativ*: Në Shqipëri, brezi 81–87.5 MHz është i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin radioteleviziv dhe përdoret në përputhje me vendimet e përmbajtura në Aktet Finale të Konferencës Speciale Rajonale (Gjenevë, 1960).

5.194 *Përcaktim shtesë:* Në Kirgistan, Somali dhe Turkmenistan, brezi 104–108 MHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë dytësore për shërbimin e lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik (R). (WRC–07)

5.197 *Përcaktim shtesë:* Në Republikën Arabe të Sirisë, brezi 108–111.975 MHz është përcaktuar gjithashtu për shërbimin e lëvizshëm për përdorim dytësor, subjekt marrëveshjeje të përfituar në përputhje me nenin 9.21. Me qëllim që të sigurohet mos shkaktimi i interferencave të dëmshme në stacionet e shërbimit të radionavigacionit aeronautik, stacionet e shërbimit të lëvizshëm nuk duhet të futen në këtë brez deri sa ky brez të mos kërkohet më për shërbimin e radionavigacionit aeronautik, nga cilado administratë e cila mund

të identifikohet si e afektuar nga aplikimi i procedurës në përputhje me nenin9.21. (WRC–03)

5.197A *Përcaktim shtesë:* Brezi i frekuencave 108–117.975 MHz është përcaktuar gjithashtu për përdorim parësornga shërbimi i lëvizshëm aeronautik (R), i kufizuar për sistemet që operojnë në përputhje me standartet e njohura ndërkombëtare aeronautike. . Një përdorim i tillë duhet të jetë në përputhje me Rezolutën 413 (Rev. WRC–23). Përdorimi i brezit te frekuencave 108–112 MHz nga shërbimi i lëvizshëm aeronautik (R) do të jetë i kufizuar në sistemet e përbërë nga transmetues me bazë në tokë dhe marrësat përkatës që sigurojnë informacion mbi navigimin në mbështetje të funksioneve të navigimit ajror, në përputhje me standartet e njohura ndërkombëtare aeronautike. (WRC– 23)

5.198A Përdorimi i brezit të frekuencës 117.975-137 MHz nga shërbimi i lëvizshëm aeronautik satelitor (R) është subjekt i koordinimit sipas Nr. 9.11A. Nr. 9.16 nuk zbatohet. Një përdorim i tillë do të kufizohet për sistemet satelitore jo gjeostacionare që operojnë në përputhje me standardet ndërkombëtare aeronautike. Zbatohet Rezoluta 406 (WRC-23). (WRC-23)

5.200 Në brezin e frekuencave 117.975–137 MHz, frekuenca 121.5 MHz është frekuencë emergjence aeronautike dhe kur kërkohet, frekuenca 123.1 MHz është frekuencë ndihmëse aeronautike për 121.5 MHz. Stacionet e lëvizshme të shërbimit të lëvizshëm detar mund të komunikojnë në këto frekuenca, nën kushtet e paraqitura në Nenin 31 për qëllime sigurie dhe fatkeqësie me stacionet e shërbimit të lëvizshëm aeronautik dhe shërbimit të lëvizshëm aeronautik satelitor (R) . (WRC–23)

5.201 *Përcaktim shtesë:* Në Arabinë Saudite, Armeni, Azerbajxhan, Bahrain, Egjipt, Estoni, Federatën Ruse, Gjeorgji, Hungari, Iran (Republika Islamike e), Irak (Republika e), Japoni, Kazakistan, Mali, Mongoli, Mozambik, Uzbekistan, Guinea e Re Papua, Poloni, Katar, Kirgistan, Rumani, Senegal, Somalia, Taxhikistan dheTurkmenistan, brezi i frekuencave 132 – 136 MHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e lëvizshëm aeronautik (OR). Në caktimin e frekuencave të stacioneve të shërbimit të lëvizshëm aeronautik (OR), administratat duhet të marrin parasysh caktimin e frekuencave në stacionet e shërbimit të lëvizshëm aeronautik (R). (WRC– 23)

5.202 *Përcaktim shtesë:* Në Arabinë Saudite, Armeni, Azerbajxhan, Bahrain, Emiratet e Bashkuara Arabe, Federatën Ruse, Gjeorgji, Iran (Republika Islamike e), Jordani, Mali, Oman, Uzbekistan, Poloni, Republika Arabe e Sirisë, Kirgistan, Rumani, Senegal, Taxhikistan, dhe Turkmenistan , brezi i frekuencave 136–137 MHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e lëvizshëm aeronautik (OR). Në caktimin e frekuencave për stacionet e shërbimit të lëvizshëm aeronautik (OR), administratat duhet të marrin parasysh caktimin e frekuencave në stacionet e shërbimit të lëvizshëm aeronautik (R). (WRC– 23)

5.203C Përdorimi i shërbimeve të veprimeve hapësinore (hapësirë-Tokë) me sisteme satelitore jo-gjeostacionare me mision me kohëzgjatje të shkurtër në brezin 137-138 MHz është subjekt i Rezolutës COM5/9 (WRC-19). Rezoluta COM5/5 (WRC-19) aplikohet. Këto sisteme nuk duhet të shkaktojnë interference të dëmshme, ose të kërkojnë mbrojtje nga, shërbime ekzistuese brezi i të cilave është përcaktuar në bazë parësore. (WRC-19)

5.204 *Kategori të ndryshme shërbimi:* Në Afganistan, Arabi Saudite, Bahrain, Bangladesh, Brunei Darusalem, Kine, Kubë, Emiratet e Bashkuara Arabe, Indi, Indonezi, Republikën Islamike të Iranit, Irak, Kuvajt, Oman, Pakistan, Filipine, Katar, Singapor, Tailand si dhe Jemen, brezi 137 – 138 MHz është përcaktuar në bazë parësore për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik (R), (shiko shënimin Nr.5.33). (WRC–07)

5.205 *Kategori të ndryshme shërbimi:* Në Izrael dhe Jordani përcaktimi i brezit 137–138 MHz për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik është për përdorim dytësorë. (shih Nr.5.33).

5.206 Kategori të ndryshme shërbimi: Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Bullgari, Egjypt, Finlandë, Francë, Gjeorgji, Greqi, Kazakistan, Liban, Moldavi, Mongoli, Uzbekistan, Poloni, Kirgistan, Republika Arabe e Sirisë, Sllovaki, Republikën Çeke, Rumani, Federaten Ruse, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Ukrainë, përcaktimi i brezit 137–138 MHz për shërbimin e lëvizshëm aeronautik (OR) është në bazë parësore (shiko Nr.5.33). (WRC–2000)

5.208 Përdorimi i brezit 137 – 138 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor është objekt i koordinimit nën Nr.9.11A. (WRC–97)

5.208A Në dhënien e frekuencave për stacionet hapësinore në shërbimin e lëvizshëm satelitor në brezat 137 – 138 MHz, 387 – 390 MHz dhe 400.15– 401 MHz, dhe në shërbimet e lëvizshme satelitore detare (hapësirë-Tokë) në brezat 157.1875-157.3375 MHz dhe 161.7875-161.9375 MHz, administratat duhet të marrin të gjitha masat praktike për mbrojtjen e shërbimit të radio astronomisë në brezat 150.05 – 153 MHz, 322 –328.6 MHz, 406.1 – 410 MHz dhe 608 – 614 MHz nga interferencat e dëmshme shkaktuar nga emëtimet e padëshiruara. Nivelet e kufirit të dëmtimeve të intereferencës në shërbimin e radio astronomisë tregohen në versionin më të fundit të Rekomandimit ITU-R RA.769 (WRC–07)

5.208B* Në brezat e frekuencave:
137–138 MHz,
157.1875-157.3375 MHz,
161.7875-161.9375 MHz,
387–390 MHz,
400.15–401 MHz,
1 452–1 492 MHz,
1 525–1 610 MHz,
1 613.8–1 626.5 MHz,
2 655–2 690 MHz,
21.4–22 GHz,
do të zbatohet Rezoluta 739 (Rev.WRC–15). (WRC–15)

* Kjo dispozitë më parë ka qenë nën shënimin 5.347A. Është vendosur numër i ri për të ruajtur rendin vazhdues me shënimin e mësipërm.

5.209 Përdorimi i brezave 137–138 MHz, 148–150.05 MHz, 399.9–400.05 MHz, 400.15– 401 MHz, 454–456 MHz dhe 459–460 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor është i rezervuarpër sistemet satelitore jogjeostacionare. (WRC–97)

5.209A Përdorimi i brezit 137.175-137.825 MHz nga sistemet satelitore jogjeostacionare në shërbimin e veprimeve hapësinore identifikuar si mision

me kohëzgjatje të shkurtër, në përputhje me shtojcën 4, nuk i nënshtrohet Nr.9.11A. (WRC-19)

5.210 *Përcaktim shtesë:* Në , Itali dhe Mbretërinë e Bashkuar, brezat e frekuencave 138–143.6 MHz dhe 143.65–144 MHz janë gjithashtu të përcaktuar për përdorim dytësore për shërbimin e kërkimeve hapësinore (hapësirë–Tokë). (WRC–23)

5.211 *Përcaktim shtesë*: Në Gjermani, Arabi Sauditë, Austri, Bahrein, Belgjikë, Danimarkë, Emiratet e Bashkuara Arabe, Spanjë, Finlandë, Greqi, Guinea, Irlandë, Izrael, Kenia, Kuvajt, Liban, Lihtenshtejn, Luksemburg, Maqedoni e Veriut, Mali, Maltë, Mal i Zi, Norvegji, Hollandë, Katar, Sllovaki, Mbretërinë e Bashkuar, Serbi, Slloveni, Somali, Suedi, Zvicër, Tanzani, Tunizi dhe Turqi, brezi i frekuencave 138–144 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimet e lëvizshme detare dhe tokësore. (WRC– 19)

5.212 *Përcaktim alternativ*: në Angola, Botsvanë, Kamerun, Rep Afrikës Qendrore, Kongo (Rep. e), Esuatini, Gabon, Gambia, Gana, Guinea, Irak, Jordani, Lesoto, Liberi, Libi, Malaui, Mozambik, Namibia, Nigeri, Oman, Uganda, Republika Arabe e Sirisë, Rep. Demokratike e Kongos, Ruanda, Sierra Leone, Afrika Perëndimore, Çad, Togo, Zambia dhe Zimbabve, brezi 138–144 MHz është përcaktuar për përdorim parësor, për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm. (WRC–19).

5.214 *Përcaktim shtesë*: Në Eriteria, Etiopi, Kenia, Maqedoni e Veriut, Mal të Zi, Serbi, Somali, Sudan, Sudani Jugor dhe Tanzani, brezi 138–144 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin fiks. (WRC– 19)

5.218 *Përcaktim shtesë:* Brezi 148–149.9 MHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e veprimeve hapësinore (Tokë–hapësirë), objekt për marrëveshjen e arritur në bazë të Nr. 9.21. Gjërësia e brezit e çdo transmetimi individual nuk do të kalojë ± 25 kHz.

5.218A Brezi 148-149.9 MHz në shërbimin e veprimeve hapësinore (Tokë-hapësirë) mund të përdoret nga sisteme satelitore jogjeostacionare me mision me kohëzgjatje të shkurtër. Sistemet satelitore jogjeostacionare në përdorimin e shërbimeve veprime hapësinore për një mision me kohë të shkurtër në përputhje me Rezolutën **COM5/5 (WRC-19)** të Radio Rregulloreve nuk i nënshtrohen marrëveshjes nën Nr. **9.21**. Në fazën e koordinimit, zbatohen edhe dispozitat Nr. 9.17 dhe 9.18. Në brezin 148-149.9 MHz sistemet satelitore jogjeostacionare me misione me kohëzgjatje të shkurtër nuk duhet të shkaktojnë interferencë të papranueshme, ose të pretendojnë mbrojtje nga, shërbimet parësore ekzistuese brenda këtij brezi, ose të vendosë kufizime shtesë në shërbimet e veprimeve hapësinore dhe në shërbimet e lëvizshme satelitore. Pëveç kësaj, satcionet tokësore në sistemet jogjeostacionare satelitore në shërbimin e veprimeve hapësinore me mision me kohezgjatje të shkurtër në brezin 148-149.9 MHz siguron që densiteti i fluksit të energjisë të mos kalojë -149 dB(W/(m^2·4 kHz)) për më shumë se 1% të kohës në kufirin e territorit të vendeve në vijim: Armeni, Azerbajxhan, Bjellrusi, Kinë, Korea (Rep.e), Kubë, Federata Ruse, India, Irani (Republika Islamike e), Japoni, Kazakistan, Malajzi, Uzbekistan, Kirgistan, Tajlandë dhe Vietnam. Në rast se ky kufi i densitetit të fluksit të energjisë tejkalohet, marrëveshja Nr. 9.21 kërkohet të merret nga vendet e përmendura në këte shënim.

5.219 Përdorimi i brezit 148–149.9 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor është objekt për koordinimin nën Nr. 9.11A. Shërbimi i lëvizshëm satelitor nuk do

të pengojë zhvillimin dhe përdorimin e shërbimeve fiks, i lëvizshëm dhe veprime hapësinore në brezin 148–149.9 MHz. Përdorimi i brezave 148-149.9 MHz nga sistemet jo gjeostacionare-satelitore në shërbimin e funksionimit hapësinor të identifikuar si mision me kohëzgjatje të shkurtër nuk i nënshtrohet Nr. 9.11A (WRC-19)

5.220 Përdorimi i brezave 149.9–150.05 MHz dhe 399.9–400.05 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor është objekt për koordinimin nën Nr. 9.11A. (WRC–15)

5.221 Stacionet e shërbimit të lëvizshëm satelitor në brezin e frekuencave 148 – 149.9 MHz nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e shërbimit fiks ose të lëvizshëm, që veprojnë në përputhje me Tabelën e Përcaktimit të Frekuencave në vendet e mëposhtme: Shqipëri, Algjeri, Gjermani, Arabi Saudite, Australi, Austri, Bahrain, Bangladesh, Barbados, Bjellorusi, Belgjike, Benin, Bosnje–Hercegovinë, Botsvana, Brunei Darusalam, Bullgari, Kamerun, Kinë, Qipro, Kongo (Rep e), Kore (Rep e), Bregu i Fildishtë, Kroaci, Kubë, Danimarkë, Xhibuti, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Eritrea, Spanjë, Estoni, Esuatini, Etiopi, Federatën Ruse, Finlandë, Francë, Gabon, Gjeorgji, Gana, Greqi, Guinea, Guinea Bissau, Hungari, Indi, Republikën Islamike të Iranit, Irlandë, Islandë, Izrael, Itali, Xhamajke, Japoni, Jordani, Kazakistan, Kenia, Kuvait, Lesotho, Letoni, Liban, Libi, Liehtenshtein, Lituani, Luksemburg, Maqedoni e Veriut, Malajzi, Mali, Maltë, Mauritani, Moldavia, Mongoli, Mali i Zi, Mozambik, Namibi, Norvegji, Zelandën e Re, Oman, Ugandë, Uzbekistan, Pakistan, Panama, Guine e Re Papua, Paraguaj, Hollandë, Filipine, Poloni, Portugali, Katar, Siri (Republika Arabe),Turqi, Kirgistan, Republika Demoktratike e Koresë, Sllovaki, Rumani, Mbretërinë e Bashkuar, Senegal, Serbia, Siera Leone, Singapor, Slloveni, Somali, Sudan, Sri Lanka, Afrikën e Jugut, Suedi, Zvicër, Tanzani, Çad, Togo, Tonga, Trinidad dhe Tobago, Tunizi, Ukrainë, Vietnam, Jemen, Zambia dhe Zimbabve. (WRC– 23)

5.225A *Përcaktim shtesë*: Në Algjeri, Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Kinë, Francë, Iran (Republika Islamike e), Kazakistan, Uzbekistan, Kirgistan, Taxhikistan, Turkmenistan, Ukraninë dhe Vietnam, brezi i frekuencave 154–156 MHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e radiopërcaktimit. Përdorimi i brezit të frekuencave 154–156 MHz nga shërbimi i radiopërcaktimit duhet të kufizohet në sistemet e zbulimit të hapësirë–objekt që veprojnë nga pozicione tokësore. Përdorimi i stacioneve në shërbimin e radiopërcaktimit në brezin e frekuencave 154–156 MHz do të jetë objekt i marrëveshjes së arritur sipas Nr. 9.21. Për identifikimin e administratave të prekura potencialisht në Rajonin 1, duhet të përdoret vlera e fuqisë së fushës prej 12 dB (μV/m) për 10% të kohës prodhuar në 10 m mbi nivelin e tokës në brezin e frekuencave referencë 25 kHz, në kufirin e territorit të çdo administrate tjetër. Për identifikimin e administratave të prekura potencialisht në Rajonin 3, duhet të përdoret vlera e raportit interferencë –zhurmë (I/N) prej 6 dB (N = 161 dBW/4 kHz), ose 10 dB për aplikimet me kërkesa më të mëdha mbrojtjeje, të tilla si mbrojtje publike dhe lehtësim fatkeqësish (PPDR (N = 161 dBW/4 kHz)), prej 1% të kohës prodhuar në 60 m mbi nivelin e tokës në kufirin e territorit të çdo administrate tjetër. Në brezat e frekuencave 156.7625–156.8375 MHz, 156.5125–156.5375 MHz, 161.9625– 161.9875 MHz, 162.0125–162.0375 MHz, (out–of–band e.i.r.p) e.i.r.p brenda brezit të radarëve të mbikqyrjes së hapësirës nuk duhet të kalojë 16 dBW. Caktimet e frekuencës në shërbimin e radiopërcaktimit sipas këtij përcaktimi në Ukrainë nuk do të përdoren pa marrëveshje me Moldavinë. (WRC–12)

5.226 Frekuenca 156.8 MHz është frekuencë ndërkombëtare për fatkeqësi, siguri dhe thirrje për shërbimin e lëvizshëm detar të radiotelefonisë VHF. Kushtet për përdorimin e kësaj frekuence dhe të brezit 156.7625–156.8375 MHz përmbahen në Nenin 31 dhe Shtojcën 18. Frekuenca 156.525 MHz është frekuencë ndërkombëtare për fatkeqësi, siguri dhe thirrje për shërbimin e lëvizshëm detar të radiotelefonisë VHF duke përdorur thirrje selektive numerike (DSC). Kushtet e përdorimit të kësaj frekuence dhe brezit 156.4875–156.5625 MHz përfshihen në nenin 31 dhe 52 si dhe shtojcën 18. Në brezat 156 –156.4875 MHz, 156.5625–156.7625 MHz, 156.8375–157.45 MHz, 160.6–160.975 MHz and 161.475–162.05 MHz çdo administratë duhet t'i japë prioritet shërbimit të lëvizshëm detar vetëm në ato frekuenca që janë dhënë për stacionet e shërbimit të lëvizshëm detar nga administratat (shih Nenet 31 dhe 52, dhe Shtojcen 18). Çdo përdorim i frekuencave në këto breza nga stacionet e shërbimeve të tjera për të cilat ato janë përcaktuar duhet të shmangen në zona ku të tilla përdorime mund të shkaktojnë interferenca të dëmshme për shërbimin e radiokomunikimit VHF të lëvizshëm detar. Megjithatë frekuenca 156.8 MHz dhe 156.525 MHz si dhe brezat e frekuencave në të cilat prioritet i është dhënë shërbimit të lëvizshëm detar mund të jenë përdorur për radiokomunikime brenda territoreve të lundrueshëm ujore (si lumë, kanale ujore) objekt për marrëveshje përmes administratave të interesuara dhe të prekura duke marrë parasysh përdorimin e frekuencave aktuale dhe marrëveshjet ekzistuese.

5.227 *Përcaktim shtesë:* Brezat 156.4875–156.5125 MHz dhe 156.5375–156.5625 MHz janë caktuar gjithashtu për përdorim parësor dhe për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm tokësor. Përdorimi i këtyre brezave nga shërbimet fiks dhe i lëvizshëm tokësor nuk duhet të shkaktojë interferenca të dëmshme dhe as të kërkojë mbrojtje nga shërbimi i radiokumunikimit të lëvizshëm detar në VHF. (WRC–07)

5.228 Përdorimi i brezave të frekuencave 156.7625–156.7875 MHz dhe 156.8125–156.8375 MHz nga shërbimi satelitor i lëvizshëm (tokë–hapësirë) është kufizuar në marrjen e transmetimeve nga sistemi automatik i identifikimit (AIS) të mesazheve elektronike me rreze të gjatë veprimi AIS (Mesazh 27, shih versionin më të fundit të Rekomandimit ITU R M.1371). Me përjashtim të transmetimeve të AIS, transmetimet në këto breza frekuencash nga sistemet që operojnë në shërbimin e lëvizshëm detar për komunikimet nuk duhet të tejkalojnë vlerën 1 W. (WRC–12)

5.228A Brezat e frekuencave 161.9625–161.9875 MHz and 162.0125–162.0375 MHz mund të përdoren nga stacionet e avionëve për qëllime të operacioneve të kërkimit dhe shpëtimit si dhe komunikime të tjera që lidhen me sigurinë. (WRC–12)

5.228AA Përdorimi i brezit të frekuencave 161.9375–161.9625 MHz dhe 161.9875–162.0125 MHz nga shërbimi i lëvizshëm detar–satelitor (Tokë–hapësirë) është kufizuar tek sistemet të cilat operojnë në përputhje me Shtojcën 18. (WRC–15)

5.228AB Përdorimi i brezave 157.1875-157.3375 MHz dhe 161.7875-161.9375 MHZ nga shërbimi i lëvizshëm detar-satelitor (Tokë-hapsirë) është i kufizuar në sisteme satelitore jogjeostacionare që veprojnë në përputhje me Shtojcën 18. (WRC-19)

5.228AC Përdorimi i brezave 157.1875-157.3375 MHz dhe 161.7875-161.9375 MHz nga shërbimi i lëvizshëm detar-satelitor (Tokë-hapsirë) është i kufizuar në sisteme satelitore jogjeostacionare që veprojnë në përputhje me Shtojcën 18.

Një përdorim i tillë i nënshtrohet marrëveshjes së marrë nën Nr. 9.21 në lidhje me shërbimet tokësore në Azerbajxhan, Bjellrusi, Kinë, Koreja (Rep. e), Kubë, Federata Ruse, Republika Arabe e Sirisë, Republika Popullore Demokratike e Koresë, Afrika e Jugut dhe Vietnam. (WRC-19)

5.528B Përdorimi i brezave të frekuencave 161.9625–161.9875 MHz and 162.0125–162.0375 MHz nga shërbimet fikse dhe të lëvizshme tokësore nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme, ose të kërkojnë mbrojtje nga shërbimi i lëvizshem detar. (WRC–12)

5.228C Përdorimi i brezave të frekuencave 161.9625–161.9875 MHz and 162.0125–162.0375 MHz nga shërbimi i lëvizshëm detar dhe shërbimi i lëvizshëm satelitor (tokë–hapësirë) është i kufizuar për sistemin e identifikimit automatik (AIS) duke përfshirë kerkimin AIS dhe transmetuesit e shpëtimit (AIS-SART) dhe pozicionimin e satelitëve të emergjencës që tregojnë farët me AIS (EPIRB-AIS). Përdorimi i këtyre brezave të frekuencave nga shërbimi i lëvizshëm aeronautik (OR) është i kufizuar për transmetimet AIS nga operacionet e kërkimit dhe shpëtimit të avioneve. Operacionet AIS, AIS-SART dhe AIS-EPIRB në këto breza frekuencash nuk do të kufizojnë zhvillimin dhe përdorimin e shërbimeve fikse dhe të lëvizshme që operojnë në brezat e frekuencave fqinje. (WRC-23)

5.228D Brezat e frekuencave 161.9625–161.9875 MHz (AIS 1) and 162.0125–162.0375 MHz (AIS 2) mund të vazhdojnë të përdoren në bazë parësore për shërbimet fikse dhe të lëvizshme deri në 1 Janar 2025, datë në të cilën ky përcaktim nuk do të jetë më i vlefshëm. Administratat inkurajohen të bëjnë të gjitha përpjekjet praktike për të ndërprerë përdorimin e këtyre brezave nga shërbimet fikse dhe të lëvizshme përpara datës së tranzicionit. Gjatë kësaj periudhe tranzicioni, shërbimet e lëvizshme detare në këto breza frekuencash kanë prioritet mbi shërbimet fikse, të lëvizshme tokësore dhe të lëvizshme aeronautike.

5.228E Përdorimi i sistemit automatik të identifikimit në brezat e frekuencave 161.9625–161.9875 MHz dhe 162.0125–162.0375 MHz nga shërbimi i lëvizshëm aeronautik (OR) është i kufizuar për stacionet e avionëve për qëllime të operacioneve të kërkimit dhe shpëtimit dhe komunikimeve të tjera që lidhen me sigurinë.

5.228F Përdorimi i brezave të frekuencave 161.9625–161.9875 MHz dhe 162.0125–162.0375 MHz nga shërbimi satelitor i lëvizshëm (tokë–hapësirë) është i kufizuar në marrjen e transmetimeve të sistemit të identifikimit automatik nga stacionet që operojnë në shërbimin e lëvizshëm detar. (WRC–12)

5.229

5.231 *Përcaktim shtesë*: Në Afganistan dhe Kinë, brezi 167–174 MHz është i përcaktuar gjithashtu për shërbimin radioteleviziv për përdorim parësorë. Futja e shërbimit radioteleviziv në këtë brez do të jetë subjekt marrëveshjeje me vendet fqinje të Rajonit 3, shërbimet e të cilave mund të afektohen. (WRC–12)

5.235 *Përcaktim shtesë:* Në Gjermani, Austri, Belgjikë, Danimarkë, Spanjë, Finlandë, Francë, Izrael, Itali, Lihtenshtejn, Maltë, Monako, Norvegji, Hollandë, Mbretëri e Bashkuar, Suedi dhe Zvicër, brezi 174–223 MHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e lëvizshëm në sterë. Megjithatë, stacionet e shërbimit të lëvizshëm në sterë nuk do të shkaktojnë interferenca të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet radiotelevizive,

ekzistuese ose të planifikuara, në vendet e tjera që nuk janë përmendur më sipër në këtë shënim.

5.246 *Përcaktim alternativ*: Në Spanjë, Francë, Izrael dhe Monako, brezi 223 –230 MHz është përcaktuar në bazë parësore për shërbimet radiotelevizive dhe të lëvizshëm në sterë (shih Nr. 5.33) bazuar në faktin që në përgatitjen e planeve të frekuencave shërbimi radioteleviziv të ketë zgjedhje prioritare të frekuencave dhe është përcaktuar në bazë dytësore për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm përveç i lëvizshëm në sterë. Megjithatë, stacionet e shërbimit të lëvizshëm në sterë nuk do të shkaktojnë interferencë të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet ekzistuese ose të planifikuar të radiotelevizionit në Marok dhe Algjeri.

5.247 *Përcaktim shtesë:* Në Arabinë Saudite, Bahrain, Emiratet e Bashkuara Arabe, Jordani, Oman, Katar dhe Rep Arabe e Sirisë, brezi 223–235 MHz është i përcaktuar gjithashtu për shërbimin e radionavigacionit aeronautik, për përdorim parësor.

5.251 *Përcaktim shtesë:* Në Nigeri, brezi 230–235 MHz është i përcaktuar gjithashtu për shërbimin e radionavigacionit aeronautik, për përdorim parësorë, subjekt marrëveshjeje përfituar në përputhje me pikën 9.21.

5.252 *Përcaktim alternativ:* Në Botsvanë, Esuatini, Lesoto, Malaui, Mozambik, Namibia, Afrika Jugore, Zambia dhe Zimbabve, brezat 230–238 MHz dhe 246–254 MHz janë përcaktuar për shërbimin radioteleviziv, për përdorim parësorë, subjekt marrëveshjeje të përfituar në përputhje me pikën 9.21. (WRC- 19)

5.254 Brezat 235–322 MHz dhe 335.4–399.9 MHz mund të përdoren nga shërbimi i lëvizshëm satelitor, objekt i marrëveshjes së arritur sipas pikes 9.21, me kusht që stacionet në këtë shërbim të mos shkaktojnë interferenca të dëmshme në shërbimet e tjera, që veprojnë ose janë planifikuar të veprojnë në përputhje me Tabelën e Përcaktimit të Frekuencave, përveç përcaktimeve shtesë që janë bërë në shënimin Nr. 5.256A. (WRC–03)

5.255 Brezat 312–315 MHz (Tokë–hapësirë) dhe 387–390 MHz (hapësirë–Tokë) në shërbimin e lëvizshëm satelitor mund të përdoren gjithashtu nga sistemet satelitore jo–gjeostacionare. Ky përdorim është objekt për koordinim në përputhje me pikën 9.11A.

5.256 Frekuenca 243 MHz është për përdorim nga stacionet e avionave të shpëtimit dhe për pajisjen që përdoret për qëllimet e shpëtimit. (WRC–07)

5.256A *Përcaktim shtesë:* në Kinë, Federatën Ruse, dhe Kazakistan, brezi i frekuencave 258–261 MHz është gjithashtu i përcaktuar për shërbimin e kërkimit hapësinor (Tokë–hapësirë) dhe shërbimit të operimit hapësinor (Tokë–hapësirë), për përdorim parësor. Stacionet në shërbimin e kërkimit hapësinor (Tokë–hapësirë) dhe shërbimit të operimit hapësinor (Tokë–hapësirë), nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme as të kërkojnë mbrojtje, dhe as të pengojnë përdorimin dhe zhvillimin e sistemeve të shërbimit të lëvizshëm dhe të sistemeve të shërbimit satelitor të lëvizshëm që operojnë në këtë brez frekuencash. Stacionet në shërbimin e kërkimit hapësinor (Tokë–hapësirë) dhe shërbimi i operimit hapësinor (Tokë–hapësirë), nuk duhet të pengojnë zhvillimin në të ardhmen të sistemeve të shërbimit fiks në vendet e tjera. (WRC–15)

5.257 Brezi 267 – 272 MHz mund të jetë përdorur nga administratat në bazë parësore për telemetrinë hapësinore në vendet e tyre, objekt për marreveshjen e arritur sipas pikës 9.21.

5.258 Përdorimi i brezit 328.6 – 335.4 MHz nga shërbimi i radionavigacionit aeronautik është kufizuar në Sistemet e Instrumentave Tokësore (rrugë e dritës).

5.259 *Përcaktim shtesë:* Në Egjipt dhe Republikën Arabe të Sirisë, brezi 328.6–335.4 MHz është përcaktuar gjithashtu për shërbimin e lëvizshëm, për përdorim dytësor, subjekt marrëveshjeje përfituar sipas pikës 9.21. Me qëllim që të sigurohet mos shkaktimi i interferencave të dëmshme në stacionet e shërbimit të radionavigacionit aeronautik, stacionet e shërbimit të lëvizshëm nuk duhet të futen në këtë brez deri sa ky brez të mos kërkohet më për shërbimin e radionavigacionit aeronautik, nga cilado administratë e cila mund të identifikohet si e afektuar nga aplikimi i procedurës në përputhje me pikën 9.21. (WRC–12)

5.260A Në brezin 399.9-400.05 MHz, maksimumi i e.i.r.p të çdo emisioni të stacioneve tokësore në shërbimin e lëvizshëm satelitor nuk duhet të kalojë 5 dBW në çdo brez 4 kHz dhe maksimimi i e.i.r.p të secilit stacion tokësor në shërbimin satelitor të lëvizshëm nuk duhet të kalojë 5 dBW në të gjithë brezin 399.9-400.05 MHz. Deri më 22 Nëntor 2022, ky limit nuk do të zbatohet për sistemet satelitore për të cilat janë marrë njoftime të plota nga Byroja e Radiokomunikimit deri më 22 Nëntor 2019 dhe që janë vënë në përdorim deri në atë datë. Pas 22 Nëntorit 2022, këto kufij do të zbatohen për të gjitha sistemet e shërbimit të lëvizshëm satelitor që veprojnë në këtë brez.

Në brezin 399.99-400.02 MHz, kufijtë e.i.r.p siç përcaktohen më larg do të zbatohen pas 22 Nëntorit 2022 për të gjitha sistemet brenda shërbimit të lëvizshëm satelitor. Kërkohet nga administratat që lidhjet e tyre satelitore të shërbimit satelitor të lëvizshëm në brezin 399.99-400.02 MHz përputhen me kufijtë e e.i.r.p siç përcaktohet më lart, pas 22 Nëntor 2019. (WRC-19)

5.260B Në brezin 400.02-400.05 MHz, dispozitat e Nr. 5.206A nuk janë të zbatueshme për telekomandimin e uplink-ut brenda shërbimit të lëvizshëm satelitor. (WRC-19)

5.261 Emetimet do të kufizohen në një diapazon ± 25 kHz rreth frekuencës standarte 400.1 MHz.

5.262 *Përcaktim shtesë:* Në Arabinë Saudite, Armeni, Azerbajxhan, Bahrein, Bjellorusi, Botsvana, Kolumbi, Kubë, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Ekuador, Federatën Ruse, Gjeorgji, Hungari, Republikën Islamike të Iranit, Irak, Izrael, Jordani, Kazakistan, Kuvajt, Liberi, Malajzi, Moldavi, Oman, Uzbekistan, Pakistan, Filipine, Katar, Republikën Arabe të Sirisë, Kirgistan, Singapor, Somali, Taxhikistan, Çad, Turkmenistan dhe Ukrainë, brezi 400.05–401 MHz është i përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimet fikse dhe të lëvizshme. (WRC– 12)

5.263 Brezi 400.15–401 MHz është gjithashtu i përcaktuar për shërbimin e kërkimeve hapësinore në drejtimin hapësirë–hapësirë për komunikimin me mjetet kryesore hapësinore. Në këtë aplikim, shërbimi i kërkimit hapësinor nuk do të shqyrtohet si shërbim sigurie.

5.264 Përdorimi i brezit 400.15–401 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor është objekt koordinimi nën pikën 9.11A. Kufiri i fuqisë së densitetit të fluksit, treguar në Aneksin 1 të Shtojcës 5, të zbatohet deri në rishikimin e saj nga një konferencë botërore kompetetente për radiokomunikacionet.

5.264A Në brezin 401-403 MHz maksimumi e.i.r.p i çdo emisioni të secilit stacion tokësor në shërbimin meteorologjik-satelitor dhe shërbimin satelitor të eksplorimit të Tokës nuk duhet të kalojë 22 dBW në çdo brez 4 kHz për sistemet satelitore gjeostacionare dhe sistemet jo-gjeostacionare-satelitore me një orbitë nëtë apogjeut të barabartë ose më të madhe se 35 786 km.

Maksimumi e.i.r.p. i çdo emisioni të secilit stacion tokësor në shërbimin meteorologjik-satelitor dhe shërbimin satelitor të eksplorimit të tokës nuk duhet të kalojë 7 dBW në çdo brez 4 kHz për sistemet satelitore jo-gjeostacionare me një orbitë ntë apogjeut më të ulët se 35 786 km.

Maksimumi e.i.r.p. të secilit stacion tokësor në shërbimin meteorologjik-satelitor dhe shërbimin satelitor të eksplorimit të Tokës nuk duhet të kalojë 22 dBW për sistemet satelitore gjeostacionare dhe sistemet satelitore jo-gjeostacionare me një orbitë ntë apogjeve të barabartë ose më të madhe se 35 786 km në të gjithë brezin 401-403 MHz. Maksimumi e.i.r.p. të çdo stacion tokësor në shërbimin meteorologjik-satelitor dhe shërbimin satelitor të eksplorimit të Tokës nuk duhet të kalojë 7 dBW për sistemet satelitore jo-gjeostacionare me një orbitë të apogje më të ulët se 35 786 km në të gjithë brezin 401-403 MHz.

Deri më 22 nëntor 2029, këto kufij nuk do të zbatohen për sistemet satelitore për të cilat informacioni i plotë i njoftimit është marrë nga Byroja e Radiokomunikimit deri më 22 Nëntor 2019 dhe ato janë vënë në përdorim deri në atë datë. Pas 22 Nëntorit 2029, këto kufij do të zbatohen për të gjitha sistemet brenda shërbimit meteorologjik-satelitor dhe shërbimit satelitor të eksplorimit të Tokës që veprojnë në këtë brez. (WRC-19)

5.264B Sistemet satelitore jo-gjeostacionare në shërbimin meteorologjik-satelitor dhe shërbimin satelitor të eksplorimit të Tokës për të cilin informacioni i plotë i njoftimit është marrë nga Byroja e Radiokomunikimit jo më vonë se 28 Prill 2007 janë përjashtuar nga dispozitat e Nr. 5.264A dhe mund të vazhdojnë të funksionojnë në brezin e frekuencave 401.898-402.522 MHz në përdorim parësor pa e tejkaluar një nivel maksimum të e.i.r.p. prej 12 dBW. (WRC-23)

5.265 Në brezin e frekuencave 403–410 MHz, aplikohet rezoluta 205 (Rev. WRC–19) (WRC–19)

5.266 Përdorimi i brezit 406–406.1 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor është kufizuar në sinjalizimet satelitore emergjente të tregimit të pozicionit me fuqi të ulët (shih gjithashtuNenin 31). (WRC–07)

5.267 Është e ndaluar çdo mundësi emetimi i interferencave të dëmshme shkaktuar nga përdoruesit e pa autorizuar në brezin 406–406.1 MHz.

5.268 Përdorimi i brezit 410 – 420 MHz nga shërbimi i kërkimeve hapësinore është kufizuar për lidhjet e komunikimit hapësirë–hapësirë nga një orbit e një anije kozmike. Fuqia e densitetit të prurjeve në sipërfaqen e Tokës të prodhuar nga rrezatimet nga stacionet transmetuese të shërbimit kërkimor të hapësirës (hapësirë–hapësirë) në brezin e frekuencave 410–420 MHz nuk duhet të

tejkalojë vlerën prej –153 dB (W/m2) për 0° ≤ δ≤ 5°, –153 + 0.077 (δ – 5) dB(W/m2) për 5° ≤ δ ≤ 70° dhe –148 dB(W/m2) për 70° ≤ δ ≤ 90°, ku δ është këndi i arritjes të valës së radio–frekuencës dhe brezi referues është 4 kHz. Në këtë brez frekuencash, stacionet e shërbimit të kërkimit hapësinor (hapësirë–hapësirë) nuk duhet të kërkojnë mbrojtje dhe as të pengojnë përdorimin dhe zhvillimin e stacioneve të shërbimit fiks dhe të lëvizshëm. Nr. 4.10 nuk aplikohet. (WRC–15)

5.269 *Kategori të ndryshme shërbimi*: Në Australi, Brazil, Shtetet e Bashkuara, Indi, Japoni dhe Mbretërinë e Bashkuar, përcaktimi i brezave te frekuencave 420–430 MHz dhe 440–450 MHz në shërbimin e radiovendndodhjes është në bazë parësore (shih Nr. 5.33). (WRC-23)

5.271 *Përcaktim shtesë:* Në Bjellorusi, Kinë, Indi, Kirgistan dhe Turkmenistan, brezi 420–460 MHz është i përcaktuar gjithashtu në bazë dytësore për shërbimin e radionavigacionit aeronautik (radiomatës lartësie). (WRC–07)

5.274 *Përcaktim alterntiv*: Në Danimark, Norvegji, Suedi dhe Çad, brezat 430–432 MHz dhe 438–440 MHz janë përcaktuar në bazë parësore për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. (WRC– 12)

5.275 *Përcaktim shtesë*: Në Kroaci, Estoni, Finland, Libi, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi dhe Serbi, brezat e frekuencave 430–432 MHz dhe 438–440 MHz janë gjithashtu të përcaktuar në bazë parësore për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. (WRC–19)

5.276 *Përcaktim shtesë*: Në Afganistan, Algjeri, Arabi Saudite, Bahrain, Bangladesh, Brunei Darusalam, Burkina Faso, Xhibuti, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Ekuador, Eritrea, Etiopi, Greqi, Guinea, Indi, Indonezi, Republikën Islamike të Iranit, Irak, Izrael, Itali, Jordani, Kenia, Kuvait, Libi, Malajzi, Niger, Nigeri, Oman, Pakistan, Filipine, Katar, Siri, Republikën Popullore Demokratike të Kores, Singapor, Somali, Sudan, Zvicër, Tajland, Togo, Turqi dhe Jemen, brezi i frekuencave 430–440 MHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin fiks dhe brezat e frekuencave 430–435 MHz dhe 438–440 MHz janë gjithashtu të përcaktuar, përveç në Ekuador, në bazë parësore për shërbimin e lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. (WRC– 15)

5.277 *Përcaktim shtesë*: Në Angola, Armeni, Azerbajxhan, Belarusi, Kamerun, Kongo (Rep. e), Xhibuti, Federatën Ruse, Gjeorgji, Hungari, Izrael, Kazakistan, Mali, Uzbekistan, Poloni, Republika Demokratike e Kongos, Kirgistan, Sllovaki, Rumani, Ruandë, Taxhikistan, Çad, Turkmenistan dhe Ukrainë, brezi 430–440 MHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin fiks. (WRC– 12)

5.279A Përdorimi i brezit të frekuencave 432–438 MHz nga sensorët në shërbimin e eksplorimeve tokësore– satelitore (aktive), duhet të jetë në përputhje me Rekomandimin e ITU R RS.1260–

2. Si shtesë, shërbimi i eksplorimeve tokësore–satelitore (aktive) në brezin e frekuencave 432–438 MHz nuk duhet të shkaktojë interferenca të dëmshme ndaj shërbimit të radionavigacionit aeronautik në Kinë. Kushtet e këtij shënimi nuk e zvogëlojnë detyrimin e shërbimit të eksplorimeve tokësore–satelitore (aktive) të operojë si një shërbim dytësor në përputhje me Nr. 5.29 dhe 5.30. (WRC–19)

5.280	Në Gjermani, Austri, Bosnje–Hercegovinë, Kroaci, Maqedonia e Veriut, Lihtenshtein, Portugali, Serbi, Mali i Zi, Slloveni dhe Zvicër, brezi 433.05–434.79 MHz (frekuenca qendrore 433.92 MHz) është përcaktuar për zbatimet industriale, shkencore dhe shëndetësore (ISM). Shërbimet e radiokomunikimit të këtyre vendeve, që operojnë brenda këtij brezi duhet t'i pranojnë interferencat e dëmshme, që mund të shkaktohen nga këto aplikime. Pajisjet ISM që veprojnë në këtë brez janë objekt i përcaktimeve të nenit Nr.15.13. (WRC–19)
5.281	Përcaktim shtesë: Në Territoret Franceze në Rajonin 2 dhe Indi, brezi 433.75–434.25 MHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e veprimeve hapësinore (Tokë–hapësirë). Në Francë dhe në Brazil, brezi është përcaktuar në bazë dytësore për të njëjtin shërbim.
5.282	Në brezat 435–438 MHz, 1260–1270 MHz, 2400–2450 MHz, 3400–3410 MHz (vetëm në Rajonet 2 dhe 3) dhe 5650–5670 MHz, shërbimi amator satelitor mund të operojë me kusht që të mos shkaktojë interferenca të dëmshme në shërbimet e tjera që operojnë në përputhje me Tabelën (shih Nr. 5.43). Administratat që autorizojnë një përdorim të tillë do të sigurojnë që ndonjë interferencë e dëmshme shkaktuar nga emëtimet e ndonjë stacioni të shërbimit amator–satelitor të jetë menjëherë i eleminueshëm në përputhje me kërkesat e Nr.25.11. Përdorimi i brezave 1260–1270 MHz dhe 5650–5670 MHz nga shërbimi amator– satelitor është kufizuar në drejtimin Tokë–hapësirë.
5.283	*Përcaktim shtesë:* Në Austri brezi 438–440 MHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore, për shërbimet fiksdhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik.
5.286	Brezi 449.75–450.25 MHz mund të jenë përdorur për shërbimin e veprimeve hapësinore (Tokë–hapësirë) dhe shërbimin e kërkimeve hapësinore (Tokë–hapësirë), objekt për marrëveshjen e arritur sipas pikës Nr.9.21.
5.286A	Përdorimi i brezave 454–456 MHz dhe 459–460 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor është objekt për koordinimim sipas pikes Nr.9.11A. (WRC–97)
5.286AA	Brezi i frekuencave 450–470 MHz është identifikuar për përdorim nga administratat që dëshirojnë të implementojnë shërbimet e Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Shih Rezolutën 224 (Rev.WRC–19). Ky idenfikim nuk pengon përdorimin e këtij brezi frekuencash nga ndonjë aplikim i shërbimeve për të cilat është caktuar dhe nuk përcakton prioritet në Rregulloret Radio. (WRC–19)
5.286B	Përdorimi i brezit 454–455 MHz në vendet sipas listës tek Nr. 5.286D, 455–456 MHz dhe 459–460 MHz në Rajonin 2,454–456 MHz dhe 459–460 MHz në vendet sipas listës tek Nr. 5.286 E nga stacionet e shërbimit të lëvizshëm satelitor, nuk do të shkaktojnë interferencë të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e shërbimeve fiks ose të lëvizshëm, të cilët operojnë në përputhje me Tabelën e Përcaktimit të Frekuencave. (WRC–97)
5.587	Përdorimi i brezit të frekuencave 457.5125–457.5875 MHz dhe 467.5125–467.5875 MHz nga shërbimi i lëvizshëm detar është kufizuar nga stacionet e komunikimit në bord. Karakteristikat e pajisjeve dhe marrëveshjeve të kanaleve duhet të përputhen me specifikimet e dhëna në Rekomandimet ITU–

R M.1174–3. Përdorimi i këtyre frekuencave në territoret ujore është objekt për rregullim kombëtar të administratave përkatëse. (WRC–19)

5.289 Zbatimet e shërbimit satelitor për eksplorimin e tokës, ndryshe nga shërbimi satelitor meteorologjik, mund të përdoren gjithashtu në brezat 460 – 470 MHz dhe 1690–1710 MHz për transmetimet hapësirë–tokë, me kusht që të mos shkaktojnë interferenca të dëmshme në stacionet që operojnë në përputhje me Tabelën.

5.290 *Kategori të ndryshme shërbimi*: Në Afganistan, Azerbajxhan, Bjellorusi, Kinë, Federatën Ruse, Kirgistan, Taxhikistan dhe Turkmenistan, përcaktimi i brezit 460–470 MHz për shërbimin satelitor meteorologjik (hapësirë–tokë) është në bazë parësore (shih Nr.5.33), objekt i marrëveshjes së arritur sipas pikës 9.21 (WRC– 12).

5.291A *Përcaktim shtesë*: Në Gjermani, Austri, Danimark, Estonia, Lihtenshtein, , Serbi dhe Zvicër brezi i frekuencave 470–494 MHz është gjithashtu i përcaktuar për shërbimin e radiovendndodhjes në një bazë dytësore. Ky përdorim është i kufizuar për operimin e radareve për matjen e profilit të erërave në përputhje me Rezolutën 217 (Rev. WRC–23). (WRC–23)

5.293 Kategori të ndryshme shërbimi: në Kanada, Kili, Kubë, Shtetet e Bashkuara, Guajana dhe Panama, caktimi i brezave të frekuencave 470-512 MHz dhe 614-806 MHz për shërbimin fiks është në bazë parësore (shih Nr. 5.33), subjekt i marrëveshjes së marrë sipas Nr. 9.21. Në Bahamas, Barbados, Kanada, Kili, Kubë, Shtetet e Bashkuara, Guajana, Xhamajka, Meksikë dhe Panama, caktimi i brezave të frekuencave 470-512 MHz dhe 614-698 MHz për shërbimin e lëvizshëm është mbi bazëprimare (shih Nr. 5.33), subjekt i marrëveshjes së marrë sipas Nr. 9.21 Në Argjentinë dhe Ekuador, caktimi i brezit të frekuencave 470-512 MHz për shërbimet fikse dhe të lëvizshme është në bazë primare (shih Nr. 5.33), subjekt i marrëveshjes së marrë sipas Nr 9.21. (WRC-23)

5.294 *Përcaktim shtesë*: Në Arabi Saudite, Kamerun, Bregu i Fildishtë, Egjipt, Etiopi, Izrael, Libi, Palestinë*, Republikën Arabe të Sirisë, Çad dhe Jemen, brezi i frekuencave 470 – 582 MHz është përcaktuar gjithashtu për përdorim dytësor për shërbimin fiks. (WRC–23).

5.295A Përcaktim shtesë: në Shqipëri, Gjermani, Andora, Austri, Belgjikë, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Qipro, Vatikan, Kroaci, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjeorgji, Greqi, Hungari, Irlandë, Islandë, Letoni, Lihtenshtajn , Lituania, Luksemburgu, Maqedonia e Veriut, Malta, Moldavia, Monako, Mali i Zi, Norvegjia, Uzbekistani, Mbretëria e Holandës, Polonia, Portugalia, Turqia, Sllovakia, Republika Çeke, Rumania, Mbretëria e Bashkuar, San Marino, Serbia, Sllovenia, Suedia, Zvicra dhe Ukraina, brezi i frekuencave 470-694 MHz i caktohet shërbimit të lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik, në baza dytësore, subjekt i marrëveshjes së marrë sipas Nr 9.21. Për mbrojtjen e shërbimit radioteleviziv, stacionet në shërbimin e lëvizshëm nuk duhet të krijojnë fuqinë e fushës për më shumë se 1% të kohës në lartësinë më të lartë të ndërhyrjes ose 10 m mbi nivelin e tokës në kufirin e territorit të çdo administrate tjetër që tejkalon vlerën e fuqisë së fushës siç llogaritet duke përdorur § 4.1.3.2 të Aneksit 2 të Marrëveshjes GE06 në lidhje me lejimin për interferenca të shumëfishta, Tabela A.1.10 dhe metodologjinë e dhënë në Marrëveshjen GE06. Këto kufij mund të tejkalohen në territorin e çdo vendi, administrata e të cilit ka rënë dakord. Kjo ndarje në asnjë mënyrë nuk do të

ndikojë negativisht në zhvillimin radioteleviziv ose të dëmtojë hyrjet e reja të shërbimit të radioteleviziv sipas planit GE06. (WRC-23)

5.296 *Përcaktim shtesë:* Në Shqipëri, Algjeri, Gjermani, Angolë, Arabi Saudite, Austri, Bahrein, Belgjikë, Benin, Bosnje – Hercegovinë, Botsvana, Bullgari, Burkina Fazo, Burundi, Kamerun,Vatikan, Kongo (Republikë e), Bregu i Fildishtë, Kroaci, Danimarkë, Xhibuti, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Spanjë, Estoni, Esuatini, Finlandë, Francë, Gabon, Gjeorgji, Gana, Hungari, Irak, Irlandë, Island, Izrael, Itali, Jordani, Kenia, Kuvait, Lesoto, Letoni, Liban, Libi, Lihtenshtajn, Lituani, Luksemburg, Maqedonia e Veriut, Malaui, Mali, Maltë, Marok, Maurisius, Mauritania, Moldavi, Monako, Mozambik, Namibi, Niger, Nigeria, Norvegji, Oman, Ugandë, Palestinë*, Hollandë, Poloni, Portugali, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Sllovaki, Republika Çeke, Rumani Mbretërinë e Bashkuar, Ruandë, San Marino, Senegal, Serbi, Sudan, Afrika e Jugut, Suedi, Zvicër, Tanzani, Çad, Togo, Tunizi, Turqi, Ukrainë, Zambia dhe Zimbabve, brezi 470–694 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë dytësore për shërbimin e lëvizshëm tokësor, parashikuar për zbatime ndihmëse për shërbimin radioteleviziv dhe blerjen e programeve. Stacionet e shërbimit të lëvizshëm tokësor, në vendet e renditura në këtë shënim nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme në stacionet e planifikuara ose ekzistuese, që operojnë në përputhje me Tabelën e Përcaktimit të Frekuencave në vendet që nuk përmenden në këtë shënim. (WRC– 23).

* Në bazë të Rezolutës 99 (Rev. Dubai, 2018) të Konferencës Fuqiplotë dhe duke marrë parasysh Marrëveshjen e Përkohshme Izraelito-Palestineze të 28 shtatorit 1995.

5.296A Në Mikronezi, Ishujt Solomon, Tuvalu dhe Vanuatu, brezi i frekuencave 470-698 MHz, ose pjesë të tij, dhe në Bangladesh, Lao P.D.R., Maldive, Zelandën e Re dhe Vietnam, brezi i frekuencave 610-698 MHz, ose pjesë të tij janë identifikuar për përdorim nga këto administrata që dëshirojnë të zbatojnë Telekomunikacionin Ndërkombëtar Të lëvizshëm (IMT) - shih Rezolutën 224 (Rev.WRC-23). Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtyre brezave të frekuencave nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u janë caktuar dhe nuk vendos përparësi në Radio Rregulloret. Përcaktimi i lëvizshëm në këtë brez frekuencash nuk do të përdoret për sistemet IMT përveç rasteve kur i nënshtrohet marrëveshjes së marrë sipas Nr. 9.21 dhe nuk duhet të shkaktojë interferenca të dëmshme ose të kërkojë mbrojtje nga shërbimi radioteleviziv i vendeve fqinje. Aplikohet Nr. 5.43 dhe 5.43A. (WRC-23)

5.300 *Përcaktim shtesë:* Në Arabi Saudite, Kamerun, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Irak, Israel, Jordani, Libi, Oman, Palestinë *, Katar, Republikën Arabe të Sirisë dhe Sudan, brezi i frekuencave 582–790 MHz është përcaktuar gjithashtu për përdorim dytësor, për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. (WRC–23)

5.304 *Përcaktim shtesë:* Në zonën Afrikane të transmetimeve radiotelevizive (shih nga pika 5.10 deri në 5.13), brezi 606–614 MHz është i përcaktuar gjithashtu për përdorim parësorë dhe për shërbimin radio astronomi.

5.306 *Përcaktim shtesë*: Në Rajonin 1, me përjashtim të Zonës Afrikane të transmetimeve radiotelevizive (shih Nr. 5.10 deri në 5.13) dhe në Rajonin 3,

brezi 608–614 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë dytësore për shërbimin e radioastronomisë.

5.307A Përcaktim shtesë: në Arabinë Saudite, Bahrein, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Irak, Jordani, Kuvajt, Oman, Palestinë*, Katar dhe Republikën Arabe Siriane, brezi i frekuencave 614-694 MHz i është caktuar në bazë primare shërbimit të lëvizshëm, përveç i lëvizshëm aeronautik, dhe i identifikuar për Telekomunikacionin e Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT) – shih Rezolutën 224 (Rev.WRC-23) që i nënshtrohet marrëveshjes së marrë sipas Nr. 9.21. Stacionet në shërbimin e lëvizshëm nuk duhet të krijojnë fuqinë e fushës për më shumë se 1% të kohës në lartësinë më të lartë të ndërhyrjes ose 10 m mbi nivelin e tokës në kufirin e territorit të çdo administrate tjetër që tejkalon vlerën e fuqisë së fushës siç llogaritet duke përdorur § 4.1.3.2 të Aneksit 2 të Marrëveshjes GE06 në lidhje me lejimin për ndërhyrje të shumëfishta, Tabelën A.1.10 dhe metodologjinë e dhënë në Marrëveshjen GE06. Stacionet në shërbimin e lëvizshëm të vendeve të listuara në këtë shënim nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet ekzistuese dhe të ardhshme të transmetimit të vendeve fqinje që operojnë në përputhje me planin GE06. Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtyre brezave të frekuencave nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u janë caktuar dhe nuk vendos prioritet në Radio Rregulloret dhe në asnjë mënyrë nuk do të ndikojë negativisht në zhvillimin e shërbimit ekzistues dhe të ardhshëm radioteleviziv në përputhje me Marrëveshjen GE06. Për vendet palë në Marrëveshjen GE06, përdorimi i stacioneve në shërbimin e lëvizshëm është gjithashtu subjekt i zbatimit të suksesshëm të procedurave të asaj Marrëveshjeje. Ky përcaktim nuk përcakton prioritet në Radio Rregulloret dhe do të lejojë zbatimin dhe zhvillimin e shërbimit të transmetimit në përputhje me Marrëveshjen GE06. Vendet e listuara në këtë shënim dhe të vendosura në Zonën e Transmetimeve Afrikane duhet të sigurojnë mbrojtjen e shërbimit të radioastronomisë brenda brezit të frekuencave 606-614 MHz, siç përcaktohet në Nr. 5.304, në përputhje me versionin më të fundit të Rekomandimit ITU-R RA.769. Vendet e listuara në këtë shënim, të cilat janë fqinje me vendet e renditura në Nr. 5.312, duhet të sigurojnë mbrojtjen e shërbimit të radionavigacionit aeronautik në brezin e frekuencave 645-862 MHz. (WRC-23).

* Në bazë të Rezolutës 99 (Rev. Dubai, 2018) të Konferencës Fuqiplotë, dhe duke marrë parasysh Marrëveshjen e Përkohshme Izraelito-Palestineze të 28 shtatorit 1995.

5.307B Pëcaktim shtesë: në Gambi, Mauritani, Namibi, Nigeri, Senegal, Somali, Tanzani dhe Çad, brezi i frekuencave 614-694 MHz është përcaktuar për shërbimin e lëvizshëm në bazë dytësore. Për mbrojtjen e shërbimit radioteleviziv, stacionet në shërbimin e lëvizshëm nuk duhet të krijojnë fuqinë e fushës për më shumë se 1% të kohës në lartësinë më të lartë të ndërhyrjes ose 10 m mbi nivelin e tokës në kufirin e territorit të çdo administrate tjetër që tejkalon vlerën e fuqisë së fushës siç llogaritet duke përdorur § 4.1.3.2 të Aneksit 2 të Marrëveshjes GE06 në lidhje me lejimin për interferenca të shumëfishta, Tabela A.1.10 dhe metodologjia e dhënë në Marrëveshjen GE06. Ky përcaktim në asnjë mënyrë nuk do të ndikojë negativisht në zhvillimin e radioteleviziv ose nuk do të dëmtojë hyrjet e reja të shërbimit të radioteleviziv në planin GE06. Masa shtesë do të përdoren nga administratat që zbatojnë stacionet në shërbimet e lëvizshëm për të mbrojtur stacionet në shërbimin e radioteleviziv të administratave fqinje, si p.sh. kufizimi i distancës nga kufiri i një vendi fqinj.

5.308	Kategori të ndryshme shërbimi: në Belize, Kolumbi, El Salvador dhe Guatemalë, brezi i frekuencave 614-698 MHz i përcaktohet shërbimit të lëvizshëm në bazë parësore. Stacionet e shërbimit të lëvizshëm brenda brezit të frekuencave i nënshtrohen marrëveshjes së marrë sipas Nr. 9.21. (WRC-23)
5.308A	Në Bahamas, Barbados, Belize, Kanada, Kolumbi, El Salvador, Shtetet e Bashkuara, Guatemalë, Xhamajka dhe Meksikë, brezi i frekuencave 614-698 MHz, ose pjesë të tij, është identifikuar për Telekomunikacionin e Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT) - shih Rezolutën 224 (Rev.WRC-23). Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtyre brezave të frekuencave nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u janë caktuar dhe nuk vendos përparësi në Radio Rregulloret. Stacionet e shërbimit të lëvizshëm të sistemit IMT brenda brezit të frekuencave janë subjekt i marrëveshjes së marrë sipas Nr. 9.21 dhe nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga shërbimi radioteleviziv i vendeve fqinje. Zbatohet Nr. 5.43 dhe 5.43A. (WRC-23)
5.311A	Për brezin 620-790 MHz, shih gjithashtu Rezolutën 549 (WRC-07)
5.312	*Përcaktim shtesë:* Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Federatën Ruse, Gjeorgji, Kazakistan, Uzbekistan, Kirgizstan, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Ukrainë, brezi i frekuencave 645 – 862 MHz, dhe në Bullgari brezat e frekuencave , 726–753 MHz, 778–811 MHz dhe 822–852 MHz, janë përcaktuar gjithashtu për përdorim parësor për shërbimin e radionavigacionit aeronautik. (WRC– 23)
5.312A	Në Rajonin 1, përdorimi i brezit të frekuencave 694–790 MHz nga shërbimi i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik, është subjekt në dispozitat e Rezolutës 760 (WRC– 23). Shih gjithashtu Rezolutën 224 (Rev.WRC– 23). (WRC–23)
5.312B	Brezi i frekuencës 698-960 MHz, ose pjesë të tij, në Rajonin 2, dhe brezi i frekuencave 694-960 MHz, ose pjesë të tij, në Rajonin 1, identifikohen për përdorim nga stacionet e platformës në lartësi të lartë si stacionet bazë (HIBS) të Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtyre brezave të frekuencave nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u janë caktuar dhe nuk vendos përparësi në Radio Rregulloret. Rezoluta 213 (WRC-23) do të zbatohet. HIBS nuk do të kërkojë mbrojtje nga shërbimet primare ekzistuese. Nr. 5.43A nuk zbatohet, shikoni vendimin 2 të Rezolutës 213 (WRC-23). Një përdorim i tillë i HIBS në brezat e frekuencave 694-728 MHz, 830-835 MHz dhe 805.3-806.9 MHz është i kufizuar në marrje nga HIBS. (WRC-23)
5.314A	Brezi i frekuencave 698-960 MHz, ose pjesë të tij, në Australi, Maldive, Mikronezi, Papua Guinea e Re, Tonga dhe Vanuatu, dhe brezat e frekuencave 703-733 MHz, 758-788 MHz, 890-915 MHz dhe 935-960 MHz, ose pjesë të tyre, në Kinë, Indi, Indonezi, Japoni, Kore (Rep. e), Malajzi, Filipine dhe Tajlandë janë identifikuar për përdorim nga stacionet e platformës në lartësi të lartë si stacionet bazë (HIBS) të Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtyre brezave të frekuencave nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u janë caktuar dhe nuk vendos përparësi në Radio Rregulloret. Rezoluta 213 (WRC-23) do të zbatohet. HIBS nuk do të kërkojë mbrojtje nga shërbimet primare ekzistuese. Nr. 5.43A nuk zbatohet, shiko vendimin 2 të Rezolutës 213

(WRC-23). Një përdorim i tillë i HIBS në brezat e frekuencave 698-728 MHz dhe 830-835 MHz është i kufizuar në marrje nga HIBS. (WRC-23)

5.316B Në Rajonin 1, përcaktimi për shërbimin e lëvizshëm, përveç i lëvizshëm aeronautik, në brezin e frekuencave 790–862 MHz është subjekt i arritjes së marrëveshjes sipas pikës Nr. 9.21 në lidhje me shërbimin e radionavigacionit aeronautik në vendet e përmendura në shënimin Nr. 5.312. Për vendet që janë pjesë e marrëveshjes GE06, përdorimi i stacioneve të shërbimit të lëvizshëm është gjithashtu subjekt i aplikimeve të suksesshme të procedurave të kësaj Marrëveshjeje. Rezolutat 224 (Rev.WRC-23) dhe 749 (Rev.WRC–23) do të aplikohen sipas rastit. (WRC– 23).

5.317A Pjesë të brezit të frekuencave 698–960 MHz në Rajonin 2, dhe brezat e frekuencave 694–790 MHz në Rajonin 1 dhe 790–960 MHz në Rajonin 1 dhe 3 të cilat janë përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e lëvizshëm, janë identifikuar për përdorim nga administratat që duan të implementojnë shërbimet e Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT) – shih Rezolutat 224 (Rev.WRC–23), 760 (Rev.WRC–23) dhe 749 (Rev.WRC–23), sipas nevojës. Ky identifikim nuk pengon përdorimin e këtyre brezave frekuencore nga çdo aplikim i shërbimeve të cilëve u është përcaktuar dhe nuk vendos prioritete në Rregulloret Radio. (WRC– 23)

5.319 *Përcaktim shtesë*: Në Bjellorusi, Rusi dhe Ukrainë, brezat 806–840 MHz (Tokë– hapësirë) dhe 856–890 MHz (hapësirë–Tokë) janë gjithashtu të përcaktuar për shërbimin e lëvizshëm satelitor, përveç shërbimit të lëvizshëm satelitor aeronautik (R). Përdorimi i këtyre brezave nga ky shërbim nuk do të shkaktojë interferenca të dëmshme ose të kërkojë mbrojtje nga shërbimet në vendet e tjera që operojnë në përputhje me Tabelën e Përcaktimit të Frekuencave dhe është objekt për marrëveshje speciale përmes administratave përkatëse.

5.322 Në Rajonin 1, në brezin 862–960 MHz, stacionet e shërbimit radioteleviziv do të operojnë vetëm në Zonën Afrikane të transmetimeve radiotelevizive (shih Nr. 5.10 deri 5.13) përjashtuar Algjerinë, Burundin, Xhibutin, Egjyptin, Spanjën, Lesoto, Libi, Marok, Malaui, Namibi, Nigeri, Afrika Jugore, Tanzani, Zimbabve dhe Zambia, objekt i marrëveshjes së arritur sipas pikës Nr. 9.21. (WRC– 23)

5.323 *Përcaktim shtesë:* Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Federatën Ruse, Kazakistan, Uzbekistan, Kirgizstan, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Ukrainë, brezi 862 – 960 MHz, në Bullgari brezat 862– 880 MHz and 915–925 MHz, dhe në Rumani brezat 862–880 MHz dhe 915–925 MHz, janë përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin e radionavigacionit aeronautik. Ky përdorim është objekt i marrëveshjes së arritur nën 9.21, me administratat përkatëse dhe i kufizuar për sinjalet radio tokësore që operojnë që nga data 27 tetor 1997 e deri në fund të ekzistencës së tyre. (WRC– 19)

5.325A

Kategori të ndryshme shërbimi: në Argjentinë, Brazil, Kosta Rika, Kubë, Republikën Domenikane, El Salvador, Ekuador, departamentet dhe komunitetet Franceze jashtë shtetit në Rajonin 2, Guatemala, Paraguaj, Uruguai dhe Venezuelë, brezi i frekuencës 902-928 MHz i caktohet shërbimit të lëvizshëm tokësor mbi bazën primare. Në Meksikë, brezi i frekuencave 902-928 MHz i përcaktohet mbi bazë primare shërbimit të lëvizshëm, përveç i lëvizshëm aeronautik. Në Kolumbi, brezi i frekuencave 902-915 MHz i përcaktohet shërbimit të lëvizshëm tokësor mbi bazën primare. (WRC-23)

5.327A Përdorimi i brezit të frekuencave 960–1164 MHz nga shërbimi i lëvizshëm aeronautik (R) është i kufizuar për sistemet që veprojnë në përputhje me standartet e njohura ndërkombëtare aeronautike. Një përdorim i tillë do të jetë në përputhje me rezolutën 417 (Rev. WRC–15). (WRC–15)

5.328 Brezi 960–1215 MHz është rezervuar në një bazë mbarë botërore për përdorimin dhe zhvillimin e ndihmave elektronike të avionëve të navigacionit ajror dhe të çdo pajisje tokësore që lidhet direkt me to. (WRC–2000)

5.328A Stacionet në shërbimin e radionavigacionit satelitor në brezin 1164–1215 MHz duhet të veprojnë në përputhje me përcaktimet e Rezolutës 609 (Rev.WRC–07) dhe s'duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet në shërbimin e radionavigacionit aeronautik në brezin 960– 1215 MHz. Nr. 5.43A nuk aplikohet. Përcaktimi i Nr. 21.18 duhet të aplikohet. (WRC–07)

5.328AA Brezi i frekuencave 1087.7–1092.3 MHz është përcaktuar gjithashtu për përdorim parësor, për shërbimin i lëvizshëm aeronautik –satelitor (R) (Tokë–hapësirë), i limituar në marrje të stacionit hapësinor të rrezatimit Automatic Dependent Surveillance–Broadcast (ADS–B) nga transmetimi i avionëve të cilët operojnë në përputhje me njohjen e standarteve ndërkombëtare të aeronautikës. Stacionet që operojnë në shërbimin i lëvizshëm aeronautik – satelitor (R) nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet që operojnë në shërbimet e radionavigimit aeronautik. Rezoluta 425 (WRC–19) mund të aplikohet. (WRC–19)

5.328B Përdorimi i brezave 1164–1300 MHz, 1559–1610 MHz dhe 5010–5030 MHz nga sistemet dhe rrjetet në shërbimin e radionavigacionit satelitor për çdo koordinim të kompletuar ose informacion njoftimi, siç është caktuar, që është pranuar nga Zyra e Radiokomunikimeve pas datës 1 Janar 2005, është objekt për aplikimin e përcaktimeve të Nr. 9.12, 9.12A dhe 9.13. Rezoluta 610 (WRC–03) duhet të aplikohet gjithashtu. (WRC–03); Megjithatë në rastin e shërbimit të radionavigacionit–satelitor (hapësirë–hapësirë), rrjeteve dhe sistemeve, rezoluta 610 (WRC–03) duhet të aplikohet vetëm për stacionet hapësinore transmetuese. Në përputhje me nr. 5.329A, për sistemet dhe rrjetet e shërbimit të radionavigacionit– satelitor (hapësirë–hapësirë) në brezat 1215–1300 MHz dhe 1559–1610 MHz, dispozitat 9.7, 9.12, 9.12A dhe 9.13 duhet të aplikohen vetëm në përputhje me sistemet dhe rrjetet e tjera të shërbimit të radionavigacionit–satelitor (hapësirë–hapësirë). (WRC–07)

5.329 Përdorimi i shërbimit të radionavigacionit– satelitor në brezin 1215–1300 MHz do të jetë objekt i kushtit që të mos shkaktohen interferenca të dëmshme dhe të mos kërkohet mbrojtje nga shërbimi i radionavigacionit, autorizuar nën Nr.5.331. Gjithashtu, përdorimi i shërbimit të radionavigacionit satelitor në brezin 1215–1300 MHz do të jetë objekt i kushtit që të mos shkaktohen interfenca të dëmshme për shërbimin e radiovendndodhjes. Nr 5.43 nuk duhet aplikuar përsa i përket shërbimit të radiovendndodhjes. Rezoluta 608 (Rev. WRC–19) duhet aplikuar. (WRC–19)

5.329A Përdorimi i sistemeve në shërbimin e radionavigacionit– satelitor (hapësirë–hapësirë) që operojnë në brezat 1215–1300 MHz dhe 1559–1610 MHz nuk ka si paramendim të ofrojë shërbime sigurie dhe nuk duhet të imponojë asnjë detyrim shtesë në shërbimin e radionavigacionit– satelitor (hapësirë–Tokë), sisteme ose shërbime të tjera që veprojnë në përputhje me Tabelën e Përcaktimit të Frekuencave. (WRC–07)

5.330 *Përcaktim shtesë:* Në Angolë, Arabi Saudite, Bahrain, Bangladesh, Kamerun, Kinë, Xhibuti, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Eritrea, Etiopi, Gujana, Indi, Indonezi, Republikën Islamike të Iranit, Irak, Izrael, Japoni, Jordani, Kuvajt, Nepal, Oman, Pakistan, Palestinë*, Filipine, Katar, Republikën Arabe të Sirisë, Somali, Sudan, Sudani Jugor, Cad, Togo dhe Jemen, brezi i frekuencave 1 215 – 1 300 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm. (WRC– 23)

5.331 *Përcaktim shtesë*: Në Algjeri, Gjermani, Arabi Saudite, Australi, Austri, Bahrein, Bjellorusi, Belgjikë, Benin, Bosnje–Hercegovinë, Brazil, Burkina Faso, Burundi, Kamerun, Kinë, Republika e Koresë, Kroaci, Danimarkë, Xhibuti, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Estoni, Federata Ruse, Finlandë, Francë, Gana, Greqi, Guinea, Guinea Ekuatoriale, Hungari, Indi, Indonezi, Republikën Islamike të Iranit, Irak, Irlandë, Izrael, Jordani, Kenia, Kuvajt, Lesoto, Letoni, Liban, Lihtenshtein, Lituani, Luksemburg, Maqedoni e Veriut, Madagaskar, Mali, Mauritania, Mali i Zi, Nigeri, Norvegji, Oman, Pakistan, Palestinë*, Mbretëria e Hollandës, Poloni, Portugali, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Turqia, Republika Popullore Demokratike e Koresë, Sllovaki, Mbretëri e Bashkuar, Serbia, Sllloveni, Somali, Sudan, Sudani Jugor, Sri Lanka, Afrika Jugut, Suedi, Zvicër, Tailandë, Togo, Venezuelë dhe Vietnam, brezi i frekuencave 1215–1300 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin e radionavigacionit. Në Kanada dhe SHBA, brezi 1240–1300 MHz është përcaktuar gjithashtu për shërbimin e radionavigacionit dhe përdorimi i shërbimit të radionavigacionit duhet të kufizohet për shërbimin aeronautik të radionavigacionit. (WRC– 23)

5.332 Në brezin 1215–1260 MHz, sensorët aktive në hapësirë për shërbimet hapësinore dhe të eksplorimit satelitor të Tokës, nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme, të kërkojnë mbrojtje, ose të imponojnë detyrime në veprimet ose zhvillimet e shërbimit të radiovendndodhjes, shërbimit të radionavigacionit satelitor, shërbimet e tjera të përcaktuara në bazë parësore. (WRC–2000)

5.332A

Administratat që autorizojnë funksionimin e shërbimeve amatore dhe ato amatore satelitore në brezin e frekuencave 1 240-1 300 MHz, ose pjesë të tij, duhet të sigurojnë që shërbimet amatore dhe satelitore amatore të mos shkaktojnë ndërhyrje të dëmshme në marrësit e shërbimeve satelitore të radionavigacionit (hapësirë-Tokë) në përputhje me Nr. 5.29 (shih versionin më të fundit të Rekomandimit ITU-R M.2164). Administrata autorizuese, pas marrjes së një raporti për interferenca të dëmshme të shkaktuara nga një stacion i shërbimeve amatore ose satelitore amatore, do të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të eliminuar me shpejtësi këtë interferencë. (WRC-23).

* Në bazë të Rezolutës 99 (Rev. Dubai, 2018) të Konferencës Fuqiplotë dhe duke marrë parasysh Marrëveshjen e Përkohshme Izraelito-Palestineze të 28 Shtatorit 1995.

5.335A Në brezin 1260–1300 MHz, sensoret aktive në hapësirë për shërbimet hapësinore dhe të eksplorimit satelitor të Tokës, nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme, të kërkojnë mbrojtje, ose të imponojnë detyrime në veprimet ose zhvillimet e shërbimit të radiovendndodhjes dhe të shërbimeve të tjera të përcaktuara në shënime për përdorim parësor. (WRC–2000)

5.337 Përdorimi i brezave 1300–1350 MHz, 2700–2900 MHz dhe 9000–9200 MHz nga shërbimi i radionavigacionit aeronautik është kufizuar në radarët me bazë

	në tokë dhe në transponderat shoqërues të avioneve të cilët transmetojnë vetëm në këto breza dhe vetëm kur aktivizohen nga radarët operues në të njëjtin brez.
5.337A	Përdorimi i brezave 1300–1350 MHz nga stacionet tokësore në shërbimin e radionavigacionit satelitor nuk duhet të shkaktojë interferenca të dëmshme, as të imponojë veprimet dhe zhvillimet e shërbimit të radionavigacionit aeronautik. (WRC– 2000)
5.338	Në Kirgizstan, Sllovaki dhe Turkmenistan, instalimet egzistuese të shërbimit të radionavigacionit mund të vazhdojnë të operojnë në brezin 1350–1400 MHz. (WRC– 12)
5.338A	Në brezat e frekuencave 1350–1400 MHz, 1427–1452 MHz, 22.55–23.55 GHz, 24.25-27.5 GHz, 30–31.3 GHz, 49.7–50.2 GHz, 50.4–50.9 GHz, 51.4–52.6 GHz, 81–86 GHz dhe 92–94 GHz, aplikohet Rezoluta 750 (Rev. WRC–15). (WRC–15)
5.339	Brezat 1370–1400 MHz, 2640–2655 MHz, 4950–4990 MHz and 15.20–15.35 GHz janë gjithashtu të përcaktuar në bazë dytësore për shërbimet e kërkimeve hapësinore (pasive) dhe eksplorimit satelitor të tokës (pasive).
5.340	Të gjitha emëtimet janë të ndaluara në brezat në vijim: 1400–1427 MHz, 2690–2700 MHz, me përjashtim të atyre që kërkohen në shënimin 5.422, 10.68–10.7 GHz, me përjashtim të atyre që kërkohen në shënimin 5.483, 15.35–15.4 GHz, me përjashtim të atyre që kërkohen në shënimin 5.511, 23.6–24 GHz, 31.3–31.5 GHz, 31.5–31.8 GHz, në Rajonin 2, 48.94–49.04 GHz, nga stacionet në bordet e avionëve, 50.2–50.4 GHz (1), 52.6–54.25 GHz, 86–92 GHz, 100–102 GHz, 109.5–111.8 GHz, 114.25–116 GHz, 148.5–151.5 GHz, 164–167 GHz, 182–185 GHz, 190–191.8 GHz, 200–209 GHz, 226–231.5 GHz, 250–252 GHz. (WRC– 03)/(1) 5.340. Përcaktimi i shërbimit për eksplorimin e tokës– satelitor (pasive) dhe shërbimi për kërkimin hapësinor (pasive) në brezin 50.2–50.4 GHz nuk duhet të imponojë kufizime të panevojshme të brezave fqinjë nga shërbimet e përcaktuar për përdorim parësorë në këto breza.
5.341	Në brezat 1400 –1727 MHz, 101 – 120 GHz dhe 197 – 220 GHz, kërkim pasiv është duke u drejtuar nga disa vende në një program për emëtimet e paramenduara të origjinës jashtëtokësore.
5.341A	Në Rajonin 1, brezat e frekuencave 1427–1452 MHz dhe 1492–1518 MHz janë identifikuar për përdorim nga administratat që duan të implementojnë shërbimet e Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT) në

përputhje me Rezolutën 223 (Rev. WRC–15). Ky identifikim nuk parandalon përdorimin e këtyre brezave të frekuencave për çdo aplikim tjetër të shërbimeve për të cilët ata janë përcaktuar dhe nuk vënë prioritet në Radio Rregullatoret. Përdorimi i stacionit IMT është subjekt i marrëveshjes sipas Nr. 9.21 në respekt të shërbimit të lëvizshëm aeronautik përdorur për telemetrinë aeronautike në përputhje me Nr. 5.342. (WRC–15)

5.342 *Përcaktim shtesë*: Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Federatën Ruse, Uzbekistan, Kirgistan dhe Ukrainë, brezi i frekuencave 1429–1535 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin e lëvizshëm aeronautik, ekzkluzivisht për qëllimet e telemetrisë aeronautike brenda territoreve kombëtare. Deri në 1 Prill 2007, përdorimi i brezit 1 452–1 492 MHz është subjekt për marrëveshjen ndërmjet administratave përkatëse. (WRC– 15)

5.345 Përdorimi i brezit 1452–1492 MHz nga shërbimi radioteleviziv satelitor, dhe nga shërbimi radioteleviziv, është i kufizuar për shërbimin radioteleviziv numerik audio dhe është subjekt i dispozitave të Rezolutës 528 (WRC -19).

5.346 Në Algjeri, Angolë, Arabi Saudite, Bahrein, Benin, Botsvana, Burkina Faso, Burundi, Kamerun, Republika e Afrikës Qendrore, Kongo (Rep. e), Bregu i Fildishtë, Xhibuti, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Esuatini, Gabon, Gambia, Gana, Guinea, Irak, Jordani, Kenia, Kuvajt, Lesoto, Liban, Liberi, Madagaskar, Malaui, Mali, Marok, Mauritius, Mauriani, Mozambik, Namibia, Niger, Nigeri, Oman, Uganda, Palestinë**, Katar, Republika Demokratike e Kongos, Ruanda, Senegal, Sejshel, Sudan, Sudani Jugor, Afrika e Jugut, Tanzani, Çad, Togo, Tunizi, Zambia dhe Zimbabve, brezi i frekuencave 1452–1492 MHz është identifikuar për përdorim nga administratat të listuara mësipër që duan të implementojnë shërbimet e Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT) në përputhje me Rezolutën 223 (Rev. WRC–23). Ky identifikim nuk pengon përdorimin e këtij brezi të frekuencave nga ndonjë aplikim tjetër i shërbimeve për të cilët ata janë përcaktuar dhe nuk vënë prioritet në Radio Rregullatoret. Përdorimi i këtij brezi frekuencash për implementimin e IMT është subjekt i arritjes së marrëveshjes sipas Nr. 9.21 në përputhje të shërbimit të lëvizshëm aeronautik përdorur për telemetrinë aeronautike në përputhje me shënimin Nr. 5.342. Shiko gjithashtu Rezolutën 761 (WRC–23). (WRC-23)

** Përdorimi nga Palestina në brezin frekuencor 1452-1492 MHz të alokuar për shërbimin e lëvishëm të identifikuar për IMT është shënuar, në përputhje me Rezolutën 99 (Rev. Dubai, 2018) të Konferencës Fuqiplotë dhe duke marrë parasysh Marrëveshjen e Përkohshme Izraelito-Palestinezin të 28 Shtatorit 1995.

5.348 Përdorimi i brezit 1518–1525 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor është subjekt koordinimi nën Nr.9.11A. Në brezin 1518–1525 MHz stacionet e shërbimit satelitor të lëvizshëm nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e shërbimit fiks. Nr5.43A nuk aplikohet. (WRC– 03)

5.348A Në brezin 1518–1525 MHz, limiti i koordinimit në terma të niveleve të fuqisë së densitetit të fluksit në sipërfaqen e Tokës në aplikim të Nr. 9.11A për stacionet hapësinore në shërbimin e lëvizshëm satelitor (Hapësirë–Tokë), në respekt të përdorimit të shërbimit të lëvizshëm në sterë për radiot e lëvizshme ose i përdorur në mënyrë të përbashkët me rrjetet PSTN që veprojnë në territorin e Japonisë, duhet të jetë në vlerën prej –150 dB(W/m2) në çdo brez 4 kHz për të gjitha këndet e arritjes, në vend të atyre të dhëna në tabelën 52 të

Shtojcës 5. Në Brezin 1518–1525 MHz stacionet në sherbimin satelitor të lëvizshëm nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e shërbimit të lëvizshëm në territorin e Japonisë. Nr. 5.43 nuk aplikohet. (WRC– 03)

5.348B Në brezin 1518–1525 MHz, stacionet e shërbimit satelitor të lëvizshëm nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet telemetrike të lëvizshme aeronautike në shërbimin e lëvizshëm të Shteteve të Bashkuara (shiko shënimet Nr. 5.343 dhe 5.344) dhe të vendeve në listën e Nr. 5.342. Shënimi 5.43A nuk aplikohet. (WRC– 03)

5.349 *Kategori të ndryshme shërbimi*: Në Arabinë Saudite, Azerbajxhan, Bahrein, Kamerun, Xhibuti, Egjypt, Republikën Islamike të Iranit, Irak, Izrael, , Kuvait, Liban, Maqedoninë e Veriut, Marok, Katar, Republikën Arabe të Sirisë, Kirgizstan, Turkmenistan dhe Jemen përcaktimi i brezit të frekuencave 1 525–1 530 MHz për shërbimin e lëvizshëm, përveç i lëvizshëm aeronautik është në bazë primare (shiko Nr.5.33). (WRC– 23).

5.350 *Përcaktim shtesë:* Në Kirgizstan dhe Turkmenistan brezi 1525–1530 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin e lëvizshëm aeronautik. (WRC– 19)

5.351 Brezat 1525–1544 MHz, 1545–1559 MHz, 1626.5–1645.5 MHz and 1646.5–1660.5 MHz nuk duhet të përdoren për lidhjet fider të çdo shërbimi. Megjithatë, në rrethana të veçanta një stacion tokësor i çdo shërbimi të lëvizshëm satelitor të pozicionuar në një pikë fikse mund të autorizohet nga administrata për komunikim ndërmjet stacioneve hapësinore që përdorin këto breza.

5.351A Për përdorimin e brezave të frekuencave 1518–1544 MHz, 1545–1559 MHz, 1610–1645.5 MHz, 1646.5–1660.5 MHz, 1668–1675 MHz, 1980–2010 MHz, 2170–2200 MHz, 2483.5–2520 MHz, MHz dhe 2670–2690 MHz nga shërbimi satelitor i lëvizshëm, shiko Rezolutat 212 (Rev. WRC– 23) dhe 225 (Rev.WRC–23). (WRC–23)

5.352A Në brezin e frekuencave 1 525–1 530 MHz, stacionet e shërbimit satelitor të lëvizshëm, përveç stacioneve të shërbimit detar satelitor të lëvizshëm, nuk duhet të shkaktojnë interfereca të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e shërbimit fiks në Algjeri, Arabi Saudite, Egjipt, Guine, Indi, Izrael, Itali, Jordani, Kuvait, Mali, Marok, Mauritani, Nigeri, Oman, Pakistan, Filipine, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Vietnam dhe Jemen njoftuar para 1 Prillit 1998. (WRC– 19)

5.353A Në aplikimin e procedurave të Seksionit II të Nenit 9 për shërbimin satelitor të lëvizshëm në brezat e frekuencave 1530–1544 MHz dhe 1626.5–1645.5 MHz, prioritet i duhet dhënë pranimit të kërkesave spektrale për fatkeqësi, urgjenca dhe komunikime sigurie për sistemet globale detare të sigurisë dhe fatkeqësive GMDSS. Komunikimet satelitore të lëvizshme detare për fatkeqësi, urgjencë dhe shpëtim duhet të kenë akses prioritar dhe disponibilitet të menjëhershëm mbi të gjitha komunikimet satelitore të lëvizshëm që veprojnë brenda një rrjeti. Shërbimet satelitore të lëvizshme nuk duhet të shkaktojnë interferenca të papranueshme, ose të kërkojnë mbrojtje nga, komunikimet për fatkeqësi, urgjencë dhe të shpëtimit GMDSS. Duhet të merret në konsideratë prioriteti i komunikimeve të lidhura me shpëtimet në shërbimet e tjera satelitore të

lëvizshme. Dispozitat e Rezolutës 222 (WRC–23) duhen aplikuar.) (WRC–23)

5.354 Përdorimi i brezave 1525–1559 MHz dhe 1626.5–1660.5 MHz nga shërbimet e lëvizshme satelitore është objekt për koordinimet nën pikën 9.11A.

5.355 *Përcaktim shtesë:* në Bahrain, Bangladesh, Rep. Demokratike të Kongos, Xhibut, Egjipt, Eritre, Irak, Izrael, Kuvajt, Katar, Republikën Arabe të Sirisë, Somali, Sudan, Sudani Jugor, Çad, Togo dhe Jemen, brezat 1540–1559 MHz, 1640–1645.5 MHz dhe 1646.5–1660 MHz janë përcaktuar gjithashtu për përdorim dytësor, për shërbimin fiks. (WRC–12)

5.356 Përdorimi i brezit 1544–1545 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor (hapësirë– Tokë) është kufizuar në komunikimet e fatkeqësive dhe shpëtimit (shih nenin 31).

5.357 Transmetimet në brezin 1545–1555 MHz nga stacionet tokësore aeronautike direkt në stacionet e anijeve, ose midis stacioneve të anijeve në shërbimin e lëvizshëm aeronautik (R) janë gjithashtu të autorizuar kur të tilla transmetime janë përdorur për të zgjeruar ose mbështetur lidhjet satelit – avion.

5.357A Në aplikimin e procedurave të Seksionit II të Nenit 9 për shërbimin satelitor të lëvizshëm në brezat e frekuencave 1545–1555 MHz dhe 1646.5–1656.5 MHz, prioritet i duhet dhënë pranimit të kërkesave spektrale të shërbimit satelitor të lëvizshëm aeronautik (R) duke dhënë mundësinë e transmetimit të mesazheve me përparësi nga 1 në 6 të Nenit 44. Komunikimet e shërbimit satelitor të lëvizshëm aeronautik (R) me përparësi nga 1 në 6 në Nenin 44 duhet të kenë përparësi në akses dhe disponibilitet të menjëhershëm, me konfiskim në qoftë se është e nevojshme, mbi të gjitha komunikimet e tjera satelitore të lëvizshme që veprojnë brenda një rrjeti. Sistemet satelitore të lëvizshme nuk duhet të shkaktojnë interferenca të papranueshme, ose të kërkojnë mbrojtje nga komunikimet e shërbimit satelitor të lëvizshëm aeronautik (R) me përparësi nga 1 në 6 në Nenin 44. Duhet të merren në konsideratë si prioritet komunikimet e lidhura me shpëtimet në shërbimet e tjera satelitore të lëvizshme. (Duhen aplikuar dispozitat e Rezolutës 222 (Rev.WRC–23)). (WRC–23)

5.359 *Përcaktim shtesë:* në Gjermani, Arabi Saudite, Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, , Kamerun, Federata Ruse, , Gjeorgji, Guine, Guine–Bisau, Jordani, Kazakistan, Kuvait, Lituani, Mauritani, Ugandë, Uzbekistan, Pakistan, Poloni, Republika Arabe e Sirisë, Kirgizstan, Republika Popullore Demokratike e Koresë, Rumani, Taxhikistan, Tunizi, dhe Turkmenistan brezat e frekuencave 1 550–1 559 MHz, 1 610–1 645.5 MHz dhe 1 646.5–1 660 MHz janë gjithashtu të përcaktuara për përdorim parësor, për shërbimin fiks. Administratat janë të detyruara të bëjnë të gjitha përpjekjet për të shmangur implementimin e stacioneve të reja të shërbimit fiks në këto breza frekuencash. (WRC–23)

5.364 Përdorimi i brezit 1610 –1626.5 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor (Tokë– hapësirë) dhe nga shërbimi i radiopërcaktimit satelitor (Tokë–hapësirë) është objekt për koordinimin nën Nr. 9.11A. Stacioni i lëvizshëm tokësor që operon në secilën nga shërbimet përcaktuar në këtë brez nuk do të prodhojë një densitet piku e.i.r.p. që të kaloje –15 dB(W/4 kHz) në pjesët e brezit përdorur nga sistemet operuese në përputhje me kërkesat e Nr. 5.366 (në të cilat aplikohet Nr.4.10), ose të paktën në marrëveshje me administratat e shqetësuara. Në pjesët e brezit ku nuk operojnë sisteme të tilla, densiteti mesatar e.i.r.p. i stacionit të lëvizshëm tokësor nuk do të kalojë –3 Db (W/4

kHz). Stacionet e shërbimit të lëvizshëm satelitor nuk do të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e shërbimit të radionavigacionit aeronautik, stacionet që operojnë në përputhje me kërkesat e Nr.5.366 dhe stacionet në shërbimin fiks që operojnë në përputhje me kërkesat e Nr. 5.359. Administratat përgjegjëse për koordinimin e rrjeteve të lëvizshme satelitore do të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për të siguruar mbrojtjen e stacioneneve që operojnë në përputhje me kërkesat e Nr. 5.366.

5.365 Përdorimi i brezit 1613.8–1626.5 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor (hapësirë–Tokë) është objekt i koordinimeve nën pikën 9.11A.

5.366 Brezi 1610 –1626.5 MHz është rezervuar për përdorim dhe zhvillim në një bazë mbarë botërore të navigacionit ajror për ndihmat elektronike në bordet e avionëve dhe të ndonjë pajisje të lidhur direkt me bazë në tokë ose në satelit. Një përdorim i tillë satelitor është objekt për marrëveshjen e arritur nga Nr 9.21.

5.367 *Përcaktim shtesë:* Brezi 1610–1626.5 MHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e lëvizshëm satelitor aeronautik (R), objekt i marrëveshjes së arritur nga Nr. 9.21.

5.368

Dispozitat e Nr. 4.10 nuk zbatohen në lidhje me shërbimet e radiopërcaktimit satelitor dhe të lëvizshëm satelitor në brezin e frekuencave 1 610-1 626.5 MHz. Megjithatë Nr. 4.10 zbatohet në brezin e frekuencave 1 610-1 626.5 MHz në respekt të shërbimit satelitor të radionavigacionit aeronautik kur operohet në përputhje me Nr. 5.366, shërbimi aeronautik satelitor i lëvizshëm (R) kur operon në përputhje me Nr. 5.367, dhe në brezat e frekuencave 1 614.4225-1 618.725 MHz ose 1 616.3-1 620.38 MHz (Toka - hapësirë) (shih vendimin 5 të Rezolutes 365 (WRC-23) dhe 1 621.35-1 626.5 MHz në respekt të shërbimit satelitor të lëvizshëm detar kur përdoret për sistemin global të rrezikut dhe sigurisë detare (GMDSS). Në zbatim të procedurës së seksionit II të nenit 9, dispozitat e Nr. 4.10 nuk zbatohen për brezat e frekuencave 1 614.4225-1 618.725 MHz ose 1 616.3-1 620.38 MHz (Toka - hapësirë) (shih vendimin 5 të Rezolutës 365 (WRC-23)) dhe 2 483.59-2 499.91 MHz (hapësirë - Tokë) për shërbimin satelitor të lëvizshëm detar kur përdoret për GMDSS me rrjete ose sisteme satelitore për të cilat informacioni i plotë i koordinimit është marrë nga Byroja e Radiokomunikacionit para datës 20 Nëntor 2023. Zbatohet Rezoluta 365 (WRC-23). (WRC-23)

5.369 Kategori të ndryshme shërbimi: Në Angolë, Australi, Kinë, Eritrea, Etiopi, Indi, Iran (Rep Islamike e), Izrael, Liban, Liberi, Madagaskar, Mali, Pakistan, Papua Guinea e Re, Rep Arabe e Sirisë, Rep. Demokratike e Kongos, Sudan, Sudani jugor, Togo dhe Zambia, brezit 1610–1626.5 MHz është përcaktuar për shërbimin e Radiopërcaktimit– Satelitor (Tokë–hapësirë), për përdorim parësorë (shiko Nr.5.33), subjekt marrëveshjeje përfituar sipas pikës 9.21 nga vendet jo të listuar në këtë dispozitë. (WRC–12).

5.371 *Përcaktim shtesë:* Në Rajonin 1, brezi 1 610 – 1 626.5 MHz (Tokë-hapësirë) është gjithashtu të përcaktuar në bazë dytësore për shërbimin e radiopërcaktimit satelitor, objekt i marrëveshjes së arritur nga Nr. 9.21. (WRC–12)

5.372 Interferenca e dëmshme nuk duhet të shkaktohet në stacionet e shërbimit radio astronomi që përdorin brezin 1610.6–1613.8 MHz nga stacionet e shërbimeve të

radiopërcaktimit satelitor dhe të lëvizshëm satelitor (aplikohet Nr 29.13). Dendësia ekuivalente e fluksit të energjisë (epfd) e prodhuar në brezin 1610.6-1613.8 MHz nga të gjitha pozicionet hapësinore të një sistemi jo-gjeostacionar-satelitor në shërbimin e lëvizshëm satelitor (hapësirë-Tokë) që vepron në brezin 1613.8-1626.5 MHz do të jetë në përputhje me kriteret e mbrojtjes të parashikuara në Rekomandimet ITU-R RA.769-2 dhe ITU-R RA.1513-2, duke përdorur metodologjinë e dhënë në Rekomandimin ITU-R M.1583-1, dhe modeli i antenës radio-astronomike i përshkruar në Rekomandimin ITU-R RA.1631-0. (WRC 19)

5.372A Shërbimi satelitor i lëvizshëm detar në brezat e frekuencës 1 614.4225-1 618.725 MHz ose 1 616.3 - 1 620.38 MHz (Toka - hapësirë) (shih vendimin 5 të Rezolutës 365 (WRC- 23)) dhe 2483.59 – 2499.91 MHZ (hapësirë – Tokë) kur ato përdoren për sistemin global të rrezikut dhe sigurisë detare (GMDSS) është i kufizuar në rrjetet gjeostacionare satelitore të identifikuara në Rezolutën 365 (WRC-23) dhe stacionet tokësore të lidhura me to të vendosura brenda një zone shërbimi nga 75°E në 135°E në gjatësinë gjeografike dhe nga 10°N deri në 55°N në gjerësi gjeografike. Zbatohet Rezoluta 365 (WRC-23). (WRC-23)

5.373 Stacionet e lëvizshme tokësore detare që marrin në brezin 1 621.35-1 626.5 MHz nuk do të imponojnë kufizime shtesë në stacionet tokësore që veprojnë në shërbimin e lëvizshëm detar satelitor ose në stacionet tokësore detare të shërbimit të radiodeterminimit satelitor që funksionon në përputhje me Radio Rregulloret në brezin 1 610-1 621.35 MHz ose në stacionet tokësore që veprojnë në shërbimin e lëvizshëm detar satelitor në përputhje me Radio Rregulloret në brezin 1 626.5-1 660.5 MHz, përveç nëse është rënë dakord ndryshe ndërmjet administratave.

5.373A Stacionet e lëvizshme tokësore detare të lëvizshme që marrin në brezin 1621.35-1626.5 MHz nuk do të imponojnë kufizime në caktimin e stacioneve tokësore të shërbimeve të lëvizshme satelitore (Tokë-hapësirë) dhe shërbimet e radiodeterminimit satelitor (Tokë-hapësirë) në brezin 1621.35-1626.5 Mhz në rrjete për të cilat informacioni i plotë për koordinim është marrë nga Byroja e Radiokomunikimit para 28 Tetorit 2019. (WRC-19)

5.374 Stacionet tokësore sterë të lëvizshme në shërbimin e lëvizshëm satelitor që operojnë në brezat 1631.5–1634.5 MHz dhe 1656.5–1660 MHz nuk do të shkaktojnë interferencë të dëmshme në stacionet e shërbimit fiks që operojnë në vendet e renditura në shënimin Nr. 5.359. (WRC–97)

5.375 Përdorimi i brezit të frekuencave 1645.5–1646.5 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor (Tokë–hapësirë) dhe për lidhjet ndër–satelitore është kufizuar në komunikimet për fatkeqësi dhe shpëtim (shih Nenin 31). (WRC-23)

5.376 Transmetimet në brezin 1646.5–1656.5 MHz nga stacionet e avionëve në shërbimin e lëvizshëm aeronautik (R) direkt drejt stacioneve aeronautike tokësore ose përmes stacioneve të anijeve, janë gjithashtu të autorizuar kur të tilla transmetime janë përdorur për zgjerimin ose plotësimin e lidhjeve avion–satelit.

5.376A Stacionet tokësore të lëvizshme që operojnë në brezin 1660–1660.5 MHz nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme për stacionet në shërbimin e radio astronomisë. (WRC–97)

5.379A Administratat janë të detyruara të sigurojnë, sa më shpejt të jetë e mundur, gjithë mbrojtjen e mundshme në brezin 1660.5 – 1668.4 MHz për kërkimet e ardhshme në radio astronomi, veçanërisht duke eleminuar transmetimet ajër – tokë në shërbimin e ndihmave meteorologjike në brezin 1664.4 – 1668.4 MHz sa më shpejt të jetë e praktikueshme.

5.379B Përdorimi i brezit të frekuencave 1668–1675 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor është objekt koordinimi nga Nr. 9.11A. (WRC–23)

5.379C Në mënyrë që të ruhet shërbimi i radio astronomisë në brezin 1668–1670 MHz vlerat e fuqisë së agreguar të densitetit të fluksit të prodhuar nga stacionet tokësore të lëvizshme në rrjetin e shërbimit satelitor të lëvizshëm që operojnë në këtë brez nuk duhet të kalojnë vlerat –181dB (W/m2) në 10 MHz dhe –194 dB (W/m2) në çdo 20 kHz në çdo stacion radio astronomik të regjistruar në MIFR (Master International Frequency Register), për më shumë se 2% të integrimit të periudhës prej 2000 s. (WRC– 03)

5.379D Për bashkëndarjen e brezit të frekeuencave 1668.4–1675 MHz ndërmjet shërbimit të lëvizshëm satelitor dhe atij fiks dhe të lëvizshëm duhet aplikuar Rezoluta 744 (Rev.WRC– 23). (WRC– 23)

5.379E Në brezin 1668.4–1675 MHz, stacionet në shërbimin e lëvizshëm satelitor, nuk duhet ti shkaktojnë interferenca të dëmshme stacioneve në shërbimin e ndihmave meteorologjike në Kinë, Iran (Republika Islamike), Japoni dhe Uzbekistan. Në brezin 1668.4–1675 MHz administratat janë të detyruara të mos implementojnë shërbime të reja të ndihmës meteorologjike dhe janë të inkurajuara të migrojnë shërbimet egzistuese të ndihmës meteorologjike në breza të tjerë sa më shpejt të jetë e praktikueshme.
(WRC– 03)

5.380A Në brezin 1670–1675 MHz stacionet në shërbimin e lëvizshëm satelitor nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme, të detyrojnë zhvillimin e, stacioneve egzistuese tokësore në shërbimin satelitor meteorologjik njoftuar para Janarit 2004. Çdo caktim i ri të stacioneve tokësore në këtë brez duhet gjithashtu të mbrohet nga interferencat e dëmshme shkaktuar nga stacionet e shërbimit të lëvizshëm–satelitor. (WRC–07)

5.381 *Përcaktim shtesë:* në Afganistan, Kubë, Indi, Iran (Republika Islamike e) dhe Pakistan, brezi 1690–1700 MHz është përcaktuar gjithashtu për përdorim parësor për shërbimin fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. (WRC–12)

5.382 *Kategori të ndryshme shërbimi:* Në Arabinë Saudite, Armeni, Azerbajxhan, Bahrain, Bjellorusi, Kongo (Rep e), Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Eritrea, Etiopia, Federata Ruse, Guine, Irak, Izrael, Jordani, Kazakistan, Kuvait, Liban, Maqedoni e Veriut, Mauritani, Moldavi, Mongoli, Oman, Uzbekistan, Poloni, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Kirgizstan, Somali, Taxhikistan, Turkmenistan, Ukrainë dhe Jemen përcaktimi i brezit të frekuencave 1 690 – 1 700 MHz për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik, është në bazë parësore (shih Nr. 5.33), dhe në Republikën Popullore Demokratike të Koresë, përcaktimi i brezit të frekuencave 1 690–1 700 MHz për shërbimin fiks është nëbazë parësore (shih Nr. 5.33) dhe shërbimi i lëvizshem, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik, është në bazë dytësore. (WRC–19)

5.384A	Brezat e frekuencave 1710–1885 MHz, 2300–2400 MHz dhe 2500–2690 MHz, dhe pjesë të tyre, janë të identifikuara për përdorim nga administratat që dëshirojnë të implementojnë IMT (Telekomunikacionet e Lëvizshme Ndërkombëtare) sipas Rezolutës 223 (Rev.WRC–15). Ky identifikim nuk pengon përdorimin e këtyre brezave nga ndonjë aplikacion i shërbimeve të cilëve i janë përcaktuar dhe nuk vendos prioritet në Rregulloret Radio. (WRC– 15)
5.385	*Përcaktim shtesë*: Brezi 1718.8–1722.2 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë dytësore për shërbimin e radio astronomisë në vëzhgimet e linjave spektrale. (WRC– 2000)
5.386	*Përcaktim shtesë:* Brezi 1750 – 1850 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimet e veprimeve hapësinore (Tokë–hapësirë) dhe kërkimeve hapësinore (Tokë–hapësirë) në Rajonin 2 (përveç Meksikës), në Australi, Guam, Indi, Indonezi dhe Japoni, objekt për marrëveshjen e arritur nën Nr. 9.21, duke treguar vemendje të veçantë për sistemet troposkatër. (WRC–15)
5.387	*Përcaktim shtesë*: Në Bjellorusi, Gjeorgji, , Kirgistan, Rumani, Taxhikistan dhe Turkmenistan, brezi i frekuencave 1770–1790 MHz është përcaktuar gjithashtu për shërbimin meteorologjik satelitor në bazë parësore, objekt i marrëveshjes së arritur sipas Nr. 9.21. (WRC–23)
5.388A	Në Rajonet 1 dhe 3, brezat e frekuencave 1710–1980 MHz, 2010–2025 MHz dhe 2110–2170 MHz dhe në Rajonin 2 brezat e frekuencave 1710–1980 MHz dhe 2110–2160 MHz mund të përdoren nga stacionet me lartësi të lartë të platformës si stacione bazë (HIBS) për të siguruar IMT (Telekomunikacionet e Lëvizshme Ndërkombëtare). Ky identifikim nuk pengon përdorimin e këtyre brezave të frekuencave nga çdo aklikim i shërbimeve për të cilat ato janë përcaktuar dhe nuk vendos prioritet në Radio Regulloret.Rezoluta 221 (Rev.WRC-23) do të zbatohet. HIBS nuk do të kërkojë mbrojtje nga shërbimet primare ekzistuese. Nr. 5.43A nuk zbatohet. Një përdorim i tillë i HIBS në brezat e frekuencave 1 710-1 785 MHz në Rajonet 1 dhe 2, dhe 1 710-1 815 MHz në Rajonin 3 është i kufizuar në marrje nga HIBS, dhe në brezin e frekuencave 2 110- 2 170 MHz është i kufizuar në transmetim nga HIBS. (WRC-23)
5.388B	
5.389A	Përdorimi i brezave të frekuencave 1980–2010 MHz dhe 2170–2200 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor është objekt për koordinimin sipas Nr. 9.11A dhe të dispozitave të Rezolutës 716 (Rev.WRC–23). (WRC–23)
5.389C	Përdorimi i brezave të frekuencave 2 010-2 025 MHz dhe 2 160-2 170 MHz në Rajonin 2 nga shërbimi i lëvizshëm satelitor është subjekt i koordinimit sipas Nr. 9.11A dhe dispozitave të Rezolutës 716 (Rev. WRC-23). (WRC-23)
5.389E	Përdorimi i brezave 2010–2025 MHz dhe 2160–2170 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor në Rajonin 2 nuk duhet të shkaktojë interferenca të dëmshme ose të detyrojë zhvillimin e shërbimeve fiks dhe të lëvizshëm në Rajonin 1 dhe 3.
5.389F	Në Algjeri, Kepi i Gjelbërt, Egjipt, Iran (Republika Islamike e), Mali, Republika Arabe e Syrisë dhe Tunizi, përdorimi i brezave 1980–2010 MHz

dhe 2170–2200 MHz nga shërbimi i lëvizshëm satelitor nuk duhet të shkaktojë interferenca të dëmshme në shërbimet fikse dhe të lëvizshmë dhe as të lejojë zhvillimin e këtyre shërbimeve para datës 1 Janar 2005 si dhe as të kërkojë mbrojtje të shërbimeve nga shërbimet e mëvonshme. (WRC–19).

5.391 Në dhënien e frekuencave për shërbimin e lëvizshëm në brezat e frekuencave 2025–2110 MHz dhe 2200–2290 MHz, administratat nuk duhet të fusin sisteme të lëvizshme me densitet të lartë, siç përshkruhet në Rekomandimin ITU–R SA.1154–0 dhe duhet të marrin parasysh këtë Rekomandim për futjen e çdo tipi tjetër sistemi të lëvizshëm. (WRC– 15)

5.392 Administratat janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që transmetimet hapësirë–hapësirë përmes dy ose më shumë sateliteve jogjeostacionar, në shërbimet e kërkimeve hapësinore, veprimeve hapësinore dhe shërbimit satelitor për eksplorimin e Tokës në brezat 2025–2110 MHz and 2200–2290 MHz, nuk do të imponojnë asnjë pengesë në transmetimet Tokë–hapësirë, hapësirë–Tokë dhe transmetime të tjera hapësirë–hapësirë të këtyre shërbimeve dhe të brezave përmes satelitëve gjeostacionar dhe jo–gjeostacionar.

5.394 Në Shtetet e Bashkuara, përdorimi i brezit të frekuencave 2 360-2 395 MHz nga shërbimi i lëvizshëm aeronautik për telemetrinë ka përparësi ndaj përdorimeve të tjera nga shërbimet e lëvizshme. Në Kanada, përdorimi i brezit të frekuencave 2 360-2 400 MHz nga shërbimi i lëvizshëm aeronautik për telemetrinë ka përparësi ndaj përdorimeve të tjera nga shërbimet e lëvizshme . (WRC-23)

5.395 Në Francë dhe Turqi, përdorimi i brezit 2310–2360 MHz nga shërbimi i lëvizshëm aeronautik, për telemetrinë ka prioritet mbi përdorimet e tjera nga shërbimi i lëvizshëm. (WRC– 03)

5.396 Stacionet hapësinore të shërbimit radioteleviziv–satelitor në brezin 2310–2360 MHz që operojnë në përputhje me shënimin 5.393 që mund të prekë shërbimet për të cilët ky brez është i caktuar në vendet e tjera, duhet të koordinohet dhe të njoftohet në përputhje me Rezolutën 33 (Rev.WRC–07)*. Stacionet tokësore radiotelefvizive do të jenë subjekt koordinimi dypalësh me vendet fqinje përpara se ata të vihen në përdorim.
*Shënim nga Sekretariati: Kjo Rezolutë është rishikuar nga WRC–03.

5.398 Në lidhje me shërbimin e radiopërcaktimit satelitor në brezin 2 483.5 –2 500 MHz, dispozitat e Nr.4.10 nuk do të aplikohen.

5.398A Kategori të ndryshme shërbimi: Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Federatën Ruse, Kazakistan, Uzbekistan, Kirgistan, Taxhikistan dhe Ukrainë, brezi 2483.5 – 2500 MHz është përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e radiopërcaktimit. Stacionet e radiopërcaktimit në këto vende nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e shërbimeve fikse, të lëvizshme dhe satelitore të lëvizshme të cilët operojnë në përputhje me Rregulloret Radio në brezin e frekuencave 2 483.5–2500 MHz. (WRC–12)

5.399 Me përjashtim të rasteve referuar në shënimin Nr. 5.401, stacionet e shërbimit satelitor të radiopërcaktimit që operojnë në brezin e frekuencave 2 483.5–2 500 MHz, për të cilin informacioni i njoftimit është marrë nga Byroja pas 17 Shkurt 2012 dhe zona e shërbimit e të cilit përfshin Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Federatën Ruse, Kazakistan, Uzbekistan, Kirgistan, Taxhikistan dhe Ukrainë, nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme, dhe nuk duhet të kërkojnë

mbrojtje nga stacionet e shërbimit të radiopërcaktimit që operojnë në këto vende në përputhje me shënimin Nr. 5.398A. (WRC–12)

5.401 Në Angolë, Australi, Bangladesh, Kinë, Eritrea, Esuatini, Etiopi, Indi, Liban, Liberi, Libi, Madagaskar, Mali, Pakistan, Papua Guinea e Re, Republika Arabe Siriane, Republika Demokratike e Kongos, Sudan, Togo dhe Zambia, brezi i frekuencave 2483.5–2500 MHz është përcaktuar tashmë në bazë parësore për shërbimin satelitor të radiopërcaktimit përpara WRC–12, në bazë të marrëveshjes së mbajtur sipas Nr. 9.21 nga vendet që nuk janë të listuar në këtë dispozitë. Sistemet në shërbimin satelitor të radiopërcaktimit për të cilët është marrë informacioni i plotë mbi koordinimin nga Zyra e Radiokomunikimit përpara 18 Shkurt 2012 do të ruajnë statusin e tyre rregullator, që nga data e marrjes së informacionit të kërkesës së koordinimit. (WRC–19)

5.402 Përdorimi i brezit 2483.5–2500 MHz nga shërbimet i lëvizshëm satelitor dhe radiopërcaktimit satelitor është objekt për koordinimin nën Nr. 9.11A. Administratat janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për të shmangur interferencat e dëmshme të shërbimit të radio astronomisë nga emëtimet në brezin 2483.5–2500 MHz, veçanërisht kur shkaktohen nga rrezatimet harmonike dytësore që do të bien brenda brezit 4990–5000 MHz përcaktuar në bazë mbar botërore për shërbimin e radio astronomisë.

5.403 Në bazë të marrëveshjes së arritur nga Nr. 9.21, brezi 2520–2535 MHz mund të përdoret gjithashtu për shërbimin e lëvizshëm satelitor (hapësirë–Tokë), përveç i lëvizshëm aeronautik– satelitor për veprim të kufizuar brenda kufijve kombëtar. Dispozitat e Nr. 9.11° do të aplikohen. (WRC–07)

5.409A Brezi i frekuencës 2 500-2 690 MHz në Rajonet 1 dhe 2 dhe brezi i frekuencave 2 500-2 655 MHz në Rajonin 3 janë identifikuar për përdorim nga stacionet e platformës në lartësi të madhe si stacione bazë (HIBS) të Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT) (HIBS). Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtyre brezave të frekuencave nga çdo aplikim i shërbimeve të cilave u janë caktuar dhe nuk vendos përparësi në Radio Rregulloret. Rezoluta 218 (WRC-23) do të zbatohet. HIBS nuk do të kërkojë mbrojtje nga shërbimet primare ekzistuese. Nr. 5.43A nuk zbatohet. Një përdorim i tillë i HIBS në brezat e frekuencave 2 500-2 510 MHz në Rajonet 1 dhe 2, dhe 2 500-2 535 MHz në Rajonin 3 është i kufizuar në marrje nga HIBS. (WRC-23)

5.410 Brezi 2500–2690 MHz mund të përdoret për sistemet skater troposferike në Rajonin 1, subjekt i marrëveshjes së arritur sipas Nr. 9.21. Nr. 9.21 nuk zbatohet për lidhjet skater troposferike të vendosura krejtësisht jashtë Rajonit 1. Administratat duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të shmangur zhvillimin e sistemeve të reja skater troposferike në këtë brez. Kur planifikohen lidhje të reja skater troposferik radio–rele në këtë brez, duhet të merren të gjitha masat e duhura për të përjashtuar drejtimin e antenave të këtyre lidhjeve drejt orbitës së satelitit gjeostacionar. (WRC–12)

5.412 *Përcaktim alternativ:* Në Kirgizstan dhe Turkmenistan brezi 2500–2690 MHz është përcaktuar në bazë parësore për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. (WRC–12)

5.413 Në caktimin e sistemeve në shërbimin radioteleviziv– satelitor në brezat përmes 2500 MHz dhe 2690 MHz, administratat janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur shërbimin radio astronomi në brezin 2690–700 MHz.

5.414 Përcaktimi i brezit të frekuencave 2500–2520 MHz në shërbimin e lëvizshëm satelitor (hapësirë–Tokë) është objekt për koordinimin nën Nr. 9.11A. (WRC–07)

5.416 Përdorimi i brezit 2520–2670 MHz nga shërbimi radioteleviziv– satelitor është kufizuar në sistemet kombëtare dhe rajonale për marrje në bashkësi, objekt për marrëveshjen e arritur sipas Nr.9.21. Dispozitat e Nr. 9.19 do të aplikohen nga administratat në këtë brez, në marrëveshjet e tyre dypalëshe dhe shumëpalëshe. (WRC–07)

5.418 (M) *Përcaktim shtesë:* në Indi, brezi i frekuencave 2535–2655 MHz është përcaktuar gjithashtu për përdorim parësor për shërbimin radioteleviziv–satelitor (zanor) dhe shërbimet plotësuese radioteleviziv tokësor. Një përdorim i tillë është i limituar në radiotelevizionin numerik audio dhe është subjekt i dispozitave të Rezolutës 528 (Rev. WRC–19). Dispozitat e Nr.5.416 dhe Tabela 21–4 e nenit 21, nuk aplikohet në këtë përcaktim shtesë. Përdorimi i sistemit të sateliteve jo–gjeostacionar në shërbimin radioteleviziv–satelitor (zanor) është subjekt i Rezolutës 539 (Rev. WRC–19). Sistemet e shërbimit sradioteleviziv–satelitor gjeostacionar (zanor) për të cilët informacioni i plotë i koordinimit sipas Shtojcës 4 është marrë pas 1 Qershorit 2005 janë të limituara në sistemet me qëllim mbulimi kombëtar. Fuqia e densitetit të fluksit në sipërfaqen e Tokës e prodhuar nga emëtimet e një stacioni hapësinor gjeostacionar të shërbimit radioteleviziv satelitor (zanor) që operon në brezin 2630–2655 MHz për të cilin informacioni i plotë i koordinimit sipas Shtojcës 4, është marrë pas 1 Qershorit 2005, për të gjitha kushtet dhe të gjitha metodat e modulimit, nuk duhet të tejkalojë limitet e mëposhtme: –130 dB (W/ (m2 · MHz)) për 0o ≤ Θ ≤5o

–130 + 0.4 (Θ –5) dB (W/ (m2 · MHz)) për 5o ≤ Θ ≤25o

–122 dB (W/ (m2 · MHz)) për 25o ≤ Θ ≤ 90o

ku Θ është këndi i arritjes së valës incidente mbi planin horizontal, në gradë. Këto limite mund të tejkalohen në territorin e çdo vëndi për të cilin administrata ka rënë dakord në këtë mënyrë. Si një përjashtim i limiteve të mësipërme, fuqia e densitetit të fluksit prej –122 dB(W/(m2 · MHz)) duhet përdorur si kufi për koordinim nën Nr. 9.11 në një sipërfaqe prej 1500 km rreth territorit të një administrate duke njoftuar sistemet e shërbimit radioteleviziv–satelitor (zanor). Veç kësaj, një administratë e listuar në këtë dispozitë nuk duhet të ketë njëherësh dy mbivendosje të frekuencave të caktuara, njera nën këtë dispozitë dhe tjera nën Nr. 5.416 për sistemet për të cilat informacioni i plotë i koordinimit sipas Shtojcës 4 është marrë pas 1 Qershorit 2005. (WRC–19)

5.418B Përdorimi i brezit 2630–2655 MHz nga sistemet satelitore jo–gjeostacionare në shërbimin radioteleviziv– satelitor (zanor), që ndiqet nga shënimi. 5.418, për të cilat infomacioni i plotë i koordinimit sipas Shtojcës 4, ose informacioni i njoftimit është marrë pas 2 Qershorit 2000, është objekt për aplikimin e përcaktimeve të Nr. 9.12. (WRC– 03)

5.418C Përdorimi i brezit 2630–2655 MHz nga rrjetet satelitore gjeostacionare për të cilat informacioni i plotë i koordinimit sipas Shtojcës 4 ose informacioni i njoftimit është marrë pas 2 Qershorit 2000, është objekt për aplikimin e përcaktimeve të Nr. 9.13 në respekt të sistemeve satelitore jo–gjeostacionare në shërbimin radioteleviziv–satelitor (zanor), që ndiqet nga Shënimi. 5.418. Nr. 22.2 nuk aplikohet. (WRC– 03)

5.419 Kur sistemet e shërbimit të lëvizshëm satelitor përdoren në brezin 2670–2690 MHz, administratat duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur sistemet satelitore që operojnë në këtë brez para datës 3 Mars 1992.

Koordinimi i sistemeve të lëvizshme satelitore në këtë brez do të jetë në përputhje me Nr. 9.11A. (WRC–07)

5.420 Brezi 2655–2670 MHz mund të jetë përdorur gjithashtu për shërbimin i lëvizshëm satelitor (Tokë–hapësirë), përveç i lëvizshëm aeronautik–satelitor për operim të kufizuar brenda kufijve kombëtar, objekt për marrëveshjen e arritur nën Nr. 9.21. Aplikohet koordinimi sipas Nr. 9.11A. (WRC–07)

5.422 *Përcaktim shtesë*: Në Arabinë Saudite, Armeni, Azerbajxhan, Bahrein, Bjellorusi, Brunei Darusalem, Kongo (Republika e), Bregu i Fildishtë, Kubë, Xhibuti, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Eritrea, Etiopi, Gabon, Gjeorgji, Guinea, Guinea–Bissau, Republika Islamike e Iranit, Irak, Izrael, Jordani, Kuvait, Liban, Mauritani, Mongoli, Mali i Zi, Nigeri, Oman, Pakistan, Filipine, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Kirgistan, Rep. Demokratike e Kongos, Rumani, Somali, Taxhikistan, Tunizi, Turkmenistan, Ukrainë dhe Jemen brezi 2690–2700 MHz është përcaktuar gjithashtu në një bazë parësore edhe për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. Një përdorim i tillë është i lejuar vetëm për pajisjet që janë në operim nga 1 Janari 1985. (WRC–12)

5.423 Në brezin 2700–2900 MHz, radarët me bazë tokësore përdorur për qëllime meteorologjike janë autorizuar të operojnë në bazë të barazisë me stacionet e shërbimit të radionavigacionit aeronautik.

5.424A Në brezin 2900–3100 MHz, stacionet në shërbimin e radiovendndodhjes nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme, as të kërkojnë mbrojtje nga, sistemet radare në shërbimin e radionavigacionit. (WRC– 03)

5.425 Në brezin 2900 –3100 MHz, përdorimi i sistemit transponder për investigimin në bordet e anijeve (SIT) do të jetë kufizuar në nënbrezin 2930 –2950 MHz.

5.426 Përdorimi i brezit 2900–3100 MHz nga shërbimi i radionavigacionit aeronautik është kufizuar në radarët me bazë tokësore.

5.427 Në brezat 2900–3100 MHz dhe 9300–9500 MHz, përgjigja nga transponderat e radarëve nuk do të jetë e mundur të ngatërrohet me përgjigjet nga radarët sinjalizues dhe nuk do të shkaktojë interferenca në radarët e anijeve ose të avionëve në shërbimin e radionavigacionit, duke vlerësuar gjithsesi Nr.4.9.

5.428 *Përcaktim shtesë*: Në Kirgistan, dhe Turkmenistan brezi i frekuencave 3100–3300 MHz është përcaktuar gjithashtu në një bazë parësore për shërbimin e radionavigacionit. (WRC–19)

5.429 *Përcaktim shtesë*: Në Arabinë Saudite, Bahrain, Bangladesh, Benin, Brunei Darusalam, Kamboxhia, Kamerun, Kinë, Kongo (Rep. e), Korea (Rep. e), Bregu i Fildisht, Xhibuti, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Indi, Indonezi, Iran (Republika Islamike e), Irak, Japoni, Jordani, Kenia, Kuvajt, Lao P.D.R, Liban, Libi, Malajzi, Mongoli, Maynmar, Zelandë e Re, Oman, Uganda, Pakistan, Palestine* Katar, Republika Arabe e Sirisë, Rep. Demokratike e Kongos, Rep. Popullore Demokratike të Koresë, Singapor, Somali, Sudan, Tailand, Vietnam dhe Jemen, brezi i frekuencave 3300–3400 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin e lëvizshëm dhe fiks. Mongolia , Zelanda e Re dhe shtetet që kufizojnë Mesdheun nuk duhet të kërkojnë mbrojtje për shërbimin e tyre fiks dhe të lëvizshëm nga shërbimi i radiopërcaktimit. (WRC–23)

5.429A *Përcaktim shtesë*: Në Angolë, , Botsvana, Burkina Fazo, Burundi, Kabo Verde, Republika e Afrikës Qëndrore, Komoros, Xhibuti, Eritrea, Esuatini, Etiopia, Gambia, Gana, Guinea, Guinea–Bissau, Guinea Ekuateriale, Lesoto, Liberi, Madagaskar, Malaui, Mauritius, Mauritani, Mozambik, Namibi, Niger, Nigeri, Palestine*, , Republika Demokratike e Kongos, Ruanda, Sao Tome Principe, Senegal, Sejshel, Sierra Leone, Somalia, , Sudani Jugor, Afrika e Jugut, Tanzani, Çad, Togo, Zambia dhe Zimbabve, brezi i frekuencave 3300–3400 MHz është përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e lëvizshëm, përveç shërbimit lëvizshëm aeronautik. Stacionet në shërbimin e lëvizshëm që operojnë në brezin e frekuencave 3300–3400 MHz nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme për, ose të kërkojnë mbrojtje nga, stacionet që operojnë në shërbimin e radiopërcaktimit. (WRC–23).

* Në bazë të Rezolutës 99 (Rev. Dubai, 2018) të Konferencës Fuqiplotë, dhe duke marrë parasysh Marrëveshjen e Përkohshme Izraelito-Palestineze të 28 shtatorit 1995.

5.429B Në shtetet, në vazhdim, të Rajonit 1, Angolë, Benin, Botsvana, Burkina Fazo, Burundi, Kepi i Gjelber, Kamerun, Republika e Afrikës Qëndrore, Komoros, Kongo (Republika e), Bregu i Fildishtë, Xhivuti, Egjipt, Eritrea, Esuatini,Etiopi, Gambia, Gana, Guinea, Guinea–Bissau, Guinea Ekutoriale, Kenia, Lesoto, Liberi, Malaui, Madagaskar, Mauritius, Mauritani, Mongoli, Mozambik, Namibi, Niger, Nigeri, Uganda, Rep. Demokratike e Kongos, Ruanda, Sudan, Sao Tome dhe Principe, Senegal, Sejshel, Sierra Leone, Somali, Sudan, Sudani Jugor, Afrika e Jugut, Tanzani, Çad, Togo, Zambia dhe Zimbabve, brezi i frekuencave 3300–3400 MHz është identifikuar për implementimin e Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Përdorimi i këtij brezi frekuencash duhet të jetë në përputhje me Rezolutën 223 (Rev. WRC–23). Përdorimi i brezit të frekuencave 3300–3400 MHz nga stacionet IMT në shërbimin e lëvizshëm nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme për, ose të kërkojë mbrojte nga, sistemi në shërbimin e radiopërcaktimit, dhe administratat që dëshirojnë të implementojnë IMT duhet të arrijnë marrëveshjen me shtetet fqinje për të mbrojtur operimin brenda shërbimit të radiopërcaktimit. Ky identifikim nuk përfshin përdorimin e këtij brezi frekuencash nga ndonjë aplikim i shërbimit në të cilin ai është përcaktuar dhe nuk vë prioritet në Radio Rregullatoret. (WRC–23)

5.429C Kategori të ndryshme shërbimi: në Argjentinë, Brazil, Kubë, Republikën Domenikane, Guatemalë, Meksikë, Paraguaj dhe Uruguay, brezi i frekuencës 3 300-3 400 MHz i përcaktohet shërbimit fiks në bazë primare. Stacionet në shërbimin fiks që operojnë në brezin e frekuencave 3 300-3 400 MHz nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme për, ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet që veprojnë në shërbimin e radiolokacionit. (WRC-23)

5.429D Në Rajonin 2, përdorimi i shërbimit të lëvizshëm, përveç i lëvizshëm aeronautik, në brezin e frekuencave 3 300 - 3 400 MHz është identifikuar për implementimin e Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Një përdorim i tillë do të jetë në përputhje me Rezolutën 223 (Rev.WRC-23). Përdorimi i brezit të frekuencave 3 300-3 400 MHz nga stacionet IMT në shërbimin e lëvizshëm nuk duhet të shkaktojë interferenca të dëmshme për, ose të pretendojë mbrojtje nga sistemet në shërbimin e radiolokacionit dhe administratat që dëshirojnë të zbatojnë IMT duhet të marrin miratimin e vendeve fqinje për të mbrojtur operimin brenda shërbimit të radiolokacionit. Ky identifikim nuk e përjashton përdorimin e këtij brezi frekuencor nga ndonjë

aplikim i shërbimeve tek të cilat ajo u është caktuar dhe nuk vendos prioritet në Radio Rregullore. (WRC-23)

5.429F Në vendet e mëposhtme në Rajonin 3: Kamboxhia, Indi, Indonezi, Lao P.D.R., Pakistan, Filipine, Singapor dhe Vietnam, përdorimi i brezit të frekuencave 3 300-3 400 MHz është identifikuar për implementimin e Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Një përdorim i tillë do të jetë në përputhje me Rezolutën 223 (Rev.WRC-23). Përdorimi i brezit të frekuencave 3 300-3 400 MHz nga stacionet IMT në shërbimin e lëvizshëm nuk duhet të shkaktojë interferenca të dëmshme për, ose të pretendojë mbrojtje nga sistemet në shërbimin e radiolokacionit. Përpara se një administratë të vërë në përdorim një stacion bazë ose të lëvizshëm të një sistemi IMT në këtë brez frekuencash, ajo do të kërkojë marrëveshje sipas Nr. 9.21 me vendet fqinje për të mbrojtur shërbimin e radiolokacionit. Ky identifikim nuk e përjashton përdorimin e këtij brezi frekuencor nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u është caktuar dhe nuk vendos prioritet në Radio Rregullore. (WRC-23)

5.429G Stacionet në shërbimin e lëvizshëm, përveç i lëvizshëm aeronautik, që operojnë në brezin e frekuencave 3 300 3 400 MHz në Rajonin 2 nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme për, ose të pretendojnë mbrojtje nga sistemet që operojnë në shërbimin e radiolokacionit. (WRC-23)

5.430 *Përcaktim shtesë*: Në Kirgistan dhe Turkmenistan, brezi i frekuencës 3300–3400 MHz është përcaktuar gjithashtu në një bazë parësore për shërbimin e radionavigacionit. (WRC– 19)

5.430A (M) Përcaktimi i brezit të frekuencave 3400–3600 MHz për shërbimin e lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik është subjekt i marrëveshjes së arritur sipas Nr. 9.21. Ky brez frekuencash është identifikuar për Telekomunikacionet e Lëvizshme Ndërkombetare (IMT). Ky identifikim nuk pengon përdorimin e këtij brezi nga çdo aplikim i shërbimeve për të cilët është përcaktuar dhe nuk përcakton prioritet në Rregulloret Radio. Në fazën e koordinimit zbatohen gjithashtu dispozitat e Nr. 9.17 dhe 9.18. Përpara se një administratë të vendosë në përdorim një stacion (bazë ose të lëvizshëm) të shërbimit të lëvizshëm në këtë brez, duhet të sigurojë që fuqia e fluksit të densitetit (pfd), prodhur në 3 m mbi tokën, nuk tejkalon –154.5 dB(W/(m2· 4 kHz)) për më shumë se 20% të kohës, në kufijtë e territorit të çdo administrate tjetër. Ky limit mund të tejkalohet në territorin e çdo vendi, administrata e të cilit ka rënë dakort kështu. Në mënyrë që të sigurohet që limiti pfd në kufijtë e territorit të çdo administrate tjetër është plotësuar, duhet të bëhen llogaritjet dhe verifikimet duke marrë parasysh gjithë informacionin përkatës, me marrëveshje të ndërsjelltë të të dy administratave (administratës përgjegjëse për stacionin tokësor (terrestrial station) dhe administratës përgjegjëse përstacionin në tokë (earth station)), dhe nëse kërkohet edhe me asistencë të Zyrës. Në rast të mosmarrëveshjeve, llogaritjet dhe verifikimet e pfd do të bëhen nga Zyra, duke marrë parasysh informacionet e përmendura më sipër. Stacionet e shërbimit të lëvizshëm në brezin 3400–3600 MHz nuk duhet të kërkojnë më shumë mbrojtje nga stacionet hapësinore se ato të ofruara në Tabelën 21–4 të Rregulloreve Radio (Versioni i 2004–s). (WRC–15)

5.431 *Përcaktim shtesë*: Në Gjermani brezi i frekuencave 3400–3475 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë dytësore për shërbimin amator. (WRC–19)

5.433A Në Australi, Bangladesh, Brunei Darussalam, Kinë, komunitetet franceze jashtë shtetit të Rajonit 3, Kore (Rep. e), Indi, Indonezi, Iran (Republika Islamike), Japoni, Zelandën e Re, Pakistan, Filipine, Republika Popullore

Demokratike e Koresë dhe Singapor, brezi i frekuencave 3 500-3 600 MHz është identifikuar për Telekomunikacionin e Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Ky identifikim nuk e përjashton përdorimin e këtij brezi frekuencor nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u është caktuar dhe nuk vendos prioritet në Radio Rregullore. Në fazën e koordinimit zbatohen gjithashtu edhe dispozitat Nr. 9.17 dhe 9.18. Përpara se një administratë të vërë në përdorim një stacion (bazë ose të lëvizshëm) të shërbimit të lëvizshëm në këtë brez frekuencash, duhet të sigurojë që densiteti i fluksit të fuqisë (pfd) i prodhuar në 3 m mbi tokë të mos kalojë -154,5 dB(W/(m2 . 4 kHz)) për më shumë se 20% të kohës në kufirin e territorit të çdo administrate tjetër. Ky kufi mund të tejkalohet në territorin e çdo vendi, administrata e të cilit ka rënë dakord. Për të siguruar që kufiri i pfd në kufirin e territorit të çdo administrate tjetër është përmbushur, llogaritjet dhe verifikimi do të bëhen, duke marrë parasysh të gjithë informacionin përkatës, me marrëveshje reciproke të të dyja administratave (administrata përgjegjëse për stacionin/terrestrial dhe administratën përgjegjëse për stacionin **tokësor**), me ndihmën e Byrosë nëse kërkohet. Në rast mosmarrëveshjeje, llogaritja dhe verifikimi i pfd-së bëhet nga Byroja, duke marrë parasysh informacionin e përmendur më sipër. Stacionet e shërbimit të lëvizshëm në brezin e frekuencave 3 500– 3 600 MHz nuk do të kërkojnë më shumë mbrojtje nga stacionet hapësinore sesa ajo e parashikuar në Tabelën 21-4 të Rregullores së Radios (Botimi i 2004). (WRC-23)

5.433B Në Angola, Botsvana, Guinea, Lesoto, Malavi dhe Sudanin e Jugut, brezi i frekuencave 3 600-3 700 MHz është identifikuar për Telekomunikacionin e Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e brezit të frekuencave nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u është caktuar dhe nuk vendos prioritet në Radio Rregullore. Do të zbatohen kushtet e Nr. 5.434A. (WRC-23)

5.434 Në Rajonin 2, brezi i frekuencës 3 600-3 700 MHz është identifikuar për përdorim nga administratat që dëshirojnë të zbatojnë Telekomunikacionin e Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Ky identifikim nuk e përjashton përdorimin e këtij brezi frekuencor nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u është caktuar dhe nuk vendos prioritet në Radio Rregullore. Administratat që dëshirojnë të zbatojnë IMT-në do të marrin miratimin e vendeve fqinje për të siguruar mbrojtjen e shërbimit satelitor fiks (hapësirë tokë). (WRC-23)

5.434A Përdorimi i brezit të frekuencave 3 600-3 800 MHz nga shërbimi i lëvizshëm, përveç i lëvizshëm aeronautik, në bazë parësore në Rajonin 1, është subjekt i marrëveshjes së marrë sipas Nr. 9.21 nëse kufiri i densitetit të fluksit të fuqisë (pfd) më poshtë është tejkaluar. Dispozitat e Nr. 9.17 dhe 9.18 do të zbatohen edhe në fazën e koordinimit. Përpara se një administratë në Rajonin 1 të vërë në përdorim një stacion në shërbimin e lëvizshëm në brezin e frekuencave 3 600-3 800 MHz, për mbrojtjen e stacioneve në shërbimet fikse dhe fikse satelitore, duhet të sigurojë që pfd e prodhuar në 3 m mbi tokë nuk kalon −154,5 dB(W/(m2 . 4 kHz)) për më shumë se 20% të kohës në kufirin e territorit të çdo administrate tjetër. Stacionet në shërbimin e lëvizshëm që operojnë në brezin e frekuencave 3 600-3 800 MHz nuk do të kërkojnë më shumë mbrojtje nga stacionet hapësinore sesa ajo e parashikuar në Tabelën 21-4 të Radio Rregulloreve. (WRC-23)

5.434B Në Algjeri, Arabinë Saudite, Azerbajxhan, Bahrein, Bjellorusi, Benin, Burkina Faso, Burundi, Kamerun, Rep. e Afrikës Qendrore, Komoret, Kongo (Rep. i), Bregu i Fildishtë, Xhibuti, Egjipti, Emiratet e Bashkuara Arabe, Eswatini, Gabon, Gambia, Gana, Guinea, Iraku, Jordania, Kazakistani, Kenia, Kuvajti, Libani, Liberia, Libia, Madagaskari, Mali, Maroku, Mauritius, Mauritania, Mozambiku, Namibia, Nigeri, Nigeria, Omani, Uganda, Uzbekistani, Palestina*, Katari, Republika Arabe Siriane, Dem. Rep. e Kongos, Ruandës,

Sao Tome dhe Principe, Senegal, Sierra Leone, Somalia, Sudani, Afrika e Jugut, Tanzania, Çadi, Togo, Tunizia, Jemeni, Zambia dhe Zimbabve, brezi i frekuencave 3 600-3 800 MHz është identifikuar për Telekomunikacionin e Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e brezit të frekuencave nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u është caktuar dhe nuk vendos prioritet në Radio Rregulloret. Do të zbatohen kushtet e Nr. 5.43A. (WRC-23).

* Në bazë të Rezolutës 99 (Rev. Dubai, 2018) të Konferencës Fuqiplotë, dhe duke marrë parasysh Marrëveshjen e Përkohshme Izraelito-Palestineze të 28 shtatorit 1995.

5.435A Kategori të ndryshme shërbimi: Në Angola, Botsvanë, Guine, Lesoto, Malavi dhe Sudanin e Jugut, brezi i frekuencave 3 700-3 800 MHz i përcaktohet shërbimit të lëvizshëm në bazë dytësore. (WRC-23

5.435B Në Bahamas, Belize, Brazil, Kanada, Kolumbi, Kosta Rika, Shtetet e Bashkuara, Guatemala, departamentet dhe komunitetet e huaja Franceze në Rajonin 2, Grenlandë, vendet dhe territoret e huaja brenda Mbretërisë së Holandës në Rajonin 2, Paraguaj, Peru, Trinidad dhe Tobago dhe Uruguai, brezi i frekuencave 3 700-3 800 MHz është identifikuar për përdorim nga ndonjë prej këtyre administratave që dëshirojnë të zbatojnë Telekomunikacionin e Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Ky identifikim nuk e përjashton përdorimin e këtij brezi frekuencor nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u është caktuar dhe nuk vendos prioritet në Radio Rregulloret. Administratat që dëshirojnë të implementojnë IMT do të marrin miratimin e vendeve fqinje për të siguruar mbrojtjen e shërbimit satelitor fiks (hapësirë-tokë). (WRC-23)

5.436 MOD Përdorimi i brezit të frekuencave 4200–4400 MHz nga stacionet në shërbimin e lëvizshëm aeronautik (R) është rezervuar eskluzivisht për sistemet e komunikimit të brendshëm pa tel avioniks që operojnë në përputhje me njohjen e standarteve ndërkombëtare të aeronautikës. Një përdorim i tillë duhet të jetë në përputhje me Rezolutën 424 23 (Rev.WRC-23). (WRC-23)

5.437 Sensorët pasivë në eksplorimin e Tokës–satelitor dhe shërbimet e kërkimit hapësinor mund të autorizohen për përdorim dytësor në brezin e frekuencave 4200–4400 MHz. (WRC–15)

5.438 Përdorimi i brezit 4200–4400 MHz nga shërbimi i radionavigacionit aeronautik është rezervuar ekskluzivisht për altimetrat radio të instaluar në bordet e avionëve dhe për transponderat shoqërues në tokë. (WRC–15)

5.439 *Përcaktim shtesë*: në Republikën Islamike të Iranit brezi 4200-4400 MHz është përcaktuar në bazë dytësore për shërbimin fiks (WRC-12)

5.440 Shërbimi i frekuencës standarte dhe sinjalit kohor satelitor mund të jetë autorizuar të përdor frekuencën 4202 MHz për transmetimet hapësirë–Tokë dhe frekuencën 6427 MHz për transmetimet Tokë–hapësirë. Të tilla transmetime do të jenë kufizuar brenda kufijve të ±2 MHz të këtyre frekuencave, objekt për marrëveshjen e arritur nga Nr. 9.21.

5.440A Në Rajonin 2 (përveç Brazilit, Kubës, komunitetet dhe territoret jashtë Francës, Guatemalës, Paraguajit, Uruguajit dhe Venezuelës) dhe në Australi brezi 4400–4940 MHz mund të përdoret për telemetri të lëvizshme aeronautike për testimin e fluturimit nga stacionet e avionit (shiko Nr. 1.83). Përdorime të

tilla duhet të jetë në përputhje me Rezolutën 416 (WRC–07) dhe nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme dhe as të kërkojnë mbrojtje nga shërbimi fiks dhe fiks–satelitor. Çdo përdorim i tillë nuk duhet të përjashtojë përdorimin e këtij brezi nga aplikacionet e tjera të shërbimit të lëvizshëm ose nga shërbimet e tjera për të cilat ky brez është përcaktuar në bazë bashkë–parësore dhe nuk përcakton prioritet në Rregulloret Radio. (WRC–07)

5.441 Përdorimi i brezave 4500–4800 MHz (hapësirë–Tokë), 6725–7025 MHz (Tokë–hapësirë) nga shërbimi fiks satelitor duhet të jetë në përputhje me kërkesat e Shtojcës 30B. Përdorimi i brezave 10.7–10.95 GHz (hapësirë–Tokë), 11.2–11.45 GHz (hapësirë–Tokë) dhe 12.75–13.25 GHz (Tokë–hapësirë) nga sistemet satelitore gjostacionare në shërbimin satelitor fiks duhet të jetë në përputhje me kërkesat e Shtojcës 30B. Përdorimi i brezave 10.7 – 10.95 GHz (hapësirë–Tokë), 11.2–11.45 GHz (hapësirë–Tokë) dhe 12.75–13.25 GHz (Tokë–hapësirë) nga një sistem satelitor jo gjeostacionar në shërbimin fiks satelitor është objekt aplikimi të përcaktimeve të Nr. 9.12 për koordinimin e sistemeve të tjera satelitore jo gjeostacionare në shërbimin satelitor fiks. Sistemi satelitor jo gjeostacionar në shërbimin fiks nuk duhet të kërkojë mbrojtje nga rrjetet satelitore gjeostacionare në shërbimin satelitor fiks që operojnë sipas Rregulloreve Radio, që nuk respektojnë datat e marrjes nga Byroja të informacionit të plotë të koordinimit ose të njoftimit, të përshtatshme, për sistemin satelitor jo gjeostacionar në shërbimin satelitor fiks dhe të informacionit të plotë të koordinimit ose të njoftimit, të përshtatshëm, për rrjetet satelitore gjeostacionare, Nr.5.43 nuk aplikohet. Sistemet jo gjeostacionare në shërbimin fiks satelitor në brezat më sipër duhet të operojnë në mënyrë të tillë që çdo interferencë e paparanueshme që mund të ndodhë gjatë operimit të tyre duhet të eliminohet në mënyrë të shpejtë. (WRC–2000)

5.441A Në Brazil, Paraguaj dhe Uruguaj, brezi i frekuencave 4800–4900 MHz, ose pjesë e tyre, është identifikuar për implementimin e Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Ky identifikim nuk pengon përdorimin e këtij brezi nga çdo aplikim i shërbimeve për të cilët është përcaktuar dhe nuk përcakton prioritet në Rregulloret Radio. Përdorimi i brezit të frekuencave për implementimin e IMT është subjekt i arritjes së marrëveshjes me shtetet fqinje dhe stacioni IMT nuk duhet të kërkojë mbrojtje nga stacionet e aplikimeve të tjera të shërbimit të lëvizshëm. Një perdorim i tillë duhet të jetë në përputhje me Rezolutën 223 (Rev. WRC–15). (WRC–15)

5.441B Në Angola, Argjentinë, Armeni, Azerbajxhan, Benin, Botsvana, Brazil, Burkina Faso, Burundi, Kepi i Gjelbërt, Kamboxhia, Kamerun, Kili, Kinë, Kolumbi, Repoblika e Kongos, Bregun e Fildishtë, Xhibuti, Esuatini, Federatën Ruse, Gabon, Gana, , Guinea, Republikën Islamike të Iranit, Irak, Kazakistan, Lao P.D.R., Lesoto, Liberi, Madagaskar, Malaui, Mali, ,Mongoli, Namibi Niger, Ugandë, Uzbekistan, Republikën Demokratike të Kongos, Kirgistan, Republikën Popullore Demokratike të Koresë, Sudan Jugor, Afrikën e Jugut, Çad , Togo, Vietnam, Zambia dhe Zimbabve brezi i frekuencave 4800–4990 MHz, ose pjesë të tyre, është identifikuar për përdorim nga administratat që dëshirojnë të implementojnë Telekomunikacionet e Lëvizshme Ndërkombëtare (IMT). Ky identifikim nuk pengon përdorimin e këtij brezi nga çdo aplikim i shërbimeve për të cilët është përcaktuar dhe nukpërcakton prioritet në Rregulloret Radio. Përdorimi i brezit të frekuencave për implementimin e IMT është subjekt i arritjes së marrëveshjes nën Nr. 9.21, me administratat e interesuara dhe stacionet e IMT nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e aplikimeve të tjera të shërbimeve të lëvizshme. Veç kësaj, para se një administratë të marrë në përdorim një stacion IMT në shërbimin e lëvizshëm, ajo duhet të sigurohet se fuqia e densitetit te fluksit

prodhur nga ky stacion nuk duhet të tejkaloj –155 dB (W/(m2·1MHz)) prodhuar deri në 19 km mbi nivelin e detit në 20 km nga bregdeti, përcaktuar si niveli më i ulët i ujit, e njohur zyrtarisht nga Shteti bregdetar. Zbatohet Rezoluta 223 (Rev.WRC-23). (WRC-23)

5.442 Në brezat 4825–4835 MHz dhe 4950–4990 MHz, përcaktimi i shërbimit të lëvizshëm është kufizuar në shërbimin e lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. Në Rajonin 2 (me përjashtim të Brazilit, Kubës, Guatemalës, Meksikës, Paraguaj, Uruguaj dhe Venezuelë) dhe në Australi, brezi 4825–4835 MHz është i përcaktuar gjithashtu për shërbimin e lëvizshëm aeronautik, kufizuar në telemetri të lëvishme aeronautike për testimin e fluturimit nga stacionet në avion. Përdorime të tilla duhet të jenë në përputhje me Rezolutën 416 (WRC–07) dhe nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme në shërbimin fiks. (WRC–07)

5.443AA Në brezat e frekuencave 5000–5030 MHz dhe 5091–5150 MHz, shërbimi i lëvizshëm aeronautik–satelitor (R) është objekt i marrëveshjes së mbajtur sipas Nr. 9.21. Përdorimi i këtyre brezave nga shërbimi i lëvizshëm aeronautik–satelitor (R) është kufizuar në sistemet aeronautike të standartizuara ndërkombëtarisht. (WRC– 12)

5.443B Në mënyrë që të mos shkaktohet interferencë e dëmshme në sistemet mikrovalore për uljet ajrore që operojnë mbi 5 030 MHz, fuqia agregate e densitetit të fluksit i prodhuar në sipërfaqen e Tokës në brezin 5030–5150 MHz nga të gjitha stacionet hapësinore brenda çdo sistemi të shërbimit të radionavigacionit– satelitor (hapësirë–Tokë) që operojnë në brezin 5010–5030 nuk duhet të tejkalojnë –124.5 dB (W/m2) në një brez prej 150 kHz. Në mënyrë që të mos shkaktohet interferencë e dëmshme në shërbimin e radio astronomisë në brezin e frekuencave 4990–5000 MHz, sistemet e shërbimit satelitor të radionavigacionit që operojnë në brezin e frekuencave 5010–5030 MHz duhet të përputhen me kufijtë në brezin 4 990–5000 MHz të përcaktuar në Rezolutën 741 (Rev.WRC–15). (WRC–15)

5.443C Përdorimi i brezit të frekuencave 5030–5091 MHz nga shërbimi i lëvizshëm aeronautik është i kufizuar në sistemet aeronautike të standartizuara ndërkombëtarisht. Transmetimet e padëshiruara nga shërbimi i lëvizshëm aeronautik në brezin e frekuencave 5030–5091 MHz duhet të kufizohen për të mbrojtur downlink–et e sistemit RNSS në brezin 5010–5030 MHz. Për aq kohë sa një vlerë e përshtatshme është vendosur në Rekomandimin përkatës ITU–R, duhet të përdoret densiteti e.i.r.p me limit prej –75 dBW/MHz në brezin e frekuencës 5010-5030 MHz për emëtimet e padëshiruar për çdo stacion AM(R) S. (WRC–12)

5.443D Në brezin e frekuencave 5030–5091 MHz shërbimi i lëvizshëm aeronautik–satelitor (R) është objekt i koordinimit sipas Nr. 9.11A. Përdorimi i këtij brezi frekuencash nga shërbimi i lëvizshëm aeronautik–satelitor (R) është i kufizuar në sistemet aeronautike të standartizuara ndërkombëtarisht.

5.444 Brezi i frekuencave 5030–5150 MHz është për t'u përdorur për operimin e sistemit të standardit ndërkombëtar (sistem mikrovalor për uljet ajrore) për metodën e saktësimit dhe uljeve ajrore. Në brezin e frekuencave 5030–5091 MHz, kërkesat e këtij sistemi duhet të kenë prioritet ndaj përdorimeve të tjera të këtij brezi. Për përdorimin e brezit të frekuencave 5091– 5150 MHz aplikohet Nr. 5.444A dhe Rezoluta 114 (Rev.WRC– 15). (WRC– 15)

5.444A Përdorimi i brezit të frekuencave 5091–5150 MHz përcaktuar për shërbimin fiks–satelitor (Tokë–hapësirë) është kufizuar në lidhjet fider të sistemeve satelitore jo–gjeostacionare në sistemet satelitore të lëvizshme dhe është objekt për koordinimin nën Nr. 9.11A. Përdorimi i brezit të frekuencave 5091–5150 MHz nga lidhjet fider të sistemeve satelitore jo– gjeostacionare në sistemet satelitore të lëvizshme duhet të jetë subjekt i aplikimit të Rezolutës 114 (Rev. WRC–15). Për më tepër, sigurimi i shërbimit të radionavigimit aeronautik është i mbrojtur nga interferencat e dëmshme, koordimini është i nevojshëm për lidhjen fider të stacionit tokësor të sistemit satelitor jo–gjeostacionar në shërbimin e lëvizshëm satelitor të cilat janë ndarë në më pak se 450 km nga territori i një administrate që operojnë në stacionet tokësor të shërbimit të radionavigimit aeronautik. (WRC–15)

5.444B Përdorimi i brezit 5091–5150 MHz nga shërbimi i lëvizshëm aeronautik është i kufizuar në:
– sistemet që veprojnë në shërbimin e lëvizshëm aeronautik (R) dhe në përputhje me standartet ndërkombetare aeronautike, kufizuar për aplikimet sipërfaqsore në aeroporte. Një përdorim i tillë do të jetë në përputhje me Rezolutën 748 (Rev. WRC–19).
– transmetimet e telemetrisë aeronautike nga stacionet e avionëve (shih nr. 1.83) në përputhje me Rezolutën 418 (Rev.WRC–19). (WRC–19)

5.446 (M) *Përcaktim shtesë*: Në vendet e listuara në shënimin 5.369, brezi i frekuencave 5150–5216 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin e radiopërcaktimit– satelitor (hapësirë–Tokë), objekt i marrëveshjes së arritur nën Nr. 9.21. Në Rajonin 2 (përveç Meksikës), brezi është përcaktuar gjithashtu në një bazë parësore për shërbimin e radiopërcaktimit– satelitor (hapësirë–Tokë). Në Rajonet 1 dhe 3, përveç atyre vendeve të listuara në Nr. 5.369 dhe Bangladeshit, brezi i frekuencave është përcaktuar gjithashtu në bazë dytësore për shërbimin e radiopërcaktimit satelitor (hapësirë–tokë). Përdorimi nga shërbimi i radiopërcaktimit satelitor është i kufizuar në lidhjet fider në bashkëpunim me shërbimin e radiopërcaktimit satelitor që operon në brezat e frekuencave 1610–1626.5 MHz dhe/ose 2483.5–2500 MHz. Fuqia totale e densitetit të fluksit në sipërfaqen e Tokës nuk duhet të tejkalojë në asnjë rast vlerën –159 dB (W/m2) në çdo brez 4 kHz për të gjitha këndet e arritjes. (WRC–15)

5.446A Përdorimi i brezave të frekuencave 5150–5350 MHz dhe 5470–5725 MHz nga stacionet në shërbimin e lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik duhet të jetë në përputhje me Rezolutën 229 (Rev.WRC–23). (WRC–23)

5.446B Në brezin 5150–5250 MHz, stacionet në shërbimin e lëvizshëm nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet tokësore në shërbimin fiks satelitor. Nr. 5.43A nuk aplikohet për shërbimin e lëvizshëm në respekt të stacioneve tokësore të shërbimit fiks satelitor. (WRC– 03)

5.446C *Përcaktim shtesë:* Në Rajonin 1 (përveç në Algjeri, Arabi Saudite, Bahrain, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Irak, Jordani, Kuvait, Liban, Marok, Oman, Katar, Republikën Arabe Siriane, Sudan, Sudanin Jugor dhe Tunizi) , brezi 5150–5250 MHz është gjithashtu i përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e lëvizshëm aeronautik, kufizuar në transmetimet telemetri aeronautike nga stacionet e avionëve (shih Nr. 1.83), në përputhje me Rezolutën 418 (Rev. WRC–19). Këto stacione nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e tjera që operojnë në përputhje me Nenin 5. Nr.5.43A nuk aplikohet. (WRC–19)

5.446D *Përcaktim shtesë*: në Brazil, brezi 5 150-5 250 MHz është ndarë në bazë parësore edhe për shërbimin e lëvizshëm aeronautik, kufizuar në transmetimet telemetri aeronautike nga stacionet e avionëve (shiko Nr. 1.83), në përputhje me Rezolutën 418 (Rev.WRC-19). (WRC-19)

5.447 *Përcaktim shtesë*: në Bregun e Fildishtë, Egjypt, Liban, Republikën Arabe të Sirisë dhe Tunizi, brezi i frekuencave 5150–5250 MHz është gjithashtu i përcaktuar për shërbimin e lëvizshëm në bazë parësore, subjekt i marrëveshjes së arritur nën Nr. 9.21. Në këtë rast, nuk do të aplikohen dispozitat e Rezolutës 229 (Rev.WRC–23). (WRC–23)

5.447A Përcaktimi i shërbimit fiks satelitor (Tokë–hapësirë) është kufizuar në lidhjet fider të sistemeve jo–gjeostacionare satelitore në shërbimin e lëvizshëm satelitor dhe është objekt për koordinimin nën Nr. 9.11A

5.447B *Përcaktim shtesë*: Brezi 5150–5216 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin fiks satelitor (hapësirë– Tokë). Ky përcaktim është kufizuar në lidhjet fider të sistemeve satelitore jo–gjeostacionare në shërbimin e lëvizshëm satelitor dhe është objekt i dispozitave të Nr. 9.11A. Fuqia e Densiteti të fluksit në sipërfaqen e Tokës prodhuar nga stacionet hapësinore të shërbimit fiks satelitor që operojnë në drejtimin hapësirë–Tokë në brezin 5150–5216 MHz nuk do të tejkalojë në asnjë rast –164 dBW/m2 ne çdo diapazon 4 kHz për të gjitha këndet e arritjes.

5.447C Administrat përgjegjëse për rrjetet e shërbimit fiks satelitor në brezin 5150–5250 MHz që operojnë nën shënimin. 5.447A dhe 5.447B duhet koordinohen në bazë të një barazie në përputhje me Nr.9.11A me administratat përgjegjëse për rrjetet satelitore jo–gjeostacionare që operojnë nën Nr. 5.446 dhe janë sjellë brenda përdorimit pas 17 Nëntorit 1995. Rrjetet satelitore që operojnë nën Nr. 5.446 të vëna në përdorim pas 17 Nëntorit 1995 nuk do të kërkojnë mbrojtje dhe nuk do të shkaktojnë interferenca të dëmshme në stacionet e shërbimit fiks satelitor që operojnë nën shënimin Nr. 5.447A dhe 5.447B.

5.447D Përcaktimi i brezit 5250–5255 MHz për shërbimet e kërkimit hapësinor në bazë parësore është i kufizuar për sensorët aktive të transportuar në hapësirë. Përdorimet e tjera të brezit nga shërbimet e kërkimeve hapësinore janë në bazë dytësore. (WRC– 97)

5.447F Në brezin e frekuencave 5250–5350 MHz, stacionet në shërbimin e lëvizshëm nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga shërbimi i radiovendndodhjes, shërbimi (aktiv) satelitor i eksplorimit të Tokës dhe shërbimi (aktiv) i kërkimeve hapësinore. Shërbimi i radiovendndodhjes, shërbimi (aktiv) satelitor i eksplorimit të Tokës dhe shërbimi (aktiv) i kërkimeve hapësinore nuk duhet të imponojnë në shërbimin e lëvizshëm, kritere më të rrepta sesa ato të përcaktara në Rezolutën 229 (Rev. WRC-23) (WRC-23)

5.448 *Përcaktim shtesë*: Në Kirgizstan, Rumani dhe Turkmenistan, brezi 5250–5350 MHz është përcaktuar gjithashtu në një bazë parësore për shërbimin e radionavigacionit. (WRC– 19)

5.448A Shërbimet satelitor (aktiv) për eksplorimin e Tokës dhe kërkimit hapësinor (aktiv) në brezin 5250–5350 MHz nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga shërbimi i radiovendndodhjes. Nr 5.43° nuk aplikohet. (WRC–03)

5.448B Shërbimi satelitor (aktiv) i eksplorimit të Tokës që operon në brezin 5350–5570 MHz dhe shërbimi i kërkimit hapësinor (aktiv) që operon në brezin 5460–

5570 MHz nuk duhet ti shkaktojë interferencë të dëmshme shërbimit të radionavigacionit aeronautik në brezin 5350–5460 MHz, shërbimit të radionavigacionit në brezin 5460–5470 MHz dhe shërbimit të radionavigacionit detar në brezin 5470–5570 MHz. (WRC– 03)

5.448C Shërbimi (aktiv) i kërkimit hapësinor që operon në brezin 5350–5460 MHz nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme, as të kërkojë mbrojtje nga shërbimet e tjera për të cilat ky brez është përcaktuar. (WRC– 03)

5.448D Në brezin 5350–5470 MHz, stacionet në shërbimin e radiovendndodhjes nuk duhet të shkaktojnë interfencë të dëmshme, as të kërkojnë mbrojtje nga sistemet radar në shërbimin e radionavigacionit aeronautik që operojnë në përputhje me Nr. 5.449. (WRC– 03)

5.449 Përdorimi i brezit 5350–5470 MHz nga shërbimi i radionavigacionit aeronautik është kufizuar në radarët e avionëve dhe në sinjalet në bordet e anijeve.

5.450 *Përcaktim shtesë:* Në Austri, Azerbajxhan, Iran (Republika Islamike e), Kirgizstan, Rumani, Turkmenistan dhe Ukrainë, brezi 5470–5650 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin e radionavigacionit aeronautik. (WRC– 12)

5.450A Në brezin e frekuencave 5470–5725 MHz, stacionet në shërbimin e lëvizshëm nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga shërbimet e radiopërcaktimit. Shërbimet e radiopërcaktimit nuk duhet të imponojnë në shërbimin e lëvizshëm kritere më të rrepta sesa ato të përcaktuar në Rezolutën 229 (Rev. WRC-23). (WRC– 23)

5.450B Në brezin 5470–5650 MHz, stacionet në shërbimin e radiovendndodhjes, përveç radarëve me bazë në tokë të përdorur për qëllime meteorologjike në brezin 5600–5650 MHz, nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme, as të kërkojnë mbrojtje nga sistemet radare në shërbimin e radionavigacionit detar. (WRC– 03)

5.451 *Përcaktim shtesë*: Në Mbretërinë e Bashkuar, brezi 5470–5850 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë dytësore për shërbime të lëvizshme tokësore. Limitet e fuqisë të përcaktuara në pikat 21.2, 21.3, 21.4 dhe 21.5 do të zbatohen për brezin 5725-5850 MHz.

5.452 Midis 5600 MHz dhe 5650 MHz, radarët tokësorë të përdorur për qëllime meteorologjike janë të autorizuar të veprojnë në bazë të barazisë me stacionet e shërbimit detar të radionavigacionit.

5.453 *Përcaktim shtesë:* në Arabi Saudite, Bahrein, Bangladesh, Brunei Darusalam, Kamerun, Kinë, Republikën e Kongos, Republikën e Koresë, Bregun e Fildishtë, Xhibuti, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Esuatini, Gabon, Guinea, Guinea Ekuatoriale, Indi, Indonezi, Republikën Islamike të Iranit, Irak, Japoni, Jordani, Kenia, Kuvajt, Liban, Libi, Madagaskar, Malajzi, Niger, Nigeri, Oman, Ugandë, Pakistan, Filipine, Katar, Republikën Arabe të Sirisë, Republikën Popullore Demokratike të Koresë, Singapor, Somali, Sri Lanka, Tanzani, Çad, Tajlandë, Togo, Vietnam dhe Jemen, brezi i frekuencave 5650-5850 MHz gjithashtu është përcaktuar në bazë parësore për shërbime fikse dhe të lëvizshme. Në këtë rast, përcaktimet e Rezolutës 229 (Rev. WRC-23) nuk do të zbatohen. Për më tepër, në Afganistan, Angolë, Benin, Butan, Botsvana, Burkina Faso, Burundi, Republikën Demokratike të Kongos, Fixhi, Gana,

Kiribati, Lesoto, Malaui, Maldive, Mauritius, Mikronezi, Mongoli, Mozambik, Mianmar, Namibi, Nauru, Zelandën e Re, Papua Guinea e Re, Ruandë, Ishujt Solomon, Sudanin Jugor, Afrikën e Jugut, Tonga, Vanuatu, Zambia dhe Zimbabve, brezi i frekuencave 5725-5850 MHz është përcaktuar në bazë parësore për shërbime fikse, dhe stacionet që veprojnë në shërbimet fikse nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme dhe nuk duhet të kërkojnë mbrojtje për shërbime të tjera parësore në këtë brez. (WRC-23)

5.454 *Kategori të ndryshme shërbimi*: Në Azerbajxhan, Federatën Ruse, Gjeorgji, Kirgizstan, Taxhikistan dhe Turkmenistan, përcaktimi i brezit 5670–5725 MHz për shërbimin e kërkimeve hapësinore është në një bazë parësore (shih Nr. 5.33). (WRC– 12)

5.455 *Përcaktim shtesë*: Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Kubë, Gjeorgji, Hungari, Kazakistan, Moldavi, Uzbekistan, Kirgizstan, Rumani, Federatën Ruse, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Ukrainë, brezi 5670–5850 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin fiks. (WRC– 19)

5.457 Në Australi, Burkina Faso, Bregun e Fildishtë, Mali dhe Nigeri përcaktimi i brezave 6440– 6520 MHz (drejtimi HAPS–Tokë) dhe 6560–6640 MHz (drejtimi Tokë–HAPS) për shërbimin fiks mund të përdoret gjithashtu dhe nga lidhjet gateway për stacionet HAPS në platforma më lartësi të lartë brenda territorit të këtyre vendeve. Përdorime të tilla janë të kufizuara të operojnë në lidhjet gateway HAPS dhe nuk duhet të shkaktojnë interferenaca të dëmshmë në shërbimet ekzistuese dhe nuk duhet të kërkojnë mbrojtje ndaj tyre si dhe duhet të jenë në përputhje me Rezolutën 150 (WRC–12). Shërbimet ekzistuese nuk duhet të jenë në kundërshtim të zhvillimit në të ardhmen të lidhjeve gateway HAPS. Përdorimi i lidhjeve gateway HAPS në këto breza kërkon marrëveshje eksplicite me administratat e tjera, territori i të cilave pozicionohet brenda 1000 km nga kufiri i një administrate që pretendon të përdorë lidhjet gateway HAPS. (WRC– 12).

5.457A Në brezat e frekuencave 5925–6425 MHz dhe 14–14.5 GHz, stacionet tokësore që ndodhen në bordet e anijeve mund të komunikojnë me stacionet hapësinore të shërbimit satelitor fiks. Një përdorim i tillë duhet të jetë në përputhje me Rezolutën 902 (Rev.WRC-23). Në brezin e frekuencave 5925–6425 MHz, stacionet tokësore që ndodhen në bordet e anijeve që komunikojnë me stacionet hapësinore të shërbimit satelitor fiks mund të përdorin antena transmetuese me minimumin e diametrit 1.2 m dhe të operojnë pa marrëveshje paraprake të ndonjë administrate nëse pozicionohen të paktën 330 km larg nga treguesi i ulët i ujit zyrtarisht i njohur nga Shteti bregdetar. Të gjitha dispozitat e tjera të Rezolutës 902 (Rev.WRC–23) duhet të aplikohen. (WRC-23)).

5.457B Në brezat e frekuencave 5925–6425 MHz dhe 14–14.5 GHz, stacionet tokësore që ndodhen në bordet e anijeve mund të operojnë me karakteristikat dhe sipas kushteve të përfshira në Rezolutën 902 (Rev.WRC-23)në Algjeri, Arabi Saudite, Bahrein, Komoros, Xhibuti, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Jordani, Kuvajti, Libia, Maroku, Mauritania, Oman, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Sudan, Tunizi dhe Jemen, në bazë dytësore për shërbimin e lëvizshëm detar –satelitor. Një përdorim i tillë duhet të jetë në përputhje me Rezolutën 902 (Rev.WRC-23). (WRC-23)

5.457C Në Rajonin 2 (me përjashtim të Brazilit, Kubës, Territoret dhe Komunitetet e Francës përtej oqeanit, Guatemala, Meksikë, Paraguaj, Uruguaj dhe Venezuelë), brezi i frekuencës 5925–6700 MHz mund të përdoret nga shërbimi i lëvizshëm aeronautik telemetri, për testimet e fluturimit nga stacionet e

avionëve (shiko nr.1.83). Përdorime të tilla duhet të jenë në përputhje me Rezolutën 416 (WRC–07) dhe nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshmë ose ;të kërkojnë mbrojtje nga shërbimet fikse dhe fikse – satelitore. Çdo përdorim i tillë nuk përjashton përdorimin e këtij brezi frekuence nga aplikacionet e tjera të shërbimit të lëvizshëm ose nga shërbime të tjera për të cilat ky brez frekuence është përcaktuar për përdorim të përbashkët parësor dhe nuk vendos prioritet në Rregulloret Radio. (WRC–15).

5.457D Në Kamboxhia, Lao P.D.R. dhe Maldive, brezi i frekuencave 6 425-7 025 MHz është identifikuar për komponentin tokësor të Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtij brezi të frekuencës nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u është caktuar dhe nuk vendoset prioritet në Radio Rregulloret. Zbatohet Rezoluta 220 (WRC-23). (WRC-23)

5.457E Brezi i frekuencave 6 425-7 125 MHz në Rajonin 1 dhe 7 025-7 125 MHz në Rajonin 3 janë identifikuar për përdorim nga administratat që dëshirojnë të zbatojnë komponentin tokësor të Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtyre brezave të frekuencave nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u janë caktuar dhe nuk vendoset prioritet në Radio Rregulloret. Zbatohet Rezoluta 220 (WRC-23). Brezat e frekuencave përdoren gjithashtu për zbatimin e sistemeve të aksesit pa tel (WAS), duke përfshirë rrjetet lokale të radios (RLAN). (WRC-23)

5.457F Në Brazil dhe Meksikë, brezi i frekuencave 6 425-7 125 MHz është identifikuar për komponentin tokësor të Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Përdorimi i këtij brezi frekuencor për zbatimin e IMT-së është subjekt i kërkimit të marrëveshjes me vendet fqinje sipas Nr. 9.21. Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtij brezi frekuencor nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u është caktuar dhe nuk vendos prioritet në Radio Rregulloret. Zbatohet Rezoluta 220 (WRC 23). Brezi i frekuencës përdoret gjithashtu për zbatimin e sistemeve të aksesit pa tel (WAS), duke përfshirë rrjetet lokale të radios (RLAN). (WRC-23)

5.458 Në brezin 6425–7075 MHz, matjet e sensorëve mikrovalor pasivë janë kryer sipër oqeaneve. Në brezin 7075–7250 MHz, janë kryer matjet e sensorëve mikrovalorë pasivë. Administratat duhet të marrin parasysh nevojat e shërbimeve të eksplorimit satelitor të Tokës (pasivë) dhe kërkimit hapësinor (pasive) në planifikimin e ardhshëm të tyre për brezat 6425–7025 MHz dhe 7075–7250 MHz.

5.458A Në dhënien e frekuencave në brezin 6700–7075 MHz për stacionet hapësinore të shërbimit fiks satelitor, administratat janë të detyruara të marrin të gjitha masat për mbrojtjen e vëzhgimeve të linjave spektrale të shërbimit radio astronomi në brezin 6650–6675.2 MHz nga interferencat e dëmshme shkaktuar nga emetimet e padëshiruara.

5.458B Përcaktimi hapësirë–Tokë i shërbimit fiks satelitor në brezin 6700–7075 MHz është kufizuar në lidhjet fider për sistemet satelitore jo–gjeostacionare për shërbimin e lëvizshëm satelitor dhe është objekt për koordinimin nën Nr. 9.11A. Përdorimi i brezit 6700–7075 MHz (hapësirë– Tokë) nga lidhjet fider për sistemet satelitore jogjeostacionare në shërbimin e lëvizshëm satelitor nuk është objekt për Nr.22.2.

5.459 *Përcaktim shtesë*: Në Federatën Ruse, brezi 7100–7155 MHz dhe 7190–7235 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin e kërkimeve hapësinore (Tokë–hapësirë), objekt per marreveshjen e arritur nën Nr. 9.21. Në brezin e frekuencave 7190–7235 MHz, në lidhje me shërbimin e eksplorimit satelitor të Tokës (Tokë–hapësirë), Nr. 9.21 nuk aplikohet. (WRC–15)

5.460 Asnjë emëtim nga sistemi i shërbimit të kërkimit hapësinor (Tokë–hapësirë) destinuar për hapësirën e thellë do të prekin brezin e frekuencave 7190–7235 MHz. Satelitët gjeostacionarë në shërbimin e kërkimit hapësinor që operojnë në brezin 7190–7235 MHz nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet egzistuese dhe stacionet e të ardhmes të shërbimit fiks dhe të lëvizshëm. Nr.5.43A nuk aplikohet. (WRC– 15)

5.460A Përdorimi i brezit të frekuencave 7190–7250 MHz (Tokë–hapësirë) nga shërbimi i eksplorimit satelitor të Tokës duhet të limitohet tek gjurmimi, telemetria dhe komandat për operimin e anijeve kozmike. Stacionet hapësinore që operojnë në shërbimin e eksplorimit satelitor të Tokës (Tokë–hapësirë) në brezin e frekuencave 7190–7250 MHz nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet ekzistuese dhe stacionet e së ardhmes në shërbimin fiks dhe të lëvizshëm. Nuk aplikohet shënimi Nr. 5.43A. Aplikohet Nr. 9.17. Përveç kësaj, për të siguruar mbrojtje të stacioneve ekzistuese dhe të së ardhmes në shërbimet fikse dhe të lëvizshme, pozicioni i stacionit tokësor që mbështet anijen kozmike në shërbimin e eksplorimit satelitoror të Tokës në orbitën jo–gjeostacionare ose orbitën stacionare duhet të ruaj një distancë të pakten 10 km dhe 50 km, përkatësisht, nga kufiri respektiv i shtetit fqinj, vetëm nëse një distancë e shkurtër është rënë dakort ndryshe mës administrative korresponduese. (WRC–15)

5.460B Stacionet hapësinore në orbitën gjeostacionare që operojnë në shërbimin e eksplorimit satelitor të Tokës (Tokë–hapësirë) në brezin e frekuencave 7 190 – 7 235 MHz nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet ekzistuese dhe stacionet e së ardhmës në shërbimin e kërkimit hapësinor si dhe nuk aplikohet shënimi Nr. 5.43A. (WRC–15)

5.461 *Përcaktim shtesë*: brezat e frekuencave 7250–7375 MHz (hapësirë–Tokë) dhe 7900–8025 MHz (Tokë–hapësirë) janë gjithashtu të përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e lëvizshëm satelitor, objekt për marreveshjen e arritur nën Nr. 9.21. me përjashtim që Nr. 9.21 nuk do të zbatohet për rrjetet satelitore-gjeostacionare në shërbimin satelitor të lëvizshëm për të cilin Byroja merr informacion të plotë të koordinimit që nga 1 Janari 2025 në lidhje me sistemet satelitore-jogjeostacionare për të cilat informacioni i plotë i koordinimimit, sipas rastit, merret nga Byroja që nga data 1 Janar 2025. Sistemet satelitore-jogjeostacionare për të cilat informacioni i plotë i koordinimit ose njoftimit, sipas rastit, merret nga Byroja më 1 Janar 2025, nuk do të shkaktojë interferencë të papranueshme dhe nuk do të kërkojë mbrojtje nga rrjetet satelitore-gjeostacionare në shërbimin e lëvizshëm satelitor që funksionon në përputhje me këto rregullore. Nr. 5.43A nuk zbatohet. (WRC-23)

5.461A Përdorimi i brezit 7450–7550 MHz nga shërbimi satelitor meteorologjik (hapësirë– Tokë) është i kufizuar për sistemet satelitore gjeostacionare. Sistemet satelitore meteorologjike jo gjeostacionare në këtë brez njoftuar para 30 Nëntorit 1997 mund të vazhdojnë të operojnë në bazë parësore deri në fund të jetëgjatësisë së tyre. (WRC– 97)

5.461AA Përdorimi i brezit të frekuencave 7375–7750 MHz nga shërbimi i lëvizshëm detar – satelitor është i limituar në rrjetet satelitore gjeostacionare. (WRC–15)

5.461AB	Në brezin e frekuencave 7375–7750 MHz, stacionet tokësore në shërbimin e lëvizshëm detar–satelitor nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga, as të kufizojnë përdorimin dhe zhvillimin e, stacioneve në shërbimet fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. Nr 5.43A nuk aplikohet. (WRC–15)
5.461AC	5.461AC Në brezin e frekuencave 7375-7750 MHz, sistemet satelitore-jogjeostacionare që operojnë në shërbimin satelitor fiks për të cilin informacioni i plotë i koordinimit ose njoftimit, sipas rastit, merret nga Byroja që nga data 1 Janar 2025, nuk do të shkaktojë interferencë të papranueshme dhe nuk do të pretendojnë mbrojtje nga rrjetet satelitore-gjeostacionare në shërbimin satelitor te levizhëm detar që funksionon në përputhje me këto rregullore. Nr. 5.43A nuk zbatohet. (WRC-23)
5.461B	Përdorimi i brezit 7750–7900 MHz nga shërbimi satelitor meteorologjik (hapësirë–Tokë) është i kufizuar për sistemet satelitore jo gjeostacionare. (WRC–12)
5.462A	Në Rajonet 1 dhe 3 (përveç Japonisë), në brezin 8 025–8 400 MHz, shërbimi satelitor i eksplorimit të Tokës që përdor satelitë gjeostacionarë nuk duhet të prodhojë një fuqi të densitetit të fluksit në tejkalim të vlerave të mëposhtme të përcaktuara për këndet e arritjes (Θ), pa pëlqimin e administratës së prekur: –135 dB(W/m2) në një brez prej 1 MHz për $0° \leq \theta < 5°$ $-135 + 0.5\ (\theta - 5)$ dB (W/m2) në një brez prej 1 MHz për $5° \leq \theta < 25°$ –125 dB(W/(m2) në një brez prej 1 MHz për $25° \leq \theta \leq 90°$ (WRC– 12)
5.463	Stacionet e avionëve nuk lejohet të transmetojnë në brezin 8025–8400 MHz. (WRC– 97)
5.465	Në shërbimin e kërkimeve hapësinore, përdorimi i brezit 8400–8450 MHz është kufizuar për hapësirën e thellë.
5.466	Kategori të ndryshme shërbimi: Në Singapor dhe Sri Lanka, përcaktimi i brezit 8400–8500 MHz për shërbimin e kërkimit hapësinor është për përdorim dytësor (shih nr. 5.32). (WRC-12)
5.468	*Përcaktim shtesë*: Në Arabinë Saudite, Bahrain, Bangladesh, Brunei Darussalam, Burundi, Kamerun, Kina, Kongo (Republika e), Xhibuti, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Esuatini Gabon, Guajana, Indonezi, Irani (Republika Islamike e), Iraku, Xhamajka, Jordania, Kenia, Kuvajti, Libani, Libia, Malajzia, Mali, Marok, Mauritani, Nepali, Nigeria, Omani, Uganda, Pakistani, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Republika Popullore Demokratike e Koresë, Senegal, Singapor, Somali, Sudani, , Çad, Togo, Tunizi dhe Jemen, brezi i frekuencave 8500–8750 MHz është përcaktuar gjithashtu për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm në një bazë parësore. (WRC–19)
5.469	*Përcaktim shtesë*: Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Federatën Ruse, Gjeorgji, Hungari, Lituani, , Uzbekistan, Poloni, Kirgizstan, Republikën Çeke, Rumani, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Ukrainë, brezi i frekuencave 8500–8750 MHz është përcaktuar gjithashtu në një bazë parësore për shërbimin e lëvizshëm dhe radionavigacion. (WRC– 23)
5.469A	Në brezin 8550–8650 MHz, stacionet në shërbimin e eksplorimit satelitor të Tokës (aktive) shërbimit të kërkimit hapësinor (aktiv) nuk duhet të shkatojnë interferencë të dëmshme, ose të detyrojnë përdorimin dhe zhvillimin e stacioneve të shërbimit të radiovendndodhjes. (WRC–97)

5.470	Përdorimi i brezit 8750–8850 MHz nga shërbimi i radionavigacionit aeronautik është kufizuar në ndihmat Doppler të navigacionit në bordet e anijeve me një frekuencë qendrore të 8800 MHz.
5.471	*Përcaktim shtesë*: në Algjeri, Gjermani, Bahrain, Belgjikë, Kinë, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Francë, Greqi, Indonezi, Iran (Republika Islamike e), Libi, Hollandë, Katar dhe Sudan, brezat e frekuencave 8825–8850 MHz dhe 9000–9200 MHz janë gjithashtu të përcaktuar në bazë parësore për shërbimin e radionavigacionit detar, për përdorim vetëm nga radarët me bazë në bregdet. (WRC– 15)
5.472	Në brezat 8850–9000 MHz dhe 9200–9225 MHz, shërbimi i radionavigacionit detar është kufizuar në radarët me bazë në bregdet.
5.473	*Përcaktim shtesë*: Në Armeni, Austri, Azerbajxhan, Bjellorusi, Kubë, Gjeorgji, Hungari, Uzbekistan, Poloni, Kirgizstan, Rumani, Federatën Ruse, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Ukrainë, brezat 8850–9000 MHz dhe 9200–9300 MHz janë përcaktuar gjithashtu në një bazë parësore për shërbimin e radionavigacionit. (WRC–19)
5.473A	Në brezin 9000–9200 MHz, stacionet që veprojnë në shërbimin e radiopërcaktimit nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga sistemet e përcaktuara në shënimin 5.337 që operojnë në shërbimin e radionavigacionit aeronautik ose sistemet radar për shërbimin e radionavigacionit detar të përcaktuar në bazë parësore për vendet e listuara në shënimin 5.471. (WRC–07)
5.474	Në brezin 9200–9500, transponderat e kërkimit dhe shpëtimit (SART) mund të përdoren, duke pasur parasysh Rekomandimin e duhur të ITU–R (shiko gjithashtu nenin 31).
5.474A	Përdorimi i brezave të frekuencave 9200–9300 MHz dhe 9900–10400 MHz, nga shërbimet e eksplorimit satelitor të Tokës (aktiv), është i kufizuar në sistemet që kërkojnë një brez më të madh se 600 MHz, që nuk mund të vendosen plotësisht brenda brezit të frekuencave 9300–9900 MHz. Një përdorim i tillë është subjekt i marrëveshjes që arrihen nën 9.21 nga Algjeria, Arabia Saudite, Bahrein, Egjipt, Indonezi, Iran (Republika Islamike e), Liban dhe Tunizi. Një administratë që nuk është përgjigjur nën Nr 9.52 konsiderohet që nuk ka rënë dakord për kërkesën e koordinimit. Në këtë rast, administrata njoftuese e sistemit satelitor që operon në shërbimin e eksplorimit satelitor të Tokës (aktiv) mund të kërkojë ndihmën e Zyrës nën Nën–Seksionit IID të Nenit 9. (WRC–15)
5.474B	Stacionet që operojnë në shërbimin e eksplorimit satelitor të Tokës (aktiv) duhet të përputhen me Rekomandimin ITU–R RS.2066–0. (WRC–15)
5.474C	Stacionet që operojnë në shërbimin e eksplorimit satelitor të Tokës (aktiv) duhet të përputhen me Rekomandimin ITU–R RS.2065–0. (WRC–15)
5.474D	Stacionet në shërbimin satelitor për eksplorimin e Tokës (aktiv) nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme në, ose të kërkojnë mbrojtje nga shërbimet detare të stacioneve të radionavigacionit dhe radiopërcaktimit në brezin e frekuencave 9200–9300 MHz, radionavigacioni dhe shërbimi i radiopërcaktimit në brezin e frekuencave 9900–10000 MHz dhe shërbimin e radiopërcaktimit në brezin e frekuencave 10.0–10.4 GHz. (WRC–15)

5.475	Përdorimi i brezit 9300–9500 MHz nga shërbimi i radionavigacionit aeronautik është i kufizuar për radarët e motit në ajër dhe radarët me bazë në tokë. Veç kësaj, sinjalet radio të radarëve me bazë në tokë në shërbimin e radinavigacionit aeronautik lejohen në brezin 9300 –9320 MHz me kusht që të mos shkaktohen interferenca të dëmshme në shërbimin e radionavigacionit detar. Në brezin 9300–9500 MHz radarët me bazë në tokë të përdorur për qëllime meteorologjike kanë prioritet mbi paisjet e radiovendndodhjes. (WRC-07)
5.475A	Përdorimi i brezit 9300–9500 MHz nga shërbimi satelitor për Eksplorimin e Tokës (aktive) dhe shërbimi i kërkimin hapësinor (aktive) është i kufizuar në sistemet që kërkojnë gjërëzi brezi të nevojshme më të madh se 300 MHz që nuk mund të vendosen plotësisht brenda brezit 9500–9800 MHz. (WRC–07)
5.475B	Në brezin 9300–9500 MHz, stacionet që operojnë në shërbimin e radiopërcaktimit nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga radarët që operojnë në shërbimin e radionavigacionit në përputhje me Rregulloret Radio. Radaret me bazë tokësore që përdoren për qëllime meteorologjike kanë prioritet mbi përdorimet e tjera të radiopërcaktimit. (WRC–07)
5.476A	Në brezin 9300–9800 MHz, stacionet në shërbimin (aktiv) të eksplorimit satelitor të Tokës dhe shërbimi (aktiv) i kërkimit hapësinor nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme, dhe as të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e shërbimeve të radionavigacionit dhe të radiovendndodhjes. (WRC– 07)
5.477	*Kategori të ndryshme shërbimi*: Në Algjeri, Arabinë Saudite, Bahrain, Bangladesh, Brunei Darussalam, Kamerun, Xhibuti, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Eritrea, Etiopi, Guine, Indi, Indonezi, Iran (Republika Islamike e), Irak, Xhamaika, Japoni, Jordani, Kuvait, Liban, Liberi, Malajzi, Nigeri, Oman, Pakistan, Katar, Republika Arabe Siriane, Republika Popullore Demokratike e Koresë, Singapor, Somali, Sudan, Sudani Jugor, Trinidad dhe Tobago, Uganda dhe Jemen, brezi 9800–10000 MHz është përcaktuar për përdorim parësorë për shërbimin fiks (shiko Nr.5.33). (WRC–15).
5.478	*Përcaktim shtesë:* Në Azerbajxhan, Kirgizstan, Rumani, Turkmenistan dhe Ukrainë, brezi 9800–10000 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin e radionavigacionit. (WRC– 19)
5.478A	Përdorimi i brezit 9800–9900 MHz nga shërbimi satelitor i Eksplorimit të Tokës (aktive) dhe shërbimi i kërkimit hapësinor (aktive) është i kufizuar në sistemet që kërkojnë gjërësi brezi të nevojshme më të madhe se 500 MHz që nuk mund të vendosen plotësisht brenda brezit 9 300– 9 800 MHz. (WRC–07)
5.478B	Në brezin 9800–9900 MHz, stacionet e shërbimit satelitor të eksplorimit të tokës (aktive) dhe shërbimit të kërkimit hapësinor (aktive) nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e shërbimit fiks të cilëve iu është caktuar ky brez në bazë dytësore. (WRC–12)
5.479	Brezi 9975–10025 MHz është përcaktuar gjithashtu në bazë dytësore për shërbimin satelitor meteorologjik për përdorim nga radarët e motit.
5.480	*Përcaktim shtesë* : në Argjentinë, Brazil, Kili, Kolumbi, Kosta Rika, Kubë, Republikën Domenikane, El Salvador, Ekuador, Guatemalë, Honduras, Xhamajka, Meksikë, Paraguaj, vendet dhe territoret e huaja brenda Mbretërisë së Holandës në rajonin 2, Peru, Surinam dhe Uruguai, brezi i frekuencës 10-

10,45 GHz është gjithashtu i përcaktuar për shërbimet fikse dhe të lëvizshme në bazë primare. Në Venezuelë, brezi i frekuencës 10-10,45 GHz është përcaktuar gjithashtu për shërbimin fiks në bazë parësore. (WRC-23)

5.480A Në vendet e mëposhtme në Rajonin 2: Brazil, Kolumbia, Kosta Rika, Kuba, Republika Domenikane, Ekuador, Guatemala, Xhamajka, Meksikë, Paraguaj, Peru dhe Uruguai, brezi i frekuencës 10-10.5 GHz është identifikuar për implementimin e komponentit tokësor të Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Zbatimi i këtij identifikimi në Meksikë është subjekt i arritjes së marrëveshjes me Shtetet e Bashkuara nën Nr. 9.21. Përdorimi i brezit të frekuencës 10-10,5 GHz nga stacionet IMT në shërbimin e lëvizshëm nuk do të kërkojë mbrojtje nga sistemet në shërbimin e radiolokacionit. Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtij brezi të frekuencave nga ndonjë aplikim i shërbimeve të cilave u është caktuar dhe nuk vendos prioritet në Radio Rregulloret. Zbatohet Rezoluta 219 (WRC-23). (WRC-23)

5.481 *Përcaktim shtesë*: Në Algjeri, Gjermani, Angola, Brazil, Kinë, Kolumbi, Kosta Rika,Bregu i Fildishtë, Kuba, Xhibuti, Republika Domenikane, Egjipt, El Salvador, Ekuador, Spanjë, Guatemala, Hungari, Xhamajka, Japoni, Kenia, Marok, Meksikë, Nigeri, Oman, Uzbekistan, Pakistan, Palestinë, Paraguaj, Peru, Republika Popullore Demokratike e Koresë, Rumani, Somali, Suriname ,Tunizi dhe Uruguaj, brezi i frekuencave 10.45– 10.5 GHz është përcaktuar gjithashtu në një bazë parësore për shërbimet fiks dhe të lëvizshëm. (WRC–23)

5.482 Në brezin 10.6–10.68 GHz, fuqia e shpërndarë në antenë të stacioneve të shërbimeve fiks dhe i lëvizshëm, përveç i lëvizshëm aeronautik nuk do të tejkalojë vlerën – 3dBW. Këto kufij mund të jenë kaluar duke u mbështetur në marrëveshjen e arritur nën Nr. 9.21. Megjithatë, në Algjeri, Arabinë Saudite, Armeni, Azerbajxhan, Bahrain, Bangladesh, Bjellorusi, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Gjeorgji, Indi, Indonezi, Iran (Rep Islamike e), Irak, Jordani, Jamahiriya Arabe Libaneze, Kazakistan, Kuvait, Libi, Marok, Mauritania, Moldavi, Nigeri, Oman, Uzbekistan, Pakistan, Filipine, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Kirgistan, Singapor, Taxhikistan, Tunizi, Turkmenistan dhe Vietnam, kufizimet në shërbimet fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të levizshëm aeronautik, nuk janë të aplikueshme.
(WRC– 07)

5.482A Për ndarjen e brezit 10.6–10.68 GHz ndërmjet shërbimit të Eksplorimit Satelitor të Tokës (pasiv) dhe shërbimeve fikse dhe të lëvizshme përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik, do të zbatohet Rezoluta 751 (WRC–07). (WRC–07)

5.483 *Përcaktim shtesë*: Në Arabinë Saudite, Armeni, Azerbajxhan, Bahrein, Bjellorusi, Kinë, Kolumbi, Republikën e Koresë, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Gjeorgji, Iran (Republika Islamike e), Irak, Izrael, Jordani, Kazakistan, Kuvait, Liban, Mongoli, Katar, Kirgizstan, Republikën Popullore Demokratike të Koresë, Taxhikistan, Turkmenistan dhe Jemen, brezi 10.68–10.7 GHz është përcaktuar gjithashtu në një bazë parësore për sheërbimet fiks dhe të lëvizshëm, përveç i lëvizshëm aeronautik. Një përdorim i tillë është i kufizuar në pajisjet që janë në operim nga data 1 janar 1985. (WRC– 19)

5.484 Në Rajonin 1, përdorimi i brezit 10.7–11.7 GHz nga shërbimi fiks satelitor (Tokë–hapësirë) është kufizuar në lidhjet fider për shërbimin radioteleviziv–satelitor.

5.484A	Përdorimi i brezave të frekuencave 10.95–11.2 GHz (hapësirë–Tokë), 11.45–11.7 GHz (hapësirë–Tokë), 11.7–12.2 GHz (hapësirë–Tokë) në Rajonin 2, 12.2–12.75 GHz (hapësirë–Tokë) në Rajonin 3, 12.5–12.75 GHz (hapësirë–Tokë) në Rajonin 1, 13.75–14.5 GHz (Tokë–hapësirë), 17.3–17.7 GHz (hapësirë–Tokë) në Rajonin 2 17.8-18.6 GHz (hapësirë-Tokë) 19.7–20.2 GHz (hapësirë–Tokë), 27.5–28.6 GHz (Tokë–hapësirë), 29.5–30 GHz (Tokë–hapësirë) nga një sistem satelitor-jogjeostacionar në shërbimin satelitor fiks është subjekt i aplikimit të përcaktimeve të Nr. 9.12 për koordinim me sistemet e tjera satelitore-jogjeostacionare në shërbimin satelitor fiks. Sistemet satelitore-jogjeostacionare në shërbimin satelitor fiks nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga rrjetet satelitore-gjeostacionare në shërbimin satelitor fiks që operojnë në përputhje me Rregulloret Radio, që nuk respektojnë datat e marrjes nga Byroja të informacionit të plotë të koordinimit ose njoftimit, siç duhet, për sistemet satelitore - jogjeostacionare në shërbimin satelitor fiks dhe të informacionit të plotë të koordinimit ose njoftimit, siç duhet, për rrjetet satelitore-gjeostacionare, dhe Nr. 5.43A nuk aplikohet. Sistemet satelitore-jogjeostacionare në shërbimin fiks satelitor në brezat e mësipërm duhet të operojnë në mënyrë të atillë që çdo interferencë e papranueshme që mund te ndodhi gjatë operimit të tyre duhet të eliminohet shpejt. Në Rajonin 2, Nr. 22.2 do të vazhdojë të zbatohet në brezin e frekuencave 17.3-17.7 GHz. (WRC-23)
5.484B	Rezoluta 155 (WRC–15) do të aplikohet. (WRC–15)
5.487	Në brezin 11.7–12.5 GHz në Rajonet 1 dhe 3 shërbimet fiks, fiks satelitor, i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik, dhe radioteleviziv, në përputhje me përcaktimet e tyre përkatëse, nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e shërbimit radioteleviziv satelitor, që operojnë në përputhje me kërkesat për Rajonet 1 dhe 3 në Planin e Shtojcës 30. (WRC–03)
4.487A	*Përcaktim shetesë*: Në Rajonin 1, brezi 11.7–12.5 GHz, në Rajonin 2, brezi 12.2–12.7 GHz dhe në Rajonin 3, brezi 11.7–12.2 GHz, janë gjithashtu të përcaktuar në bazë parësore për shërbimin fiks satelitor (hapësirë–Tokë), të kufizuar për sistemet jo gjeostacionare dhe objekt i aplikimit të përcaktimeve të Nr. 9.12 për koordinim me sistemet e tjera satelitore jo gjeostacionare në shërbimin satelitor fiks. Sistemet satelitore jo gjeostacionare në shërbimin satelitor fiks nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga rrjetet satelitore gjeostacionare në shërbimin satelitor të radiodifusionit që operon në përputhje me Rregulloret Radio, që nuk respektojnë datat e marrjes nga Byroja të informacionit të plotë të koordinimit ose njoftimit, sic duhet, për rrjetet satelitore gjeostacionare si dhe Nr. 5.43A nuk aplikohet. Sistemet satelitore jo gjeostacionare në shërbimin satelitor fiks në brezat e mësipërm, duhet të operojnë në mënyrë të atillë që çdo interferencë e papranueshme që mund të ndodhi gjatë operimit të tyre duhet të eliminohet shpejt. (WRC–03)
5.488	Përdorimi i brezit të frekuencave 11.7–12.2 GHz nga rrjetet satelitore gjeostacionare, në shërbimin fiks satelitor në Rajonin 2, është subjekt i dispozitave të nenit 9.14 R për koordinim me stacionet tokësore të Rajonit 1, 2 dhe 3. Për përdorimin e brezit të frekuencave 12.2–12.7 GHz nga shërbimi satelitor televiziv në Rajonin 2, shih Shtojcën 30 të ITU. (WRC–03)
5.492	Dhënia e frekuencave për stacionet e shërbimit radioteleviziv–satelitor të cilat janë konform me Planin Rajonal të duhur ose të përfshira në Rajonet 1 dhe 3 në Shtojcën 30 mund të përdoret për transmetime në shërbimin fiks satelitor (hapësirë–Tokë), me kusht që ky transmetim nuk shkakton më shumë interferencë, ose kërkon më shumë mbrojtje nga interferenca, se sa transmetimet

e shërbimit radioteleviziv–satelitor që operojnë në konformitet me Planin ose Listën. (WRC– 2000)

5.494 *Përcaktim shtesë:* Në Algjeri, Arabi Saudite, Bahrein, Kamerun, Republikën e Afrikës Qendrore, Kongo (Rep. e), Bregu i Fildishtë, Xhibuti, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Eritrea, Etiopi, Gabon, Gana, Guinea, Iraku, Izraeli, Jordania, Kuvajti, Libani, Libia, Madagaskar, Mali, Marok, Mongolia, Nigeri, Oman, Palestinë*, Katar, Republika Arabe e Sirise, Rep. Popullore demokratike e Kongos, Somalia, Sudani, Sudani Jugor, Çad, Togo dhe Jemen, brezi i frekuencave 12.5–12.75 GHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin fiks dhe të lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. (WRC–23).

* Në bazë të Rezolutës 99 (Rev. Dubai, 2018) të Konferencës Fuqiplotë, dhe duke marrë parasysh Marrëveshjen e Përkohshme Izraelito-Palestineze të 28 Shtatorit 1995.

5.495 *Përcaktim shtesë:* Në Greqi, Monako, Mali i Zi, Uganda dhe Tunizi, brezi i frekuencave 12,5–12,75 GHz është përcaktuar gjithashtu në bazë dytësore në shërbimin e lëvizshëm dhe fiks, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. (WRC–19)

5.496 *Përcaktim shtesë:* Në Austri, Azerbajxhan, Kirgizstan dhe Turkmenistan, brezi 12.5–12.75 GHz është përcaktuar në një bazë parësore për shërbimin fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik. Megjithatë, stacionet në këto shërbime nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme tek stacionet tokësore të shërbimit fiks satelitor në vendet e Rajonit 1, që nuk janë renditur në këtë shënim. Koordinimi i këtyre stacioneve tokësore nuk kërkohet me stacionet e shërbimit fiks dhe të lëvizshëm në vendet e renditura në këtë shënim. Kufiri i fuqisë së densitetit të fluksit në sipërfaqen e Tokës, të dhënë në Neni 21, Tabela 21–4, për shërbimin fiks satelitor nuk duhet të aplikohet në territoret e vendeve të renditura në këtë shënim. (WRC– 2000)

5.496A Brezi i frekuencave 12.75-13.25 GHz (Tokë - hapësirë) mund të përdoret nga stacionet tokësore në lëvizje, të kufizuara në stacionet tokësore të avionëve dhe anijeve, duke komunikuar me stacionet hapësinore gjeostacionare në shërbimin satelitor fiks. Rezoluta 121 (WRC-23) do të zbatohet. (WRC-23)

5.497 Përdorimi i brezit 13.25–13.4 GHz nga shërbimi i radionavigacionit aeronautik është kufizuar në ndihmat Dopler të navigacionit.

5.498A Shërbimet e eksplorimit satelitor të Tokës (aktiv) dhe kërkimeve hapësinore (aktiv) që operojnë në brezin 13.25–13.4 GHz nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme, ose të detyrojnë përdorimin dhe zhvillimin e shërbimit të radionavigacionit aeronautik. (WRC–97)

5.499 *Përcaktim shtesë*: në Bangladesh dhe Indi, brezi i frekuencave 13.25–14 GHz është i përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin fiks. Në Pakistan, brezi 13.25–13.75 GHz është përcaktuar në bazë parësore për shërbimin fiks. (WRC–12)

5.499A Përdorimi i brezit të frekuencave 13.4–13.65 MHz nga shërbimi fiks satelitor (hapësirë–Tokë) është i kufizuar në sistemet satelitore gjeostacionare dhe është objekt për marrëveshjen e arritur nën Nr 9.21 me respekt për sistemet satelitore që veprojnë në shërbimin e kërkimeve hapësinore (hapësirë–hapësirë), për të transmetuar të dhënat nga stacionet hapësinore në orbitën

satelitore gjeostacionare për të lidhur stacionet hapësinore në orbitat e satelitëve jo–gjeostacionare për të cilat informacioni i publikimit paraprak (API) është marrë nga Byroja më 27 nëntor 2015. (WRC–15)

5.499B Administratat nuk duhet të përjashtojnë vendosjen dhe operimin e transmetimit të stacioneve tokësore në frekuencën standarte dhe shërbimin satelitor–sinjal kohë (Tokë–hapësirë) të përcaktuar në bazë dytësore në brezin e frekuencave 13.4–13.65 GHz për shkak të përcaktimit parësor në FSS (hapësirë–Tokë). (WRC–15)

5.499C Përcaktimi i brezit të frekuencave 13.4–13.65 GHz për shërbimin e kërkimeve hapësinore në një bazë parësore është i kufizuar në:
–Sistemet satelitore që operojnë në shërbimin e kërkimeve hapësinore (hapësirë–hapësirë), për të transmetuar të dhëna nga stacionet hapësinore në orbitën satelitore gjeostacionare për të lidhur stacionet hapësinore në orbita satelitore jo–gjeostacionare për të cilën informacioni i publikimit paraprak (API) është marrë nga Byroja më 27 nëntor 2015,
– Sensorët aktiv hapësinor,
– Sistemet satelitore që operojnë në shërbimin e kërkimeve hapësinore (hapësirë–Tokë) për të transmetuar të dhënat nga stacionet hapësinore në orbitën satelitore gjeostacionare në stacionet tokësore të lidhura.

Përdorime të tjera të brezit të frekuencave nga shërbimi i kërkimeve hapësinore janë në baza dytësore. (WRC–15)

5.499D Në brezin e frekuencave 13.4–13.65 GHz, sistemet satelitore në shërbimin e kërkimeve hapësinore (hapësirë–Tokë) dhe/ose shërbimin e kërkimeve hapësinore (hapësirë–hapësirë) nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme në, as të kërkojnë mbrojtje nga, shërbimet e stacioneve fikse, të lëvizshme, radiopërcaktimit dhe eksplorimit satelitor të Tokës (aktive). (WRC–15)

5.499E Në brezin e frekuencave 13.4–13.65 MHz, rrjetet satelitore gjeostacionare në shërbimin satelitor fiks (hapësirë–Tokë) nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet hapësinore në shërbimin e eksplorimit satelitor të Tokës (aktiv) që veprojnë në përputhje me këto rregulla. Nr 5.43A nuk aplikohet. Dispozitat e Nr 22.2 nuk zbatohen për shërbimin e eksplorimit– satelitor të tokës (aktiv) në lidhje me shërbimin fiks satelitor (hapësirë–Tokë) në këtë brez frekuencash (WRC–15).

5.500 *Përcaktim shtesë*: Në Algjeri, Arabi Saudite, Bahrein, Brunei Darussalam, Kameruni,Xhibut, Egjipti, Emiratet e Bashkuara Arabe, Gabon, Indonezi, Iran (Republika Islamike e), Irak, Izrael, Jordani, Kuvajt, Liban, Madagaskar, Malajzi, Mali, Maroku, Mauritania, Niger, Nigeri, Oman, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Singapor, Somali, Sudan, Sudani Jugor, Çadi dhe Tunizi, brezi i frekuencave 13.4–14 GHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin fiks dhe të lëvizshëm. Në Pakistan, brezi i frekuencave 13,4–13,75 GHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin fiks dhe të lëvizshëm (WRC–23).

5.501 *Përcaktim shtesë:* Në, Hungari, Japoni, Kirgizstan, Rumani dhe Turkmenistan brezi i frekuencave 13.4–14 GHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin e radionavigacionit (WRC– 23).

5.501A Përcaktimi i brezit të frekuencave 13.65–13.75 GHz në bazë parësore për shërbimin e kërkimit hapësinor është i kufizuar për sensorët aktiv të

transportuar në hapësirë. Përdorime të tjera të brezit nga shërbimet e kërkimit hapësinor janë në bazë dytësore (WRC– 15).

5.501B Në brezin 13.4–13.75 GHz, shërbimet e eksplorimit satelitor të tokës (aktive) dhe kërkimit hapësinor (aktiv) nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme, ose të detyrojnë përdorimin dhe zhvillimin e, shërbimeve të radiovendndodhjes (WRC–97).

5.502 Në brezin 13.75–14 GHz, një stacion tokësor i një rrjeti të shërbimit fiks satelitor gjeostacionar duhet të ketë një diameter minimum të antenës prej 1.2 m dhe një stacion tokësor i një sistemi të shërbimit fiks satelitor jo gjeostacionar duhet të ketë një diametër minimum të antenës prej 4.5 m. Veç kësaj, e.i.r.p, afërsisht mbi një sekond, rrezatuar nga një stacion në shërbimin e radiovendndodhjes ose radionavigacionit nuk duhet të tejkalojë 59 dBW për kënde të arritjes mbi 2o dhe 65 dBW për këndet e ulura. Para se një administratë të vejë në përdorim një stacion tokësor në rrjetin satelitor gjeostacionar në shërbimin satelitor fiks në këtë brez me një madhësi të antenës më të vogël se 4.5m, duhet të sigurohet që fuqia e densitetit të fluksit prodhuar nga ky stacion tokësor të mos kalojë:

–115 dB(W/(m2 · 10 MHz)) për më shumë se 1% e kohës së prodhuar në 36m lartësi mbi nivelin e detit në nivelin e poshtëm të ujit , siç njihet zyrtarisht nga Shteti bregdetar;

–115 dB(W/(m2 · 10 MHz)) për më shumë se 1% e kohës së prodhuar në 3m mbi nivelin e tokës në kufirin e një administrate që ka në përdorim ose planifikon të ketë në përdorim radarë të lëvizshëm tokësore në këtë brez, përveç rastit kur ka pasur marrëveshje dakortësie më përpara.

Për stacionet tokësore brenda shërbimit fiks satelitor që kanë një diametër antene më të madh se ose të barabartë me 4.5 m, e.i.r.p e çdo emetimi duhet të jetë të paktën 68 dBW dhe nuk duhet të tejkalojë 85 dBW (WRC–03).

5.503 Në brezin 13.75–14 GHz, stacionet hapësinore gjeostacionare në shërbimin e kërkimeve hapësinore për të cilët informacioni i publikimit paraprak është marrë nga Byroja para 31 Janar 1992 duhet të operojnë në baza të njëjta me stacionet në shërbimin fiks satelitor; pas kësaj date, stacionet e reja hapësinore gjeostacionare në shërbimin e kërkimeve hapësinore do të operojnë në një bazë dytësore. Deri në momentin kur këto stacione hapësinore gjeostacionare në shërbimin e kërkimeve hapësinore për të cilët informacioni i publikimit paraprak (API) është marrë nga Byroja para 31 Janar 1992 pushojnë së operuari në këtë brez:

– në brezin 13.77–13.78 GHz, densiteti e.i.r.p i emëtimeve nga çdo stacion tokësor në shërbimin fiks satelitor që operon me një stacion hapësinor në orbitën satelitore gjeostacionare nuk duhet të tejkalojë:

i) 4.7D+ 28 dB (W/40KHz), ku D është diametri (m) i antenës së stacionit tokësor në shërbimin fiks satelitor për diametra të antenës të barabartë me ose më të mëdhenj se 1.2m dhe më të vegjël se 4.5m;

ii) 49.2 + 20 log (D/4.5) dB (W/40KHz), ku D është diamtri (m) i antenës së stacionit tokësor të shërbimit fiks satelitor për diametra të antenës të barabartë me ose më të mëdhenj se 4.5m dhe më të vegjël se 31.9m;

iii) 66.2 dB (W/40KHz) për çdo stacion tokësor të shërbimit fiks satelitor për antena me diametër të barabartë me ose më të madh se 31.9m;

iv) 56.2 dB (W/4KHz) emëtimet e stacioneve tokësore të shërbimit fiks satelitor për brez të ngushtë (më pak se 40 KHz e gjërësisë së nevojshme të brezit) nga çdo stacion tokësor i shërbimit fiks satelitor që ka një diametër të antenës 4.5m ose më të madh.

– densiteti e.i.r.p i emëtimeve nga stacionet tokësore në shërbimin fiks satelitor operon me një stacion hapësinor në një orbitë satelitore jo gjeostacionare nuk duhet të tejkalojë 51dBW në brezin prej 6 MHz të rangut 13.772 deri në 13.778 GHz.

Kontrolli automatik i fuqisë mund të përdoret për të rritur densitetin e.i.r.p në këto diapazone fekuencash për të kompensuar atenuimin nga shiu, në limitin që fuqia e densitetit të fluksit në stacionin hapësinor të shërbimit fiks satelitor nuk tejkalon vlerën që rezulton nga përdorimi i stacionit tokësor të një e.i.r.p. që plotëson limitet e sipërme në kushte të qiellit të pastër (WRC– 03).

5.504 Përdorimi i brezit 14–14.3 GHz nga shërbimi i radionavigacionit do të jetë i tillë që të sigurojë mbrojtje të mjaftueshme të stacioneve hapësinore në shërbimin fiks satelitor.

5.504A Në brezin 14–14.5 GHz, stacionet tokësore të avionëve në shërbimin satelitor të lëvizshëm për përdorim dytësor, mund të komunikojë gjithashtu me stacionet hapësinore në shërbimin fiks satelitor. Aplikohen përcaktimet Nr. 5.29, 5.30 dhe 5.31 (WRC– 03).

5.504B Stacionet tokësore të avionëve që operojnë në shërbimin e lëvizshëm aeronautik– satelitor në brezin e frekuencave 14–14.5 GHz duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e Shtojcës 1, Pjesa C e Rekomandimit ITU–R M.1643–0, në respekt të çdo stacioni radioastronomik që bën observime në brezin 14.47–14.5 GHz të pozicionuar në territoret e Spanjës, Francës, Indisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Afrikës së Jugut. (WRC–15)

5.504C Në brezin e frekuencave 14–14.25 GHz, fuqia e densitetit të fluksit në territorin e vendeve të Arabisë Saudite, Bahrein, Botsvana, Bregu i Fildishtë, Egjypt, Guinea, Indi, Iran (Republika Islamike e), Kuvait, Nigeri, Oman, Republika Arabe Siriane dhe Tunizia, nga çdo stacion tokësor i avionëve në shërbimin e lëvizshëm aeronautik satelitor nuk duhet të tejkalojë limitet e përcaktuara në Aneksin 1, Pjesa B, të Rekomandimit ITU–R M.1643–0, përveç nëse në mënyrë specifike është rënë dakort me administratat e prekura. Dispozitat e këtij shënimi në asnjë mënyrë nuk heqin detyrimet e shërbimit të lëvizshëm aeronautik satelitor për të operuar si shërbim dytësor në përputhje me nr. 5.29 (WRC–15).

5.505 *Përcaktim shtesë:* Në Algjeri, Arabi Saudite, Bahrein, Botsvana, Brunei Darussalam, Kameruni, Kina, Kongo (Rep. e), Kore (Rep e), Xhibuti, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Esuatini ,Gabon, Guinea, India, Indonezi, Iran (Republika Islamike e), Irak, Izrael, Japoni, Jordani, Kuvajt, Liban, Malajzia, Mali, Marok, Mauritani, Oman, Filipine, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Rep Popullore Demokratike të Koresë, Singapor, Somali, Sudan, Sudani Jugor, Svaziland, Çad, Vietnam dhe Jemen, brezi i frekuencave 14–14,3 GHz është përcaktuar gjithashtu për shërbimin fiks në një bazë parësore (WRC–19).

5.506 Brezi 14–14.5 GHz mund të përdoret, brenda shërbimit fiks satelitor (Tokë–hapësirë), për lidhjet fider për shërbimin radioteleviziv satelitor, objekt për koordinimin me rrjetet e tjera në shërbimin fiks satelitor. Një përdorim i tillë i lidhjeve fider është rezervuar për vendet jashtë Europës.

5.506A Në brezin e frekeuncave 14–14.5 GHz, stacionet tokësore të anijeve me një e.i.r.p më të madh se 21dBW duhet të operojnë në të njëjtat kushte si stacionet tokësore që ndodhen në bordin e anijeve, siç thuhet në Rezolutën 902 (WRC–23). Ky shënim nuk duhet të aplikohet për stacionet tokësore të anijeve për të

cilat informacioni i plotë i Shtojcës 4 është marrë nga Byroja para 5 Korrikut 2003 (WRC–23).

5.506B Stacionet tokësore që ndodhen në bordin e anijeve që komunikojnë me stacionet hapësinore në shërbimin satelitor fiks mund të operojnë në brezin e frekuencave 14–14.5 GHz pa pasur nevojë për një marrëveshje paraprake me Qipron dhe Maltën, brenda distancës minimale të dhënë në Rezolutën 902 (Rev.WRC– 23) nga këto vende (WRC–23).

5.508 *Përcaktim shtesë:* Në Gjermani, Francë, Itali, Libi, Maqedoninë e Veriut dhe Mbretërinë e Bashkuar, brezi i frekeuncave 14.25–14.3 GHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin fiks (WRC–23).

5.508A Në brezin e frekuencave 14.25–14.3 GHz, fuqia e densitetit të fluksit i prodhuar në territoret e vendeve të Arabisë Saudite, Bahrein, Botsvana, Kinë, Bregu i Fildishtë, Egjipt, , Guine, Indi, Iran (Republika Islamike e), Itali, Kuvait, Nigeri, Oman, Republika Arabe e Sirisë, Mbretëria e Bashkuar dhe Tunizia nga çdo stacion tokësor i avionëve në shërbimin satelitor të lëvizshëm aeronautik nuk duhet të tejkalojnë kufijtë e dhënë në Shtojcën 1, Pjesa B e Rekomandimit ITU–R M.1643–0, përveç nëse në mënyrë specifike është rënë dakord midis administratës(ave) të prekur(a). Dispozitat e këtij shënimi në asnjë mënyrë nuk heqin detyrimet e shërbimit satelitor të lëvizshëm aeronautik për të operuar si një shërbim dytësor në përputhje me Nr. 5.29 (WRC–23).

5.509A Në brezin e frekuencave 14.3–14.5 GHz , fuqia e densitetit të fluksit e prodhuar në territoret e vendeve të Arabisë Saudite, Bahrein, Botsvana, Kamerun, Kinë, Bregu i Fildishtë, Egjipt, , Gabon, Guine, Indi, Iran (Republika Islamike e), Itali, Kuvait, Marok, Nigeri, Oman, Republika Arabe e Sirisë, Mbretëria e Bashkuar, Sri Lanka, Tunizia dhe Vietnami nga çdo stacion tokësor i avionëve në shërbimin satelitor të lëvizshëm aeronautik nuk duhet të tejkalojnë kufijtë e dhënë në Shtojcën 1, Pjesa B e Rekomandimit ITU–R M.1643, përveç nëse në mënyrë specifike është rënë dakord midis administratës(ave) të prekur(a). Dispozitat e këtij shënimi në asnjë mënyrë nuk heqin detyrimet e shërbimit satelitor të lëvizshëm aeronautik për të operuar si një shërbim dytësor në përputhje me Nr. 5.29 (WRC-23).

5.509B Përdorimi i brezave të frekuencave 14.5–14.75 GHz në vendet e listuara në Rezolutën 163 (WRC–15) dhe 14.5–14.8 GHz në vendet e listuara në Rezolutën 164 (WRC–15) nga shërbimi fiks satelitor (tokës–hapësirë) jo për lidhjet fider për shërbimin satelitor radiotelevizivë është i kufizuar në satelitët gjeostacionar (WRC–15).

5.509C Për përdorimin e brezit të frekuencave 14.5–14.75 GHz në vendet e listuara në Rezolutën 163 (WRC–15) dhe 14.5–14.8 GHz në vendet e listuara në Rezolutën 164 (WRC–15) nga shërbimi fiks satelitor (Tokë–hapësirë) jo për lidhjet fider për shërbimin satelitor radiotelevizivë, stacionet tokësore në shërbimin fiks satelitor duhet të kenë një minimum të diametrit të antenës prej 6 m dhe një fuqi maksimale të densitetit spektral prej–44.5 dBW/ Hz, në hyrje të antenës. Stacionet tokësore do të njoftohen në pozicionet e njohura në tokë (WRC–15).

5.509D Para se një administratë të sjellë në përdorim një stacion tokësor në shërbimin fiks satelitor (Tokë–hapësirë) jo për lidhjet fider për shërbimin satelitor radiotelevizivë në brezat e frekuencave 14.5–14.75 GHz (në vendet e listuara në Rezolutën 163 (WRC 15)) dhe 14.5–14.8 GHz (në vendet e listuara në Rezolutën 164 (WRC–15)), duhet të sigurojë që fuqia e densitetit të fluksit e prodhuar nga

ky stacion tokësor të mos tejkalojë –151.5 dB (W / (m2 · 4 kHz)) prodhuar në të gjitha lartësit nga 0 m deri 19 000 m mbi nivelin e detit në distancë prej 22 km nga të gjithë bregdetet, percaktuar si niveli më i ulët i ujit, njohur zyrtarisht nga çdo shtet bregdetar (WRC–15).

5.509E Në brezat e frekuencave 14,50–14,75 GHz në vendet e listuara në Rezolutën 163 (WRC–15) dhe 14,50–14,8 GHz në vendet e listuara në Rezolutën 164 (WRC–15), vendndodhja e stacioneve tokësore në shërbimin fiks satelitor (Tokë–hapësirë) jo për lidhjet fider për shërbimin satelitor radioteleviziv do të mbajnë një distancë ndarjeje të paktën 500 km nga kufiri (et) e vendeve të tjera, përveç rastit kur është rënë dakord për distanca më të shkurtra nga këto administrata. Nr.9.17 nuk aplikohet. Kur zbatohet kjo dispozitë, administratat duhet të marrin në konsideratë dispozitat përkatëse të këtyre rregullave dhe rekomandimet e fundit të ITU–R (WRC– 15).

5.509F Në brezat e frekuencave 14,50–14,75 GHz në vendet e listuara në Rezolutën 163 (WRC–15) dhe 14,50–14,8 GHz në vendet e listuara në Rezolutën 164 (WRC–15), stacionet tokësore në shërbimin fiks satelitor (Tokë–hapësirë) jo për lidhjet fider për shërbimin radioteleviziv satelitor nuk do të pengojnë përdorimin në të ardhmen të shërbimeve fikse dhe të lëvizshme. (WRC–15)

5.509G Brezi i frekuencave 14,5–14,8 GHz është përcaktuar gjithashtu për shërbimin e kërkimeve hapësinore në një bazë parësore. Megjithatë, një përdorimi i tillë është i kufizuar me sistemet satelitore që operojnë në shërbimin e kërkimeve hapësinore (Tokë–hapësirë) për të transmetuar të dhëna për stacionet hapësinore në orbitën satelitore gjeostacionare nga stacionet e lidhura tokësore. Stacionet në shërbimin e kërkimit hapësinor nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme në, ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet në shërbimet fiks dhe i lëvizshëm dhe në shërbimin fiks satelitor të kufizuar në lidhjet fider për shërbimin e radiotelevizionit satelitor dhe funksionet operacionale hapësinore duke përdorur kufijt e brezave nën Shtojcën 30A dhe lidhjet fider për shërbimin radioteleviziv satelitor në Rajonin 2. Përdorimet e tjera të këtij brezi frekuencash nga shërbimi i kërkimeve hapësinore janë në baza dytësore. (WRC–15)

5.510 Me përjashtim të përdorimit në përputhje me Rezolutën 163 (WRC–15) dhe Rezolutës 164 (WRC–15), përdorimi i brezit 14.5 – 14.8 GHz nga shërbimi fiks satelitor (Tokë–hapësirë) është kufizuar në lidhjet fider për shërbimin radioteleviziv satelitor. Ky përdorim është i rezervuar për vendet jashtë Europës. Përdorime të tjera të lidhjes fider për shërbimin e radiotelevizionitsatelitor në brezin e frekuencave 14.75–14.8 GHz nuk janë të autorizuar në Rajonet 1 dhe 2, (WRC–15).

5.510A Alokimi i brezit të frekuencave 14.8-15.35 GHz për shërbimin e kërkimit hapësinor në bazë parësore është i kufizuar për sistemet satelitore që veprojnë në drejtimet hapësirë-hapësirë, hapësirë-Tokë dhe Tokë-hapësirë në distanca nga Toka prej më pak se 2 × 106 km në përputhje me Rezolutën 678 (WRC-23). Përdorime të tjera të brezit të frekuencës nga shërbimi i kërkimit hapësinor janë në baza dytësore. Përdorimi i brezit të frekuencave 14,8-15,35 GHz nga shërbimi i kërkimit hapësinor (hapësirë-Tokë) (Tokë- hapësirë) është në një bazë dytësore në lidhje me shërbimet tokësore në Algjeri, Arabinë Saudite, Bahrein, Kore (Rep. e), Egjipti, Emiratet e Bashkuara Arabe, Shtetet e Bashkuara, India, Iraku, Japonia, Kuvajti, Libia, Maroku, Mauritania, Omani, Katari, Republika Arabe e Sirisë, Tunizia dhe Jemeni. (WRC-23)

5.511 *Përcaktim shtesë*: Në Arabinë Saudite, Bahrein, Kamerun, Xhibut, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Guinea, Iran (Republike Islamike e), Irak, Izrael,

Kuvajt, Liban, Oman, Pakistan, Katar, Republikën Arabe të Sirisë dhe Somali brezi i frekeuncave 15.35–15.4 GHz është përcaktuar gjithashtu në bazë dytësore për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm (WRC–23).

5.511A Përdorimi i brezit të frekuencave 15.43–15.63 GHz për shërbimin fiks satelitor (hapësirë– Tokë) është limituar në lidhjet fider të sistemeve jo–gjeostacionar në shërbimin e lëvizshëm satelitor, subjekt koordinimi sipas nenit 9.11A (WRC–15).

5.511C Stacionet që operojnë në shërbimin e radionavigacionit aeronautik duhet të kufizojnë e.i.r.p – në efektive në përputhje me Rekomandimin ITU–R S.1340–0. Minimumi i distancës së koordinimit të kërkuar për të mbrojtur stacionet e radionavigacionit aeronautik (Nr. 4.10 aplikohet) nga interfencat e dëmshme nga stacionet tokësore me lidhje fider dhe maksimum i e.i.r.p së transmetuar drejt planit horizontal lokal nga një stacion me lidhje fider, duhet të jetë në përputhje me Rekomandimin ITU–R S.1340–0 (WRC– 15).

5.511E Në brezin e frekuencave 15.4–15.7 GHz, stacionet që operojnë në shërbimin e radiopërcaktimit nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme ose të kërkojnë mbrojtje nga stacionet që operojnë në shërbimin e radionavigacionit aeronautik (WRC–12).

5.511F Me qëllim për të mbrojtur shërbimin e radio astronomisë në brezin e frekuencave 15.35–15.4 GHz, stacionet e radiopërcaktimit që operojnë në brezin e frekuencave 15.4–15.7 GHz nuk duhet të kalojnë nivelin e fuqisë së densitetit të fluksit prej −156 dB (W/m2) në një gjërësi prej 50 MHz në brezin e frekuencave 15.35–15.4 GHz, në çdo pozicion pike vëzhgimi radio astronomie për më shumë se 2 përqind të kohës (WRC–12).

5.511G Stacionet në shërbimin e lëvizshëm aeronautik (OR) që operojnë në brezin e frekuencave 15,41-15,7 GHz nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme në shërbimin radio astronomik që operon në brezin e frekuencave 15,35-15,4 GHz. Dendësia e fluksit të fuqisë totale (pfd) e marrë nga stacionet në shërbimin e lëvizshëm aeronautik (OR) që operojnë në brezin e frekuencës 15,41-15,7 GHz në çdo stacion radio astronomie që operon në brezin e frekuencave 15,35-15,4 GHz, duhet të jetë në përputhje me kriteret e mbrojtjes të parashikuara në Rekomandimet ITU-R RA.769-2 dhe ITU-R RA.1513-2, përveç rasteve kur është rënë dakord në mënyrë specifike nga administrata(at) e prekur(a). (WRC-23)

5.511H *Përcaktim shtesë:* në Indonezi, brezi i frekuencave 15,41-15,7 GHz i përcaktohet gjithashtu shërbimit të lëvizshëm aeronautik (OR) në bazë dytësore. Stacionet në shërbimin e lëvizshëm aeronautik (OR) që operojnë në brezin e frekuencave 15,41-15,7 GHz nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme në shërbimin radio astronomik që operon në brezin e frekuencave 15,35-15,4 GHz. Dendësia e fluksit të fuqisë totale (pfd) e marrë nga stacionet në shërbimin e lëvizshëm aeronautik (OR) që operojnë në brezin e frekuencave 15.41-15.7 GHz në çdo stacion radio astronomie që operon në brezin e frekuencave 15.35-15.4 GHz duhet të jetë në përputhje me kriteret e mbrojtjes të parashikuara në Rekomandimet ITU-R RA.769-2 dhe ITU-R RA.1513-2, përveç rasteve kur është rënë dakord në mënyrë specifike nga administrata(at) e prekur(a). (WRC-23)

5.512 *Përcaktim shtesë:* Në Algjeri, Arabi Saudite, Austri, Bahrein, Bangladesh, Brunei Darusalam, Kamerun, Kongo (Rep e), Egjypt, El Salvador, Emiratet e Bashkuara Arabe, Eritrea, Finland, Guatemalë, Indi, Indonezi, Iran (Republikë

Islamike e), Jordani, Kenia, Kuvajt, Liban, Libi, Malajzi, Mali, Marok, Mauritani, Mali i Zi, Nepal, Nikaragua, Niger, Oman, Pakistan, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Republika Demokratike e Kongos, Singapor, Somali, Sudan, Sudani Jugor, Çad, Togo dhe Jemen, brezi i frekuencave 15.7 – 17.3 GHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm (WRC–15).

5.513 *Përcaktim shtesë:* Në Izrael, brezi i frekuencave 15.7–17.3 GHz është i përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin fiks dhe të lëvizshëm. Këto shërbime nuk duhet të kërkojnë mbrojtje ose të shkaktojnë interferenca të dëmshme në shërbimet që operojnë në përputhje me tabelën e vendeve të ndryshme nga ato që përfshihen në Nr.5512.

5.513A Sensorët aktiv të transportuar në hapësirë që operojnë në brezin 17.2–17.3 GHz nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme, ose të detyrojnë zhvillimin e, të radiovendndodhjes dhe shërbimeve të tjera të përcaktuara në bazë parësore (WRC– 97).

5.514 *Përcaktim shtesë*: Në Algjeri, Arabi Saudite, Bahrein, Bangladesh, Kamerun, Xhibut, El Salvador, Emiratet e Bashkuara Arabe, Guatemalë, Indi, Iran (Republika Islamike e), Irak, Izrael, Itali, Japoni, Jordani, Kuvait, Libi, Lituani, Nepal, Nikaragua, Nigeri, Oman, Uzbekistan, Pakistan, Katar, Kirgizstan, Somali, Sudan dhe Sudani Jugor, brezi i frekuencave 17.3–17.7 GHz është përcaktuar gjithashtu në bazë dytësore për shërbimet fiks dhe të lëvizshëm. Do të aplikohen kufijtë e fuqisë të dhëna në Nr. 21.3 dhe 21.5 (WRC–23).

5.515 Në brezin e frekuencave 17.3–17.8 GHz, përdorimi i përbashkët midis shërbimit fiks satelitor (Tokë–hapësirë) dhe shërbimit radioteleviziv satelitor duhet të jenë gjithashtu në përputhje me dispozitat e § 1 të Aneksit 4 të Shtojcës 30A të Rregulloreve Radio të ITU.

5.515A Përveç nevojës për të përmbushur kriteret e koordinimit në Aneksit 4 të Shtojcës 30A, në kushtet e supozuara të përhapjes në hapësirës së lirë, dendësia e fluksit të fuqisë së një caktimi në shërbimin satelitor fiks (hapësirë - Tokë) të një rrjeti satelitor gjeostacionar në brezin e frekuencave 17.3-17.7 GHz në Rajonin 2 nuk duhet të kalojë vlerën −98 dB(W/(m2 · 27 MHz)) në pikat e orbitës satelitore gjeostacionare me kënde të ndarjes orbitale gjeocentrike ndërmjet 152.6° dhe 162.6 °. (WRC-23)

5.515B Në brezin e frekuencave 17,3-17,7 GHz, përdorimi i shërbimit satelitor fiks (hapësirë - Tokë) nga stacionet hapësinore satelitore gjeostacionare në Rajonin 2 nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme për marrësit e stacioneve hapësinore dhe as pretendime mbrojtje nga stacionet tokësore me lidhje fider të shërbimit të transmetimit satelitor që funksionojnë sipas Shtojcës 30A në të treja Rajonet, as të vendosni ndonjë limitim ose kufizim në vendndodhjet e stacioneve tokësore lidhje fider të shërbimit të transmetimit satelitor kudo brenda zonës së shërbimit të lidhjes fider. Administrata njoftuese për shërbimin satelitor fiks (hapësirë - Tokë), kur dorëzon elementet e informacionit të Shtojcës 4, duhet të sigurojë një angazhim/zotim të qëndrueshëm, objektiv, të zbatueshëm, të matshëm, të detyrueshëm që, në rast të raportimit të interferencave të dëmshme të raportuara në marrësit e stacioneve hapësinore ,në Shtojcën 30A, ato duhet të ndërmarrin veprime të menjëhershme për të eliminuar interferencën ose për ta reduktuar atë në një nivel të pranueshëm. (WRC-23)

5.516 Përdorimi i brezit 17.3–18.1 GHz nga sistemet satelitore gjeostacionare në shërbimin fiks satelitor (Tokë –hapësirë) është i kufizuar për lidhjet fider

për shërbimin radioteleviziv satelitor. Përdorimi i brezit 17.3–17.8 GHz në Rajonin 2 nga sistemet në shërbimin fiks satelitor (Tokë –hapësirë) është i kufizuar për satelitet gjeostacionarë. Për përdorimin e brezit 17.3–17.8 GHz në Rajonin 2 nga lidhjet fider për shërbimin radioteleviziv satelitor në brezin 12.2–12.7 GHz, shiko nenin11. Përdorimi i brezave 17.3–18.1 GHz (Tokë–hapësirë) në Rajonin 1 dhe 3 dhe 17.8–18.1 GHz (Tokë–hapësirë), në Rajonin 2 nga sistemet satelitore jo gjeostacionare në shërbimin fiks satelitor është objekt për aplikimin e dispozitave të Nr. 9.12 për koordinim me sisteme të tjera satelitore jo gjeostacionare në shërbimin fiks satelitor. Sistemet satelitore jo gjeostacionare në shërbimin fiks satelitor nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga rrjetet satelitore gjeostacionare në shërbimin fiks satelitor që operojnë në përputhje me Rregulloret Radio, duke mos respektuar datat e marrjes nga Byroja të informacionit të plotë të koordinimit ose njoftimit, siç duhet, për sistemet satelitore jo gjeostacionare në shërbimin satelitor fiks dhe të infomacionit të plotë të koordinimit ose njoftimit, sic duhet, për rrjetet satelitore gjeostacionare, dhe Nr. 5.43A nuk aplikohet. Sistemet satelitore jo gjeostacionare në shërbimin fiks satelitor në brezat e mësipërm, duhet të operojnë në mënyrë të atillë që çdo interferencë e papranueshme që mund të ndodhi gjatë operimit të tyre duhet të eliminohet shpejt (WRC– 2000).

5.516A Në brezin 17.3–17.7 GHz, stacionet tokësore të shërbimit fiks satelitor (hapësirë–Tokë) në Rajonin 1 nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga shërbimi radioteleviziv satelitor, lidhjet fider të stacioneve tokësore që operojnë nën Shtojcën 30A dhe as të mos vendosin ndonjë limitim ose kufizim në vëndndodhjet e shërbimit radioteleviziv satelitor lidhjet fider të stacioneve tokësore kudo brenda zonës së shërbimit të lidhjes fider (WRC– 03).

5.516B Brezat e mëposhtëm janë të identifikuar për përdorim nga aplikimet me densitet të lartë në shërbimin fiks satelitor :
17.3–17.7 GHz (hapësirë–Tokë) në Rajonin 1
18.3–19.3 GHz (hapësirë–Tokë) në Rajonin 2
19.7–20.2 GHz (hapësirë–Tokë) në të gjitha Rajonet
39.5–40 GHz (hapësirë–Tokë) në Rajonin 1
40–40.5 GHz (hapësirë–Tokë) në të gjitha Rajonet
40.5–42 GHz (hapësirë–Tokë) në Rajonin 2
47.5–47.9 GHz (hapësirë–Tokë) në Rajonin 1
48.2–48.54 GHz (hapësirë–Tokë) në Rajonin 1
49.44–50.2 GHz (hapësirë–Tokë) në Rajonin 1
dhe 27.5–27.82 GHz (Tokë–hapësirë) në Rajonin 1
28.35–28.45 GHz (Tokë–hapësirë) në Rajonin 2
28.45–28.94 GHz (Tokë–hapësirë) në të gjitha Rajonet
28.94–29.1 GHz (Tokë–hapësirë) në Rajonin 2 dhe 3
29.25–29.46 GHz (Tokë–hapësirë) në Rajonin 2
29.46–30 GHz (Tokë–hapësirë) në të gjitha Rajonet
48.2–50.2 GHz (Tokë–hapësirë) në Rajonin 2

Ky identifikim nuk ndalon përdorimin e këtyre brezave nga aplikime të tjera të shërbimeve fikse satelitore ose nga shërbime të tjera për të cilat këto breza janë të përcaktuar në një bazë bashkë–parësore dhe nuk përcaktojnë prioritet në Rregulloret Radio ndërmjet përdoruesve të këtyre brezave. Administratat duhet të marrin parasysh këtë kur konsiderojnë dispozitat rregullatore në lidhje me këto breza. Shiko Rezolutën 143 (Rev. WRC-19) (WRC-19).

5.517 Në Rajonin 2, përdorimi i shërbimit satelitor fiks (hapësirë - Tokë) në brezin e frekuencave 17.3-17.8 GHz nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme dhe

as të kërkojë mbrojtje nga përcaktimet në shërbimin e transmetimit satelitor që funksionon në përputhje me Radio Rregulloret. . (WRC-23)

5.517A Funksionimi i stacioneve tokësore në lëvizje duke komunikuar me stacionet hapësinore të shërbimit satelitor fiks gjeostacionar brenda brezave të frekuencave 17.7-19.7 GHz (hapësira-Tokë) dhe 27.5-29.5 GHz (Tokë-hapësirë) do të jenë subjekt në zbatimin e Rezolutës 169 (Rev.WRC-23). (WRC-23) .

5.517B Funksionimi i stacioneve tokësore aeronautike dhe detare në lëvizje që komunikojnë me stacione hapësinore jogjeostacionare në shërbimin satelitor fiks në brezat e frekuencave 17,7-18,6 GHz, 18,8-19,3 GHz dhe 19,7-20,2 GHz (hapësirë - Tokë) dhe 27.5. -29,1 GHz dhe 29,5-30 GHz (Tokë - hapësirë) do të jenë subjekt në zbatim të Rezolutës 123 (WRC-23). (WRC-23)

5.519 *Përcaktim shtesë*: Brezi 18.0 – 18.3 GHz në Rajonin 2 dhe 18.1–18.4 GHz në Rajonin 1 dhe 3 janë përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin meteorologjik satelitor (hapësirë– Tokë). Përdorimi i tyre është kufizuar në satelitet gjeostacionar (WRC–07).

5.520 Përdorimi i brezit 18.1–18.4 GHz nga shërbimi fiks satelitor (Tokë–hapësirë) është kufizuar për sistemet në lidhjet fider të sistemeve satelitor gjeostacionarë në shërbimin radioteleviziv satelitor (WRC–2000).

5.521 *Përcaktim alternativ*: Në Emiratet e Bashkuara Arabe, brezi i frekuencave 18.1–18.4 GHz është përcaktuar në një bazë parësore për shërbimet fiks, fiks satelitor (hapësirë–Tokë) dhe shërbimet e lëvizshme. (shih Nr.5.33). Aplikohen gjithashtu dispozitat e Nr.5.519 (WRC– 23).

5.521A Për përdorimin e brezave të frekuencave 18,1-18,6 GHz, 18,8-20,2 GHz dhe 27,5-30 GHz, ose pjesë të tyre, nga stacionet hapësinore në shërbimin ndër-satelitor, do të zbatohet Rezoluta 679 (WRC-23). Një përdorim i tillë është i kufizuar në kërkimin hapësinor, funksionimin e hapësirës dhe/ose aplikacionet satelitore të eksplorimit të Tokës, si dhe transmetimet e të dhënave që vijnë nga aktivitetet industriale dhe mjekësore në hapësirë. Kur përdorin këto frekuenca, administratat duhet të sigurojnë që ky shërbim ndër-satelitor të përdoret vetëm për qëllimet e sipërpërmendura dhe të mos jetë subjekt i koordinimit sipas Nr. 9.11A. Për përdorimin e brezave të frekuencave 18,1-18,6 GHz, 18,8-20,2 GHz, 27,5-29,1 GHz dhe 29,5-30 GHz nga stacionet hapësinore, shpërndarja është e kufizuar në lidhjet ndër-satelitore ndërmjet satelitëve jogjeostacionarë, ose ndërmjet satelitëve jo-gjeostacionar dhe satelitëve gjeostacionarë. Për përdorimin e brezit të frekuencës 29,1-29,5 GHz nga stacionet hapësinore, shpërndarja është e kufizuar në lidhjet ndër-satelitore ndërmjet satelitëve jogjeostacionarë dhe satelitëve gjeostacionarë. Nr. 4.10 nuk zbatohet. (WRC-23)

5.522A Emëtimet e shërbimit fiks dhe shërbimit fiks satelitor në brezin 18.6–18.8 GHz janë të kufizuara në vlerat e dhëna respektivisht në Nr. 21.5A dhe Nr. 21.16.2 (WRC– 2000).

5.522B Përdorimi i brezit 18.6–18.8 GHz nga shërbimi fiks satelitor është i kufizuar në sistemet gjeostacionare dhe sistemet me një orbitë të majës (kulmit) më të madhe se 20000 km (WRC–2000).

5.522C Në brezin e frekuencave 18.6–18.8 GHz, në Algjeri, Arabi Saudite, Bahrein, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Jamahiriya Arabe Libaneze, Jordani, Liban, Marok, Oman, Katar, Republika Arabe Siriane, Tunizi dhe Jemen,

sistemet e operimit të shërbimeve fikse në datën e hyrjes në fuqi të akteve finale të WRC–2000 nuk janë më subjekt të kufizimeve të nenit 21.5A (WRC–2000).

5.523A Përdorimi i brezave 18.8–19.3 GHz (hapësirë–Tokë) dhe 28.6–29.1 GHz (Tokë–hapësirë) nga rrjetet e shërbimeve fikse satelitore gjeostacionare dhe jogjeostacionare është objekt aplikimi i dispozitave të Nr.9.11A dhe Nr. 22.2 nuk aplikohet. Administratat që kanë rrjete satelitore gjeostacionare nën koordinim para 18 Nëntorit 1995 duhet të kooperojnë në masën maksimale të mundshme për të koordinuar sipas Nr. 9.11A me rrjetet satelitore jogjeostacionare për të cilat informacioni i njoftimit është marrë nga Byroja para kësaj date, me synimin për të arritur rezultate të pranueshme për të gjithë palët e prekura. Rrjetet satelitore jogjeostacionare nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme kundrejt rrjeteve të shërbimit fiks satelitor gjeostacionar për të cilat informacioni i plotë i njoftimit sipas Shtojcës 4 është konsideruar si i marrë nga Byroja para 18 Nëntorit 1995 (WRC– 97).

5.523B Përdorimi i brezit 19.3–19.6 GHz (Tokë–hapësirë) nga shërbimi Fiks satelitor është i kufizuar për lidhjet fider për sistemet satelitore jo gjeostacionare në shërbimin e lëvizshëm satelitor. Ky përdorim është objekt i aplikimit të dispozitave të Nr.9.11A, dhe Nr. 22.2 nuk aplikohet.

5.523C Nr. 22.2 i Rregulloreve Radio duhet të vazhdojë të aplikohet në brezat 19.3–19.6 GHz dhe 29.1–29.4 GHz, ndërmjet lidhjeve fider të rrjeteve të shërbimit të lëvizshëm satelitor jo gjeostacionar dhe të atyre rrjeteve të shërbimit fiks satelitor për të cilat informacioni i plotë i koordinimit sipas Shtojcës 4, ose informacioni i njoftimit, është konsideruar si i marrë nga Byroja para 18 Nëntorit 1995 (WRC 97).

5.523D Përdorimi i brezit 19.3–19.7 GHz (hapësirë–Tokë) nga sistemet e shërbimit fiks satelitor gjeostacionar dhe nga lidhjet fider për sistemet satelitore jo gjeostacionare në shërbimin e lëvizshëm satelitor është objekt aplikimi i normave të Nr.9.11A, por jo objekt i normave të Nr.22.2. Përdorimi i këtij brezi për sistemet e shërbimit fiks satelitor jo gjeostacionar, ose për rastet e përmendura në Nr. 5.523E, nuk është objekt i dispozitave të Nr.9.11A dhe duhet të vazhdojë të jetë objekt i Nenit 9 (përveç Nr.9.11A) dhe procedurës 11, si dhe i dispozitave të Nr.22.2 (WRC– 97).

5.523DA Për të mbrojtur lidhjet fider të rrjeteve jogjeostacionare në shërbimin e lëvizshëm satelitor në brezin e frekuencës 19,3-19,7 GHz, vlerat e densitetit të fluksit të fuqisë të prodhuara në sipërfaqen e Tokës për të gjitha këndet e ngarkesës nga një stacion hapësinor në shërbimin ndërsatelitor që operon në këtë brez në përputhje me Rezolutën 679 (WRC-23) nuk duhet të kalojë -140 dB(W/m2) në çdo 1 MHz brenda 150 km të cilitdo prej stacioneve tokësore me lidhje fider të mësipërme të regjistruar në Regjistrin Kryesor Ndërkombëtar të Frekuencave. (WRC-23)

5.523E Nr 22.2 duhet të vazhdojë të aplikohet në brezat 19.6–19.7 GHz dhe 29.4–29.5 GHz, ndërmjet rrjeteve të shërbimit të lëvizshëm satelitor jo gjeostacionar dhe atyre rrjeteve të shërbimit fiks satelitor për të cilat informacioni i plotë i koordinimi sipas Shtojcës 4, ose informacioni i njoftimit, është konsideruar si i marrë nga Byroja nga 21 Nëntori 1997 (WRC– 97).

5.524 *Përcaktim shtesë*: Në Afganistan, Algjeri, Arabia Saudite, Bahreini, Brunei Darussalam, Kamerun, Kina, Kongo (Rep e), Kosta Rika, Xhibuti, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Gabon, Guatemala, Guinea, Indi, Iran (Republika Islamike e), Irak, Izrael, Japoni, Jordani, Kuvajt, Liban, Malajzi, Mali, Marok,

Mauritani, Nepali, Nigeria, Oman, Pakistan, Palestinë*, Filipinet, Katar, Republikën Arabe të Sirisë, Rep. Demokratike e Kongos, Rep Popullore Demokratike e Koresë, Singapor, Somali, Sudan, Sudani Jugor, Çad, Togo dhe Tunizi, brezi i frekuencave 19.7–21.2 GHz është përcaktuar gjithashtu për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm në një bazë parësore. Ky përdorim shtesë nuk do të imponojë asnjë kufizim mbi fuqinë e densitetit të fluksit të stacioneve hapësinore në shërbimin fiks satelitor në brezin e frekuencave 19.7–21.2 GHz dhe të stacioneve hapësinore në shërbimin e lëvizshëm satelitor në brezin e frekuencave 19.7–20.2 GHz ku përcaktimi i shërbimit i lëvizshëm satelitor është në bazë parësore në brezin frekuencor të fundit (WRC–23).

* Në bazë të Rezolutës 99 (Rev. Dubai, 2018) të Konferencës Fuqiplotë dhe duke marrë parasysh Marrëveshjen e Përkohshme Izraelito-Palestineze të 28 Shtatorit 1995.

5.525 Me qëllim që të lehtësojë koordinimin inter rajonal ndërmjet rrjeteve në shërbimet i lëvizshëm satelitor dhe fiks satelitor, bartësit në shërbimin i lëvizshëm satelitor të cilat janë më të ndjeshme ndaj interferencave do të jenë lokalizuar, në gjerësinë e praktikueshme, në pjesët e sipërm të brezave 19.7 – 20.2 GHz dhe 29.5 – 30 GHz.

5.526 Në brezat 19.7 – 20.2 GHz dhe 29.5 – 30 GHz në Rajonin 2, dhe në brezat 20.1 – 20.2 GHz dhe 29.9 – 30 GHz në Rajonet 1 and 3, rrjetet të cilat janë edhe në shërbimin fiks satelitor edhe në shërbimin e lëvizshëm satelitor mund të përfshijnë lidhjet midis stacioneve tokësore në pikat e specifikuara ose të pa specifikuara ose gjatë kohës që janë në lëvizje, përmes një ose më shumë satelitëve për komunikimet pikë–pikë dhe pikë–shumëpika.

5.527 Në brezat 19.7 – 20.2 GHz and 29.5 – 30 GHz, dispozitat e Nr.4.10 në lidhje me shërbimin e lëvizshëm satelitor nuk do të aplikohen.

5.527A Funksionimi i stacioneve tokësore në lëvizje duke komunikuar me sistemet satelitore fikse FSS është subjekt i Rezolutës 156 (Rev.WRC–23) (WRC–23).

5.528 Përcaktimi për sherbimin e lëvizshëm satelitor është parashikuar për përdorim nga rrjetet të cilat përdorin antenat me rreze të ngushtë dhe teknologjitë e avancuara në stacionet hapësinore. Administratat ku operojnë sistemet në shërbimin e lëvizshëm satelitor në brezin 19.7 – 20.1 GHz në Rajonin 2 dhe në brezin 20.1 – 20.2 GHz do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar disponueshmëri të vazhdueshme të këtyre brezave për administratat ku operojnë sistemet fiks dhe i lëvizshëm në përputhje me kërkesat e Nr. 5.524.

5.529A Në brezat e frekuencave 20.2-21.2 GHz dhe 30-31 GHz, sistemet satelitore jogjeostacionare për të cilat informacioni i plotë i koordinimit ose njoftimit, sipas rastit, merret nga Byroja që nga data 1 Janar 2025, nuk do të shkaktojë interferencë të papranueshme për dhe nuk do të pretendojë mbrojtje nga rrjetet satelitore gjeostacionare në shërbimin satelitor të lëvizshëm që funksionon në përputhje me këto Rregullore. Nr. 5.43A nuk zbatohet. (WRC-23)

5.530A Përveç rastit kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet administratave të interesuara, çdo stacion në shërbimet fiks ose të lëvizshëm të një administrate nuk duhet të prodhojë një fuqi densiteti të fluksit më të madhe se −120.4 dB (W/(m2 • MHz)) në 3 m mbi tokë të çdo pike të territorit të çdo administrate tjetër në Rajonet 1 dhe 3 për më shumë se 20% të kohës. Në kryerjen e llogaritjeve, administratat duhet të përdorin versionin më të fundit të

Rekomandimit ITU R P.452 (shih Rekomandimin ITU– R BO.1898), (WRC–15).

5.530B Në brezin 21.4–22 GHz, me qëllim për të lehtësuar zhvillimin e shërbimit radioteleviziv–satelitor, administratat në Rajonin 1 dhe 3 janë të inkurajuar që të mos vendosin stacionet në shërbimin e lëvizshëm dhe janë të inkurajuar që të kufizojnë vendosjen e stacioneve të shërbimit fiks për lidhjet pikë–pikë (WRC– 12).

5.530D Shih Rezolutën 555 (WRC-12). (WRC-12)

5.530E Alokimi për shërbimin fiks në brezin e frekuencës 21.4-22 GHz është identifikuar për përdorim në Rajonin 2 nga Stacionet me Platformë me Lartësi të Madhe(HAPS). Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtij brezi frekuencash nga aplikacione të tjera të shërbimit fiks ose nga shërbime të tjera, të cilave u është alokuar në baza bashkë-primare, dhe nuk përcakton përparësi në Radio Rregulloret. Një përdorim i tillë i alokimit të shërbimit fiks nga HAPS është i kufizuar në drejtimin HAPS-tokë dhe do të jetë në përputhje me dispozitat e Rezolutës 165 (Rev.WRC-23). (WRC-23)

5.531A Përdorimi i shërbimit të lëvizshëm aeronautik (OR) në brezin e frekuencës 22-22,2 GHz është i kufizuar në aplikacione jo të sigurisë. (WRC-23)

5.531B Stacionet e avionëve në shërbimin e lëvizshëm aeronautik (OR) që operojnë në brezin e frekuencave 22-22,2 GHz janë subjekt i marrëveshjes së marrë sipas Nr. 9.21 në lidhje me shërbimin fiks dhe nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme dhe as të kërkojnë mbrojtje nga shërbimi fiks. Vlerat e mëposhtme të densitetit të fluksit të fuqisë do të përdoren si një prag për koordinimin sipas Nr. 9.21: -110 dB(W/(m2 · MHz)) për $0° \leq \theta \leq 12.6°$ 2.86 θ − 146 dB(W/(m2 · MHz)) për $12,6° < \theta \leq 15°$ 0,87 θ − 116 dB(W/(m2 · MHz)) për $15° < \theta \leq 30°$ 0,067 θ − 92 dB(W/(m2 · MHz)) për $30 ° < \theta \leq 90°$ ku θ është këndi i mbërritjes së valës rënëse mbi planin horizontal, në gradë. Ky kriter duhet të zbatohet në kufirin e territorit të një administrate tjetër për çdo stacion avioni që ndodhet në një lartësi deri në 15 km mbi tokë. Në kryerjen e llogaritjeve, duhet të përdoret versioni më i fundit i Rekomandimit ITU-R P.525. (WRC-23)

5.531C Stacionet në shërbimin e lëvizshëm aeronautik (OR) që operojnë në brezin e frekuencave 22-22,2 GHz nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme në shërbimin radioastronomik që funksionon në brezin e frekuencave 22,21-22,5 GHz. Dendësia e fluksit të fuqisë totale (pfd) e marrë nga këto stacione në çdo stacion radioastronomie që operon në brezin e frekuencave 22,21-22,5 GHz duhet të jetë në përputhje me kriteret e mbrojtjes të parashikuara në Rekomandimet ITU-R RA.769-2 dhe ITU-R RA.1513-2, përveç rasteve kur është rënë dakord në mënyrë specifike nga administrata(at) e prekura. (WRC-23)

5.531D Përdorimi i shërbimit të lëvizshëm (OR) aeronautik në brezin e frekuencave 22-22,2 GHz jashtë kufijve kombëtarë nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme ose të kërkojë mbrojtje nga shërbimet në vende të tjera që veprojnë në përputhje me Tabelën e Alokimeve të Frekuencave. (WRC-23)

5.531E Alokimi alternativ: në Brunei Darussalam, Iran (Republika Islamike e), Malajzi, Singapor dhe Tajlandë, brezi i frekuencës 22-22,2 GHz është përcaktuar për shërbimin e lëvizshëm, me përjashtim të lëvizshëm aeronautik (R), në bazë parësore. Përdorimi i shërbimit është i kufizuar në aplikimet e jo-

sigurisë brenda kufijve kombëtarë. Përdorimi i shërbimit të lëvizshëm (OR) aeronautik në brezin e frekuencave 22-22,2 GHz nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme ose të kërkojë mbrojtje nga shërbimet në vende të tjera që veprojnë në përputhje me Tabelën e Përcaktimeve të Frekuencave. Për më tepër, stacionet në shërbimin e lëvizshëm aeronautik (OR) që operojnë në brezin e frekuencave 22-22,2 GHz nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme në shërbimin radioastronomik që operon në brezin e frekuencave 22,21-22,5 GHz në vende të tjera në përputhje me Tabelën e Përcaktimeve të Frekuencave. Dendësia e fluksit të fuqisë totale (pfd) e marrë nga këto stacione në çdo stacion radioastronomie që operon në brezin e frekuencave 22,21-22,5 GHz duhet të jetë në përputhje me kriteret e mbrojtjes të parashikuara në Rekomandimet ITU-R RA.769-2 dhe ITU-R RA.1513-2, përveç rasteve kur është rënë dakord në mënyrë specifike nga administrata(at) e prekura. Për të mbrojtur stacionet e shërbimit satelitor të kërkimit të Tokës (pasiv) që operojnë në brezin e frekuencës 22,21-22,5 GHz, fuqia e padëshiruar ekuivalente e rrezatuar në mënyrë izotropike (e.i.r.p.) e stacioneve që operojnë në shërbimin e lëvizshëm aeronautik (OR) nuk duhet të kalojë -23 dBW në çdo brez 100 MHz në brezin e frekuencës 22,21-22,5 GHz. Stacionet e avionëve në shërbimin e lëvizshëm aeronautik (OR) që operojnë në brezin e frekuencave 22-22,2 GHz janë subjekt i marrëveshjes së marrë sipas Nr. 9.21 në lidhje me shërbimin fiks dhe nuk duhet të shkaktojnë interferencë të dëmshme dhe as të kërkojnë mbrojtje nga shërbimi fiks. Vlerat e mëposhtme të pfd do të përdoren si një prag për koordinimin sipas Nr. 9.21: -110 dB(W/(m2 · MHz)) për $0° \leq \theta \leq 12.6°$ 2.86 θ − 146 dB(W/(m2 · MHz)) për $12,6° < \theta \leq 15°$ 0,87 θ − 116 dB(W/(m2 · MHz)) për $15° < \theta \leq 30°$ 0,067 θ − 92 dB(W/(m2 · MHz)) për $30° < \theta \leq 90°$ ku θ është këndi i mbërritjes së valës rënëse mbi rrafshin horizontal, në gradë. Ky kriter duhet të zbatohet në kufirin e territorit të një administrate tjetër për çdo stacion avioni që ndodhet në një lartësi deri në 15 km mbi tokë. Në kryerjen e llogaritjeve, duhet të përdoret versioni më i fundit i Rekomandimit ITU-R P.525. (WRC-23)

5.531F 5.531F Për të mbrojtur stacionet e shërbimit satelitor të kërkimit të Tokës (pasiv) që operojnë në brezin e frekuencës 22,21-22,5 GHz, fuqia e padëshiruar ekuivalente e rrezatuar në mënyrë izotropike (e.i.r.p.) e stacioneve që operojnë në shërbimin e lëvizshëm aeronautik (OR) nuk duhet të kalojë -23 dBW në çdo brez 100 MHz në brezin e frekuencës 22,21-22,5 GHz. (WRC-23)

5.532 Përdorimi i brezit 22.21 – 22.5 GHz nga shërbimet e eksplorimit satelitor të Tokës (pasive) dhe kërkimeve hapësinore (pasive) nuk do të imponojnë detyrime mbi shërbimet fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik.

5.532A Vendndodhja e stacioneve tokësore në shërbimin e kërkimit hapësinor duhet të ruajë një distancë ndarjeje prej se paku 54 km nga kufijtë përkatës të vendeve fqinje për të mbrojtur shërbimet ekzistuese fikse dhe të lëvizshme dhe vendosjen në të ardhmen të këtyre shërbimeve, përveç rasteve kur është rënë dakort ndërmjet administratave përkatëse për një distancë më të shkurter. Nuk zbatohen Nr. 9.17 dhe 9.18. (WRC-12)

5.532AA Alokimi për shërbimin fiks në brezin e frekuencës 24.25-25.25 GHz është identifikuar për përdorim në Rajonin 2 nga HAPS. Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtij brezi frekuencash nga aplikacione të tjera të shërbimit fiks ose nga shërbime të tjera, të cilave ky brez frekuencash u është alokuar në baza primare, dhe nuk përcakton përparësi në Radio Rregulloret. Një përdorim i tillë i alokimit të shërbimit fiks nga HAPS është i kufizuar në

drejtimin HAPS-tokë dhe do të jetë në përputhje me dispozitat e Rezolutës 166 (Rev.WRC-23). (WRC-23)

5.532AB Brezi i frekuencave 24.25-27.5 GHz është identifikuar për përdorim nga administratat që dëshirojnë të zbatojnë komponentin tokësor të Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Ky identifikim nuk parandalon përdorimin e këtij brezi frekuencash nga çdo aplikim i shërbimeve për të cilat është akokuar dhe nuk vendos përparësi në Radio Rregulloret. Zbatohet Rezoluta 242 (Rev.WRC-23). (WRC-23)

5.532B Përdorimi i brezit 24.65–25.25 GHz në Rajonin 1 dhe brezit 24.65–24.75 GHz në Rajonin 3 nga shërbimi satelitor fiks (tokë–hapësirë) është i kufizuar për stacionet tokësore që përdorin një antenë me diameter minimal prej 4.5 m. (WRC– 12)

5.533 Shërbimet inter–satelitore nuk do të kërkojnë mbrojtje nga interferencat e dëmshme nga stacionet e pajisjeve të zbulimit në sipërfaqen e aeroportit të shërbimit të radionavigacionit.

5.534A Përcaktimi për shërbimin fiks në brezin e frekuencave 25.25-27.5 GHz është identifikuar në Rajonin 2 për përdorim nga Sistemet në Platforma me Lartësi të Madhe (HAPS) në përputhje me dispozitat e Rezolutës 166 (Rev.WRC-23). Një përdorim i tillë i shpërndarjes së shërbimit fiks nga HAPS do të kufizohet në drejtimin tokë-HAPS në brezin e frekuencave 25.25-27.0 GHz dhe drejtimin HAPS-tokë në brezin e frekuencave 27.0-27.5 GHz. Për më tepër, përdorimi i brezit 25.5-27.0 GHz nga HAPS do të kufizohet në lidhjet gateway. Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtij brezi frekuencash nga aplikacione të tjera të shërbimit fiks ose nga shërbime të tjera, për të cilat ky brez është ndarë në një bazë bashkë-parësore dhe nuk vendos përparësi në Radio Rregulloret. (WRC-23)

5.535 Në brezin 24.75 – 25.25 GHz, lidhjet fider të stacioneve të shërbimit radioteleviziv–satelitor do të kenë prioritet ndaj përdorimeve të tjera në shërbimin fiks satelitor (Tokë–hapësirë). Përdorime të tjera të këtij lloji do të mbrojnë dhe nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga rrjetet e lidhjeve fider egzistuese dhe që do të operojnë në të ardhmen në stacione të tilla të shërbimit radioteleviziv satelitor.

5.535A Përdorimi i brezit 29.1 – 29.4 GHz (Tokë–hapësirë) nga shërbimi satelitor fiks është kufizuar në sistemet satelitore gjeostacionare dhe lidhjet fider të sistemeve satelitore jo gjeostacionare në shërbimin e lëvizshëm satelitor. Një përdorim i tillë është objekt për aplikimin e dispozitave të Nr. 9.11A, por nuk është objekt për dispozitat e Nr. 22.2, përveç siç është treguar në Nr. 5.523C dhe Nr. 5.523E ku një përdorim i tillë nuk është objekt i dispozitave të Nr. 9.11A dhe duhet të vazhdojë të jetë objekt i Nenit 9 (përveç Nr.9.11A) dhe procedurës 1, dhe dispozitave të Nr. 22.2 (WRC– 97)

5.536 Përdorimi i brezit 25.25 – 27.5 GHz nga shërbimi inter–satelitor është kufizuar në aplikimete kërkimeve hapësinore dhe eksplorimeve satelitore të tokës, dhe gjithashtu të transmetimit të të dhënave me origjinë nga aktivitetet industriale dhe mjekësore në hapësirë.

5.536A Administratat që kanë në operim stacione tokësore në shërbimin satelitor të eksplorimit të Tokës ose shërbimin e kërkimit hapësinor nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet në shërbimet fikse dhe të lëvizshme që operohen nga administratat e tjera. Përveç kësaj, stacionet tokësore në shërbimin satelitor të

eksplorimit të Tokës ose në shërbimin e kërkimit hapësinor duhet të operojnë duke marrë parasysh versionin më të fundit të Rekomandimit ITU-R SA.1862. Zbatohet Rezoluta 242 (Rev.WRC-23). (WRC-23)

5.536B Në Algjeri, Arabi Saudite, Austri, Bahrein, Belgjikë, Brazil, Kinë, Kore (Republika e), Danimarkë, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Estoni, Finlandë, Hungari, Indi, Iran (Republika Islamike e), Irak, Irlandë, Izrael, Itali, Jordani, Kenia, Kuvajt, Liban, Libi, Lituani, Moldavi, Norvegji, Oman, Ugandë, Pakistan, Filipine, Poloni, Portugali, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Turqi, Republika Popullore Demokratike e Koresë, Sllovaki, Republika Çeke, Rumani, Mbretëria e Bashkuar, Singapor, Slloveni, Somali, Sudan, Suedi, Tanzani, Vietnam dhe Zimbabve, stacionet tokësore që operojnë në shërbimin satelitor të eksplorimit të Tokës në brezin e frekuencave 25.5–27 GHz nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e shërbimeve fiks dhe i lëvizshëm ose të kufizojnë përdorimin dhe vendosjen e stacioneve të shërbimeve fiks dhe i lëvizshëm. Zbatohet Rezoluta 242 (Rev.WRC-23). (WRC-23)

5.536C Në Algjeri, Arabi Saudite, Bahrein, Botsvana, Brazil, Kamerun, Komoros, Kubë, Xhibuti, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Estoni, Finlandë, Iran (Republika Islamike e), Izrael, Jordani, Kenia, Kuvajt, Lituani, Malajzi, Marok, Nigeri, Oman, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Somali, Sudan, Sudani Jugor, Tanzani, Tunizi, Uruguai, Zambia dhe Zimbabve, stacionet tokësore që operojnë në shërbimin e kërkimeve hapësinore në brezin 25.5–27 GHz nuk duhet të kërkojnë mbrojtje nga stacionet e shërbimeve fiks dhe i lëvizshëm ose të kufizojnë përdorimin dhe vendosjen e stacioneve të shërbimeve fiks dhe i lëvizshëm. (WRC– 12)

5.537 Shërbimet hapësinore që përdorin satelitet jo–gjeostacionare operues në shërbimet inter– satelitore në brezin 27 – 27.5 GHz janë përjashtuar nga kërkesat e Nr. 22.2.

5.537A Në Butan, Kamerun, Kinë, Kore (Rep. e), Federata Ruse, Indi, Indonezi, Iran (Republika Islamike e), Irak, Japoni, Kazakistan, Malajzi, Maldive, Mongoli, Myanmar, Uzbekistan, Pakistan, Filipine, Kirgizstan, Republika Popullore Demokratike e Koresë, Sudan, Sri Lanka, Tajlandë dhe Vietnam, përcaktimi për shërbimin fiks në brezin 27.9–28.2 GHz mund të përdoret gjithashtu nga Sistemet në Platforma me lartësi të Madhe (HAPS) brenda territorit të këtyre vendeve. Një përdorim i tillë prej 300 MHz i përcaktimit të shërbimit fiks nga HAPS në vendet e lartpërmendura është më i kufizuar në operacionet e HAPS– në drejtim të tokës dhe nuk duhet të shkaktojë interferencë të dëmshme, as të kërkojë mbrojtje nga llojet e tjera të sistemeve të shërbimit fiks ose të shërbimeve të tjera bashkë–parësore. Për më tepër, zhvillimi i këtyre shërbimeve të tjera nuk duhet të kufizohet nga HAPS. Shiko Rezolutën 145 (Rev.WRC–19). (WRC–19)

5.538 *Përcaktim shtesë*: Brezat 27.500 – 27.501 GHz dhe 29.999 – 30.000 GHz janë gjithashtu të përcaktuar në bazë parësore për shërbimin fiks satelitor (hapësirë–Tokë) për transmetimin e sinjaleve parashikuar për kontrollin e fuqisë up–link. Transmetime të tilla hapësirë–Tokë nuk do të kalojnë një fuqi rrezatimi izotropike ekuivalente (e.i.r.p.) prej +10 dBW në drejtimin e satelitëve fqinjë në orbitën gjeostacionare. (WRC–07)

5.539 Brezi 27.5 – 30 GHz mund të përdoret nga shërbimi fiks satelitor (Tokë–hapësirë) për sigurimin e lidhjeve fider për shërbimin radioteleviziv– satelitor.

5.540 *Përcaktim shtesë*: Brezi 27.501–29.999 GHz është përcaktuar gjithashtu në bazë dytësore për shërbimin fiks satelitor (hapësirë–Tokë) për transmetimet e sinjaleve parashikuar për kontrollin e fuqisë up–link.

5.541 Në brezin 28.5–30 GHz, shërbimi i eksplorimit satelitor të tokës është kufizuar në transferimin e të dhënave përmes stacioneve dhe jo për mbledhjen kryesore të informacioneve në kuptimin e sensorëve aktiv dhe pasiv.

5.541A Lidhjet fider të rrjetave jo–gjeostacionare në shërbimin e lëvizshëm satelitor dhe të rrjetave gjeostacionare në shërbimin fiks satelitor, që operojnë në brezin 29.1–29.5 GHz (Tokë–hapësirë) duhet të përdorin kontrollin adaptiv të fuqisë për drejtimin uplink ose metoda të tjera për kompensimin e shuarjeve, në mënyrë të tillë që transmetimi i stacioneve tokësore të bëhet në nivelin e fuqisë të kërkuar për të arritur cilësinë e dëshiruar të lidhjes, ndërkohë që reduktohen interferencat e ndërsjellta ndërmjet dy rrjeteve. Këto metoda duhet të aplikohen në rrjetat për të cilët konsiderohet që informacioni i koordinimit i Shtojcës 4 është marrë nga Byroja pas 17 Maj 1996 dhe deri në momentin kur ato të jenë ndryshuar nga një konferencë e ardhshme kompetente për radiokomunikacionet. Administratat që kanë paraqitur informacionin për koordinim të Shtojce 4 para kësaj date inkurajohen të përdorin këto teknika sa më gjatë. (WRC– 2000)

5.542 *Përcaktim shtesë*: Në Algjeri, Arabi Saudite, Bahrein, Brunei Darussalam, Kamerun, Kinë, Rep Demoktrate e Kongos, Xhibut, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Eritrea, Etiopi, Guine, Indi, Iran (Republika Islamike e), Irak, Japoni, Jordani, Kuvajt, Liban, Malajzi, Mali, Marok, Mauritania, Nepal, Oman, Pakistan, Palestinë*, Filipine, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Republikën Popullore Demoktratike të Koresë, Somali, Sudan, Sudani Jugor, Sri Lanka dhe Çad, brezi i frekeuncave 29.5–31 GHz është i përcaktuar gjithashtu për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm për përdorim dytësor. Duhen përdorur limitet e fuqisë të specifikuar në Nr.21.3 dhe 21.5. (WRC–23).

* Në bazë të Rezolutës 99 (Rev. Dubai, 2018) të Konferencës Fuqiplotë dhe duke marrë parasysh Marrëveshjen e Përkohshme Izraelito-Palestineze të 28 shtatorit 1995.

5.543 Brezi 29.95 – 30 GHz mund të jetë përdorur në bazë dytësore për lidhjet hapësirë–hapësirë në shërbimet e eksplorimit satelitor të tokës për telemetri, gjurmim, dhe qëllime kontrolli.

5.543A Në Butan, Kamerun, Kore (Rep. e), Federatën Ruse, Indi, Indonezi, Iran (Republika Islamike e), Irak, Japoni, Kazakistan, Malajzi, Maldive, Mongoli, Myanmar, Uzbekistan, Pakistan, Filipine, Kigizstan, Republika Popullore Demokratike të Koresë, Sudan, Sri Lanka, Tailandë dhe Vietnam, përcaktimi i shërbimit fiks në brezin e frekuencave 31–31.3 GHz mund të përdoret gjithashtu nga sistemet që përdorin Stacionet me Platformë me lartësi të Lartë (HAPS) në drejtimin tokë–HAPS. Përdorimi i brezit të frekuencave 31–31.3 GHz nga sistemet që përdorin HAPS është i kufizuar në territoret e vendeve të lartpermendura dhe nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme, as të kerkojnë mbrojtje nga lloje të tjera sistemesh të shërbimit fiks, sisteme në shërbimin e lëvizshëm dhe sisteme që operojnë nën Nr. 5.545. Për më tepër, zhvillimi i këtyre shërbimeve nuk duhet të detyrohet nga HAPS. Sistemet që përdorin HAPS në brezin e frekuencave 31–31.3 GHz nuk duhet ti shkaktojnë interferenca të dëmshme shërbimit të radio astronomisë që ka përcaktim parësor në brezin 31.3–31.8 GHz, duke marrë parasysh kriterin e mbrojtjes siç

është dhënë në versionin e fundit të Rekomandimit ITU–R RA.769. Në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e shërbimeve satelitore pasive, niveli i densitetit të fuqisë së padëshiruar në një antenë të stacionit tokësor HAPS në brezin e frekuencave 31.3–31.8 GHz duhet të jetë e kufizuar në –106 dB(W/MHz) në kushte të qiellit të pastër, dhe mund të ngrihet deri në –100 dB(W/MHz) nën kushte me shi për të zbutur shuarjen për shkak të shiut, duke siguruar që ndikimi efektiv mbi satelitet pasiv nuk tejkalon ndikimin nën kushte të qiellit të pastër. Shiko Rezolutën 145 (Rev.WRC–12). (WRC–15)

5.543B Alokimi për shërbimin fiks në brezin e frekuencës 31-31.3 GHz është identifikuar për përdorim në mbarë botën nga HAPS. Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtij brezi frekuencash nga aplikacione të tjera të shërbimit fiks ose nga shërbime të tjera, të cilave u është alokuar në baza bashkë-primare, dhe nuk përcakton përparësi në Radio Rregulloret. Një përdorim i tillë i alokimit të shërbimit fiks nga HAPS do të jetë në përputhje me dispozitat e Rezolutës 167 (Rev.WRC-23). (WRC-23)

5.544 Në brezin 31–31.3 GHz kufijtë e fuqisë së densitetit të fluksit të specifikuar në nenin 21, Tabela 21–4 duhet të aplikohen në shërbimin e kërkimeve hapësinore.

5.545 Kategori të ndryshme shërbimi: Në Armeni, Gjeorgji, Kirgizstan, Taxhikistan dhe Turkmenistan, përcaktimi i brezit 31–31.3 GHz për shërbimin e kërkimeve hapësinore është në një bazë parësore (shih Nr. 5.33). (WRC–12)

5.546 *Kategori të ndryshme shërbimi*: Në Arabi Saudite, Armeni, Azerbajxhan, Bahrein, Bjellorusi, Xhibut, Egjypt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Spanjë, Estoni, Federata Ruse, Gjeorgji, Hungari, Iran (Republika Islamike e), Izrael, Jordani, Liban, Moldavi, Mongoli, Oman, Uzbekistan, Poloni, Republika Arabe e Sirisë, Turqi, Kirgizstan, Rumani, Mbretëria e Bashkuar, Somali, Afrika Jugut, Taxhikistan dhe Turkmenistan, përcaktimi i brezit të frekeuncave 31.5–31.8 GHz për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm, përveç shërbimit të lëvizshëm aeronautik, është në bazë parësore (shih Nr. 5.33). (WRC–23)

5.547 Brezat e frekeuncave 31.8–33.4 GHz, 37–40 GHz, 40.5–43.5 GHz, 51.4–52.6 GHz, 55.78–59 GHz dhe 64–66 GHz janë të disponueshme për aplikime të densitetit të lartë në shërbimin fiks .Administratat duhet ta marrin parasysh këtë kur të konsiderojnë dispozitat rregullatore në lidhje me këto breza. Për shkak të shpërndarjes potenciale të aplikacioneve me densitet të lartë në shërbimin fiks satelitor në brezat e frekuencave 39.5–40 GHz dhe 40.5–42 GHz (shiko Nr. 5.516B), administratat duhet të kenë më tepër parasysh detyrimet e mundshme të aplikacioneve me densitet të lartë në shërbimin fiks, sipas rastit. (WRC– 23)

5.547A Administratat duhet të ndërmarrin masa praktike për të minimizuar interferencat e dëmshme ndërmjet stacioneve në shërbimin fiks dhe stacioneve ajrore në shërbimin e radionavigacionit në brezin 31.8–33.4 GHz duke marrë parasysh nevojat operative të sistemeve radare ajrore. (WRC– 2000)

5.548 Në caktimin e sistemeve për shërbimet inter–satelitore në brezin e frekeuncave 32.3–33 GHz, për shërbimet e radionavigacionit në brezin 32 – 33 GHz, dhe per shërbimin e kërkimeve hapësinore (hapësirë e thellë) në brezin e frekeuncave 31.8 – 32.3 GHz, administratat duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të penguar interferencat e dëmshme ndërmjet këtyre shërbimeve, duke mbajtur

	në mendje aspektet e shpëtimit të shërbimit të radionavigacionit (shih Rekomandimin 707(Rev.WRC– 23)). (WRC-23)
5.549	*Përcaktim shtesë*: Në Arabinë Saudite, Bahrein, Bangladesh, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Gabon, Indonezi, Iran (Republika Islamike e), Irak, Izrael, Jordani, Kuvajt, Liban, Libi, Malajzi, Mali, Marok, Mauritania, Nepal, Nigeri, Oman, Pakistan, Filipine, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Rep Demokratike e Kongos, Singapor, Somali, Sudan, Sudani Jugor, Sri Lanka, Togo, Tunizi dhe Jemen, brezi 33.4–36 GHz është përcaktuar gjithashtu për shërbimet fiks dhe i lëvizshëm, për përdorim parësor. (WRC–12)
5.549A	Në brezin 35.5–36.0 GHz, fuqia e mesme e densitetit të fluksit në sipërfaqen e Tokës, i gjeneruar nga çdo sensor i transportuar në hapësirë, në shërbimin e eksplorimit satelitor të Tokës (aktiv) ose shërbimit të kërkimit hapësinor (aktiv), për çdo kënd më të madh se 0.8o nga qendra e rrezes (beam) nuk duhet të tejkalojë –73.3 dB (W/m2) në këtë brez. (WRC– 03)
5.550	Kategori të ndryshme shërbimi: Në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Federaten Ruse, Gjeorgji, Kirgizstan, Taxhikistan dhe Turkmenistan, brezi 34.7–35.2 GHz është përcaktuar në një bazë parësore për shërbimin e kërkimeve hapësinore (shih Nr. 5.33). (WRC– 12)
5.550A	Për ndarjen e brezit 36–37 GHz ndërmjet shërbimit të Eksplorimit Satelitor të Tokës (pasiv) dhe shërbimeve fikse dhe të lëvizshme, do të zbatohet Rezoluta 752 (WRC–07).
5.550B	Brezi i frekuencave 37-43.5 GHz, ose një pjesë e tyre, është identifikuar për përdorim nga administratat që dëshirojnë të implementojnë komponentin tokësor të Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Ky identifikim nuk përjashton përdorimin e këtij brezi frekuencash nga çdo aplikim i shërbimeve për të cilat është shpërndarë dhe nuk krijon përparësi në Radio Rregulloret. Për shkak të shpërndarjes së mundshme të stacioneve tokësore të FSS brenda brezit të frekuencave 37.5-42.5 GHz dhe aplikacioneve me densitet të lartë në shërbimin fiks satelitor në brezin e frekuencave 39.5-40 GHz në Rajonin 1 , 40-40.5 GHz në të gjitha Rajonet dhe 40.5-42 GHz në Rajonin 2 (shiko Nr. 5.516B), administratat duhet të marrin parasysh më tej kufizimet e mundshme ndaj IMT në këto breza frekeuncash, sipas rastit. Aplikohet Rezoluta 243 (Rev.WRC-23). (WRC-23)
5.550C	Përdorimi i brezave 37.5-39.5 GHz (hapësirë-Tokë), 39.5-42.5 GHz (hapësirë-Tokë), 47.2-50.2 GHz (Tokë-hapësirë) dhe 50.4-51.4 GHz (Tokë-hapësirë) nga një sistem satelitor jo-geostationary në shërbimin satelitor fiks është subjekt i zbatimit të dispozitave të Nr.9.12 për koordinim me sistemet e tjerë satelitorë jo-gjeostacionarë në shërbimin satelitor fiks por jo me sisteme satelitore jo-gjeostacionare në shërbime të tjera. Do të aplikohet gjithashtu Rezoluta 770 (WRC-19), dhe Nr. 22.2 do të vazhdojë të aplikohet. (WRC-19)
5.550CA	Sistemet satelitore jo gjeostacionare në shërbimin satelitor fiks që operojnë me një lartësi apogje mbi 407 km dhe nën 2 000 km në brezin e frekuencës 37.5-38 GHz nuk duhet të kalojnë një emetim të padëshiruar e.i.r.p. dendësie prej -21 dB(W/100 MHz) për stacion hapësinor për kënde më të mëdha se 65,0° nga pika më e ulët në raport me stacionin hapësinor në shërbimin fiks satelitor në brezin e frekuencës 36-37 GHz për të mbrojtur shërbimin satelitor të eksplorimit të Tokës (pasiv) që veprojnë në brezin e fundit të frekuencës. (WRC-23)

5.550D Alokimi për shërbimin fiks në brezin e frekuencave 38-39.5 GHz është identifikuar për përdorim në të gjithë botën nga administratat që dëshirojnë të zbatojnë Sisteme në Platforma me Lartësi të Madhe (HAPS). Në drejtimin HAPS-tokë, stacioni tokësor HAPS nuk kërkon mbrojtje nga stacionet në shërbimet satelitore fikse, të lëvizshme dhe fikse; dhe Nr. 5.43A nuk aplikohet. Ky identifikim nuk parandalon përdorimin e këtij brezi frekuencash nga aplikime të tjera të shërbimeve fikse ose të shërbimeve të tjera për të cilat ky brez është alokuar në bazë bashkë-parësore dhe nuk krijon përparësi në Radio Rregulloret. Për më tepër, zhvillimi i shërbimeve fikse satelitore, fikse dhe të lëvizshme nuk do të kufizohen padrejtësisht nga HAPS. Një përdorim i tillë i alokimit të shërbimit fiks nga HAPS do të jetë në përputhje me dispozitat e Rezolutës 168 (Rev.WRC-23). (WRC-23)

5.550E Përdorimi i brezave 39.5-40 GHz dhe 40-40.5 GHz nga sistemet satelitore jo-gjeostacionare në shërbimin satelitor të lëvizshëm (hapësirë-Tokë) dhe nga sistemet satelitore jo-gjeostacionare në shërbimin satelitor fiks (hapësirë-Tokë) është subjekt i zbatimit të dispozitave të Nr. 9.12 për koordinim me sistemet e tjerë satelitorë jo-gjeostacionarë në shërbimet satelitore fikse dhe të lëvizshme fikse, por jo me sisteme satelitore jo-gjeostacionare në shërbime të tjera. Nr. 22.2 do të vazhdojë të aplikojë për sisteme satelitore jo-gjeostacionare. (WRC-19)

5.551H (M) Fuqia ekuivalente e densitetit të fluksit (epdf) i prodhuar në brezin e frekuencave 42.5–43.5 GHz nga të gjitha stacionet hapësinore në çdo sistem satelitor jo gjeostacionar në shërbimin fiks satelitor (hapësirë –Tokë), ose në shërbimin radioteleviziv satelitor (hapësirë–Tokë) që operojnë në brezin e frekuencave 42–42.5 GHz, nuk duhet të tejkalojnë vlerat e mëposhtme në vendndodhjen e (site) çdo stacioni të radioastronomisë për më shumë se 2% të kohës:
–230 dB (W/m2) në 1GHz dhe –246 dB (W/m2) në çdo 500 kHz të brezit të frekuencave 42.5–43.5GHz në vendin (site) e çdo stacioni të radio astronomisë i regjistruar si teleskop me parabolë të vetme; dhe
–209 dB (W/m2) në çdo 500 kHz të brezit 42.5–43.5 GHz në vendodhjen (site) e stacionit të radioastronomisë i regjistruar si stacion interferometrie me linjë fundore shumë të gjatë. Këto vlera të (epdf) duhet të vlerësohen duke përdorur metodologjinë e dhënë në Rekomandimin ITU–R S1586–1 dhe modeli i antenës referencë dhe maksimumi i fitimit të një antene në shërbimin e radio astronomisë të dhëna në Rekomandimin ITU–R RA.1631–0 dhe duhet të aplikohet në të gjithë hapësirën qiellore dhe për kënde ngritjeje më të mëdhenj se këndi minimum i operimit Θmin të radioteleskopit (për të cilin një vlerë e paracaktuar (standarte) prej 5o duhet marrë në mungesë të informacionit të njoftuar).
Këto vlera duhet të aplikohen në çdo stacion radioastronomie që:
– ka qënë në operim para 5 Korrikut 2003 dhe i është njoftuar Byrosë para 4 Janarit 2004; ose
– është njoftuar para datës së marrjes të informacionit të plotë sipas Shtojcës 4 për koordinim ose njoftim, sipas rastit, për stacionet hapësinore për të cilat kufijtë aplikohen.
Stacione të tjera radio astronomie të njoftuara pas këtyre datave mund të kërkojnë marrëveshje me administratat që kanë autorizuar stacionet hapësinore. Në Rajonin 2, Rezoluta 743 (WRC–03) duhet të aplikohet. Limitet në këtë shënim mund të tejkalohen në vendndodhjet e stacionit të radio astronomisë të çdo vëndi për të cilët administratat kanë rënë dakord.
(WRC–15)

5.551I Fuqia e densitetit të fluksit në brezin 42.5–43.5 GHz i prodhuar nga çdo stacion hapësinor gjeostacionar në shërbimin fiks satelitor (hapësirë–Tokë), ose shërbimi radioteleviziv satelitor (hapësirë–Tokë) që operon në brezin 42–42.5

GHz, nuk duhet të kalojë vlerat e mëposhtme në vëndndodhjen e çdo stacioni radioastronomie:
–137 dB (W/m2) në 1 GHz dhe –153 dB (W/m2) në çdo 500 kHz të brezit 42.5–43.5 GHz në vëndin (site) e çdo stacioni të radio astronomisë i regjistruar si teleskop me parabolë të vetme; dhe
–116 dB (W/m2) në çdo 500 kHz të brezit 42.5–43.5 GHz në vendndodhjen (site) e stacionit të radioastronomisë i regjistruar si stacion interferometrie me linjë fundore shumë të gjatë. Këto vlera duhet të aplikohen në çdo stacion radioastronomie që:
– ka qënë në operim para 5 Korrikut 2003 dhe i është njoftuar Byrosë para 4 Janarit 2004; ose
– është njoftuar para datës së marrjes të informacionit të plotë sipas Shtojcës 4 për koordinim ose njoftimin, sipas rastit, për stacionet hapësinore për të cilat kufijtë aplikohen.
Stacione të tjera radio astronomie të njoftuara pas këtyre datave mund të kërkojnë marrëveshje me administratat që kanë autorizuar stacionet hapësinore. Në Rajonin 2, Rezoluta 743 (WRC–03) duhet të aplikohet. Limitet në këtë shënim mund të tejkalohen në vendndodhjet e stacionit të radio astronomisë të çdo vëndi për të cilët administratat kanë rënë dakord.
(WRC–03)

5.552 Përcaktimi i spektrit për shërbimin fiks satelitor në brezat 42.5 – 43.5 GHz dhe 47.2 – 50.2 GHz për transmetimet Tokë–hapësirë është më i madh se ai në brezin 37.5 –39.5 GHz për transmetimin hapësirë–Tokë me qëllim që të përshtaten lidhjet fider për shërbimin radioteleviziv satelitor. Administratat janë të detyruara të marrin të gjitha hapat e nevojshme për të rezervuar brezin 47.2 – 49.2 GHz për lidhjet fider për shërbimin radioteleviziv satelitor që operojnë në brezin 40.5 – 42.5 GHz.

5.552A Përcaktimi në shërbimin fiks në brezat 47.2–47.5 GHz dhe 47.9–48.2 GHz është përcaktuar për përdorim nga Sisteme në Platforma me Lartësi të Madhe (HAPS). Ky përcaktim nuk parandalon përdorimin e këtij brezi frekuencash nga çdo aplikim i shërbimeve për të cilat është përcaktuar në bazë bashkë-parësore dhe nuk vendos përparësi në radio Rregulloret.Përdorimi i brezave 47.2–47.5 GHz dhe 47.9–48.2 GHz nga HAPS është objekt i përcaktimeve të Rezolutës 122 (Rev.WRC– 19). (WRC-19)

5.553 Në brezat 43.5–47 GHz dhe 66–71 GHz, mund të operojnë stacionet në shërbimin e lëvizshëm tokësor, me kusht që të mos shkaktojnë interferenca të dëmshme tek shërbimet e radiokomunikacionit hapësinor, për të cilat janë caktuar këto breza (shih Nr. 5.43).(WRC–2000)

5.553A Në Algjeri, Angolë, Bahrein, Bjellorusi, Benin, Botsvana, Brazil, Burkina Faso, Kepi I Gjelbërt, Kore (Rep. e), Bregu të Fildishtë, Kroaci, Xhibut, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Estoni, Esuatini, Gabon, Gambia, Gana, Greqi, Guinea, Guinea-Bissau, Hungaria, Irani (Republika Islamike e), Irak, Jordani, Kuvajt, Lesoto, Letoni, Liberi, Lituani, Madagaskar, Maliui, Mali, Marok, Mauritius, Mauritani, Mozambik, Namibi, Niger, Nigeri, Oman, Katar, Senegal, Sejshel, Sierra Leone, Slloveni, Somali, Sudan, Afrika e Jugut, Suedi, Tanzani, Togo, Tunizi, Zambia dhe Zimbabve, brezi i frekeuncave 45.5-47 GHz është identifikuar për përdorim nga administratat që dëshirojnë të zbatojnë komponentin tokësor të Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT), duke marrë parasysh Nr. 5.553. Në lidhje me shërbimin e lëvizshëm aeronautik dhe radionavigacionit, përdorimi i këtij brezi frekuencash për zbatimin e IMT është subjekt i marrëveshjes Nr. 9.21 me administratat përkatëse dhe nuk do të shkaktojnë interferenca të dëmshme, ose të kërkojnë mbrojtje nga

këto shërbime. Ky identifikim nuk parandalon përdorimin e këtij brezi frekuencash nga ndonjë aplikim i shërbimeve të ciliëve i është alokuar dhe nuk vendos përparësi në Radio Rregulloret. Aplikohet Rezoluta 244 (Rev.WRC-23). (WRC-23)

5.553B Në Rajonin 2 dhe Algjeri, Angolë, Arabi Saudite, Australi, Bahrein, Benin, Botsvana,Burkina Faso, Burundi, Kamerun, Rep. e Afrikës Qendrore, Komoros, Kongo (Rep. e), Korea (Rep. e), Bregu i Fildishtë, Xhibuti, Egjipt, Emiratet e Bashkuara Arabe, Esuatini, Etiopia, Gabon, Gambia, Gana, Guniea,Guniea-Bissau, Guinea Ekuatoriale, India, Irani (Reppublika islamike e), Iraku, Japonia, Jordania, Kenia, Kuvajti, Lesotho, Liberia, Libia, Lituania, Madagaskar, Majalzi, Malaui, Mali, Marok, Mauritius, Maurituani, Mozambik, Namibi, Niger, Nigeri, Oman, Ugandë, Katar, Republika Arabe e Sirisë, Rep. Dem. E Kongos, Ruanda, Sao Tome dhe Principe, Senegal, Sejshel, Sierra Leone, Singapor, Slloveni, Somali, Sudan, Sudani Jugor, Afrika e Jugut, Suedi, Tanzani, Çad, Togo, Tunizi, Zambia dhe Zimbabve, brezi i frekeuncave 47.2-48.2 GHz është identifikuar për përdorim nga administratat që dëshirojnë të implementojnë Telekomunikacionin e Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Ky identifikim nuk parandalon përdorimin e këtij brezi frekeuncash nga çdo aplikim i shërbimeve për të cilat është alokuar, dhe nuk përcakton ndonjë përparësi në Radio Rregulloret. Aplikohet Rezoluta 243 (Rev.WRC-23). (WRC-23)

5.554 Në brezat 43.5–47 GHz, 66–71 GHz, 95–100 GHz, 123–130 GHz, 191.8 – 200 GHz dhe 252–265 GHz, autorizohen gjithashtu lidhjet satelitore, që lidhin stacione tokësore në pika fikse të specifikuara, kur ato përdoren në kombinim me shërbimin e lëvizshëm satelitor ose me shërbimin e radionavigacionit satelitor.

5.554A Përdorimi i brezave 47.5–47.9 GHz, 48.2–48.54 GHz dhe 49.44–50.2 GHz nga shërbimi satelitor fiks (hapësirë –Tokë) është i kufizuar për satelitet gjeostacionare. (WRC– 03)

5.555 *Përcaktim shtesë:* Brezi 48.94–49.04 GHz është përcaktuar gjithashtu në bazë parësore për shërbimin e radioastronomisë. (WRC–2000)

5.555B Fuqia e densitetit të fluksit në brezin 48.94–49.04 GHz i prodhuar nga çdo stacion hapësinor gjeostacionar në shërbimin satelitor fiks (hapësirë–Tokë) që operon në brezat 48.2–48.54 GHz dhe 49.44–50.2 GHz nuk duhet të tejkalojë – 151.8 dB (W/m2) në çdo brez 500 kHz në vendndodhjen (site) e çdo stacioni të radioastronomisë. (WRC– 03)

5.555C Përdorimi i brezit 51.4-52.4 GHz nga shërbimi satelitor fiks (Tokë-hapësirë) është i kufizuar në rrjetet satelitore gjeostacionare. Stacionet tokësore do të kufizohen në gateway të stacioneve tokësore me një antenë me diametër minimumi 2.4 metra. (WRC-19)

5.556 Në brezin 51.4–54.25 GHz, 58.2–59 GHz dhe 64–65 GHz, vëzhgimet radioastronomike mund të kryhen në bazë të marrëveshjeve kombëtare. (WRC– 2000)

5.556A Përdorimi i brezave 54.25–56.9 GHz, 57–58.2 GHz dhe 59–59.3 GHz nga shërbimi ndër–satelitor është i kufizuar në satelitet në orbitën satelitore gjeostacionare. Fuqia (single–entry) e densitetit të fluksit në të gjitha lartësitë mbi sipërfaqen e Tokës nga 0 km deri në 1000 km i prodhuar nga një stacion në shërbimin ndër–satelitor, për të gjitha kushtet dhe për të gjitha metodat e

modulimit, nuk duhet të tejkalojë – 147 dB (W/m2 · 100 MHz) për të gjitha këndet e arritjes. (WRC– 97)

5.557A Në brezin 55.78–56.26 GHz, në mënyrë që të mbrohen stacionet në shërbimin (pasiv) të eksplorimit satelitor të Tokës, maksimumi i fuqisë së densitetit prodhuar nga transmetuesi tek antena e një stacioni të shërbimit fiks është i kufizuar në –26 dB (W/MHz). (WRC– 2000)

5.558 Në brezat 55.78–58.2 GHz, 59–64 GHz, 66–71 GHz, 122.25–123 GHz, 130–134 GHz, 167–174.8 GHz dhe 191.8–200 GHz, mund të operojnë stacionet në shërbimin e lëvizshëm aeronautik, me kusht që të mos shkaktojnë interferenca në shërbimin ndër–satelitor (shih Nr. 5.43). (WRC– 2000)

5.558A Përdorimi i brezit 56.9–57 GHz nga sistemet ndër–satelitore është i kufizuar në lidhjet ndërmjet satelitëve në orbitat satelitore gjeostacionare dhe në transmetimet nga satelitet gjeostacionarë në orbitat e larta–Tokësore në ato që ndodhen në orbitat e ulëta–Tokësore. Për lidhjet ndërmjet satelitëve në orbitat satelitore gjeostacionare, fuqia (single–entry) e densitetit të fluksit në të gjitha lartësitë mbi sipërfaqen e Tokës nga 0 km deri në 1000 km, për të gjitha kushtet dhe për të gjitha metodat e modulimit, nuk duhet të tejkalojë –147 dB (W/m2 · 100 MHz) për të gjitha këndet e arritjes. (WRC– 97)

5.559 Në brezin 59–64 GHz, mund të operojnë radarët e transportuar në hapësirë në shërbimin e radiovendndodhjes, me kusht që të mos shkaktojnë interferenca të dëmshme ndaj shërbimit ndër–satelitore (shih Nr. 5.43). (WRC– 2000)

5.559AA Brezi i frekuencave 66-71 GHz identifikohet për përdorim nga administratat që dëshirojnë të zbatojnë komponentin tokësor të Telekomunikacionit të Lëvizshëm Ndërkombëtar (IMT). Ky identifikim nuk parandalon përdorimin e këtij brezi frekuencash nga çdo aplikim i shërbimeve për të cilat është alokuar ky brez frekuencash dhe nuk vendos përparësi në Radio Rregulloret. Aplikohet Rezoluta 241 (Rev.WRC-23). (WRC-23)

5.559B Përdorimi i brezit të frekuencave 77.5–78 GHz nga shërbimi i radiopërcaktimit duhet të kufizohet në radarët me rreze të shkurtër veprimi për aplikimet me bazë tokësore, duke përfshirë radarët e automjeteve. Karakteristikat teknike të këtyre radarëve janë dhënë në versionin më të fundit të Rekomandimin ITU–R M.2057. Dispozitat e Nr 4.10 nuk zbatohen. (WRC–15)

5.560 Në brezin 78–79 GHz radarët e lokalizuar në stacionet hapësinore mund të operojnë në bazë parësore në shërbimin e eksplorimit satelitor të tokës dhe në shërbimin e kërkimeve hapësinore.

5.561 Në brezin 74–76 GHz, stacionet në shërbimet fiks, i lëvizshëm dhe radioteleviziv nuk duhet të shkaktojnë interferenca të dëmshme në stacionet e shërbimit fiks satelitor ose në stacione të shërbimit satelitor radioteleviziv që operojnë në përputhje me vendimet e konferencës të planifikimit të dhënies së frekuencave për shërbimin radioteleviziv satelitor. (WRC– 2000)

5.561A Brezi 81–81.5 GHz është gjithashtu i përcaktuar për shërbimet amatore dhe amatore– satelitore në bazë dytësore. (WRC– 2000)

5.562 Përdorimi i brezit 94–94.1 GHz nga shërbimet e eksplorimit satelitor (aktiv) të Tokës dhe kërkimit hapësinor (aktiv) është i kufizuar në radarët e hapësirës. (WRC– 97)

5.562A	Në brezat 94–94.1 GHz dhe 130–134 GHz, transmetimet nga stacionet hapësinore të shërbimit të eksplorimit satelitor (aktiv) të Tokës që janë të drejtuara në rrezen (beam) kryesore të një antenë radioastronomie, kanë potencial të dëmtojnë disa marrës të radio astronomisë. Agjensitë hapësinore që operojnë transmetuesit dhe stacionet e radioastronomisë përkatëse duhet të planifikojnë në mënyrë të dyanshme operimet e tyre, për të shmangur këto ngjarje në maksimumin e mundshëm. (WRC– 2000)
5.562B	Në brezat 105–109.5 GHz, 111.8–114.25 GHz, dhe 217–226 GHz, përdorimi i këtij përcaktimi është i kufizuar vetëm për radio astronominë e bazuar në hapësirë. (WRC– 19)
5.562C	Përdorimi i brezit 116–122.25 GHz nga shërbimi ndër–satelitor është i kufizuar për satelitet në orbitën satelitore gjeostacionare. Fuqia (single–entry) e densitetit të fluksit e prodhuar nga një stacion në shërbimin ndër–satelitor, për të gjitha kushtet dhe për të gjitha metodat e modulimit, në të gjitha lartësitë mbi sipërfaqen e Tokës nga 0 km deri në 1000 km dhe në afërsi të pozicioneve orbitale gjeostacionare të zëna nga sensorët pasiv, nuk duhet të tejkalojë –148 dB (W/m2 · 100 MHz) për të gjitha këndet e arritjes. (WRC– 2000)
5.562E	Përcaktimi për shërbimin të eksplorimit satelitor (aktiv) të Tokës është i kufizuar në brezat 133.5–134 GHz. (WRC– 2000)
5.562F	Në brezin 155.5-158.5 GHz, përcaktimi për shërbimet e eksplorimit satelitor (pasiv) të Tokës dhe kërkimit hapësinor (aktiv) do të përfundojnë në 1 Janar 2018 (WRC-2000)
5.562G	Data e hyrjes në fuqi të përcatimit të shërbimeve fikse dhe të lëvizshme në brezin 155.5-158.5 GHz do të jetë 1 Janari 2018. (WRC-2000)
5.562H	Përdorimi i brezave 174.8–182 GHz dhe 185–190 GHz nga shërbimi ndër–satelitor është i kufizuar në satelitet në orbitën satelitore gjeostacionare. Fuqia (single–entry) e densitetit të fluksit prodhuar nga një stacion në shërbimin ndër–satelitor, për të gjitha kushtet dhe për të gjitha metodat e modulimit, në të gjitha lartësitë mbi sipërfaqen e Tokës nga 0 km deri në 1000 km dhe në afërsi të pozicioneve orbitale gjeostacionare të zëna nga sensorët pasiv, nuk duhet të tejkalojë –144 dB (W/m2 · 100 MHz) për të gjitha këndet e arritjes. (WRC– 2000)
5.563A	Në brezat 200–209 GHz, 235–238 GHz, 250–252 GHz dhe 265–275 GHz, perceptimi atmosferik pasiv me bazë–tokë bëhet për të vëzhguar përbërësit atmosferik. (WRC– 2000)
5.563AA	Në brezin e frekuencave 235-238 GHz, stacionet që operojnë në shërbimin satelitor të eksplorimit të Tokës (pasiv) nuk do të kërkojnë mbrojtje nga stacionet në shërbimet fikse dhe të lëvizshme. (WRC-23)
5.563B	Brezi 237.9–238 GHz është gjithashtu i përcaktuar në shërbimin e eksplorimit satelitor (aktiv) të Tokës dhe shërbimit të kërkimit hapësinor (aktiv) vetëm për radarët e reve në në hapësirë. (WRC– 2000)
5.564A	Për funksionimin e aplikacioneve të shërbimit të lëvizshëm fiks dhe tokësor në brezat 275-450 GHz:

Brezat e frekuencave 275-296 GHz, 306-313 GHz, 318-333 GHz dhe 356-450 GHz janë identifikuar për përdorim nga administratat për zbatimin e aplikacioneve të shërbimit të lëvizshëm tokësor dhe fiks, kur nuk ekzistojnë kushte të nevojshme specifike për të mbrojtur aplikacionet (passive) të shërbimit satelitor të eksplorimit të Tokës. Brezat e frekuencave 296-306 GHz, 313-318 GHz dhe 333-356 GHz mund të përdoren vetëm nga aplikacionet e shërbimit fiks dhe të lëvizshëm tokësor, kur kushtet specifike për të siguruar mbrojtjen e aplikacioneve (pasive) të shërbimit satelitor të eksplorimit të Tokës përcaktohen në përputhje me Rezolutën 731 (Rev. WRC-23).

Në ato pjesë të diapazonit të frekuencave 275-450 GHz ku përdoren aplikime të radio astronomisë, kushte specifike (p.sh. distanca minimale e ndarjes dhe/ose kënde të shmangies) mund të jenë të nevojshme për të siguruar mbrojtjen e vendodhjeve të radio astronomis nga aplikacionet e shërbimit të lëvizshëm tokësor dhe/ose fiks, rast pas rasti në përputhje me Rezolutën 731 (Rev.WRC-23).

Përdorimi i brezave të frekuencave të përmendur më lart nga aplikacionet e shërbimit të lëvizshëm tokësor dhe fiks nuk parandalon përdorimin nga, dhe nuk vendos përparësi mbi, çdo aplikacion tjetër të shërbimeve radio në diapazonin 275-450 GHz. (WRC-23)

5.565 Brezat e frekuencave në vijim, në diapazonin 275–1 000 GHz janë identifikuar për përdorim. Brezat e frekuencave në vijim, në diapazonin 275–1 000 GHz janë identifikuar për përdorim nga administratat për aplikime të shërbimit pasiv:
– shërbimi i radio astronomisë: 275–323 GHz, 327–371 GHz, 388–424 GHz, 426–442 GHz, 453–510 GHz, 623–711 GHz, 795–909 GHz dhe 926–945 GHz
– shërbimi satelitor i eksplorimit të Tokës (pasiv) dhe shërbimi i kërkimit hapësinor (pasiv):
275–286 GHz, 296–306 GHz, 313–356 GHz, 361–365 GHz, 369–392 GHz, 397–399 GHz, 409–411 GHz, 416–434 GHz, 439–467 GHz, 477–502 GHz, 523–527 GHz, 538–581 GHz, 611–630 GHz, 634–654 GHz, 657–692 GHz, 713–718 GHz, 729–733 GHz, 750–754 GHz, 771–776 GHz, 823–846 GHz, 850–854 GHz, 857–862 GHz, 866–882 GHz, 905–928 GHz, 951–956 GHz, 968–973 GHz dhe 985–990 GHz.

Përdorimi i diapazonit 275–1000 GHz nga shërbimet pasive nuk përjashton përdorimin e këtij diapazoni nga shërbimet aktive. Administratat që dëshirojnë të bëjnë të mundshme frekuencat në diapazonin 275–1000 GHz për aplikimet në shërbimin aktiv janë të detyruara të marrin të gjitha hapat praktike për të mbrojtur këto shërbime pasive nga interferencat e dëmshme deri në datën kur është vendosur në Tabelën e Përcaktimeve të Frekuencës për diapazonin e frekuencave 275–1000 GHz të lartpërmendura.
Të gjithë frekuencat në diapazonin 1 000–3 000 GHz mund të përdoren nga të dy shërbimet, aktive dhe pasive. (WRC– 12)

SHTOJCA 3

SHËNIMET PËR PËRCAKTIMIN E PËRBASHKËT EUROPIAN

ECA1	Nuk përdoret
ECA2	Nuk përdoret
ECA3	Nuk përdoret
ECA4	Nuk përdoret
ECA5	Në pjesët e këtij brezi stacionet aeronautike dhe stacionet e montuar në avionë përdorin hapësira kanalesh 8.33 kHz për kërkesa komunikimi jo të sigurta.
ECA6	Shërbimi satelitor i lëvizshëm është kufizuar në orbita të ulëta satelitore.
ECA7	Ky brez mund të jetë përdorur gjithashtu nga lidhje fikse me kapacitet të ulët në zonat rurale në një bazë nacionale. Këto lidhje kanë nevojë të koordinohen me shërbimin e lëvizshëm dhe kërkojnë mbrojtje të plotë.
ECA8	Ndonjë përdorim i lidhjeve fikse me kapacitet të ulët duhet të shmanget në zonat ku një përdorim i tillë mund t'i shkaktojë interferenca të dëmshme shërbimit të lëvizshëm detar të radiokomunikimit VHF.
ECA9	Administratat e CEPT mund të autorizojnë të gjithë ose pjesë të brezit 69.9–70.5 MHz për shërbimin amator për përdorim dytësorë.
EAC10	Diapazoni 225–399.9 MHz përcaktohet për vendet e NATO–s dhe është për përdorim ushtarak për shërbimet i lëvizshëm tokësor, i lëvizshëm– satelitor, komunikimet ajër/tokë/ajër dhe komunikimet specifike detare dhe tokësore, duke përfshirë dhe Rajonin 2. Ky brez UHF i NATO–s 225– 400MHz është i vetmi brez i harmonizuar dhe burim i fundëm i disponueshëmdhe i administruar nga NATO në baza të përditshme në dhe për kombetanëtare të NATO–s. Njihet që brezi i frekuencave 380–385 MHz dhe brezi 390–395 MHz janë aktualisht në përdorim të përbashkët me aplikacionet me brez të ngushtë të shrëbimeve PPDR (Mbrojtje publike dhe shpëtim nga fatkeqësitë).
ECA11	Nuk përdoret
ECA12	Zbatimi i shënimit 5 RR mbetet në forcë. Megjithatë administratat janë të detyruara të synojnë harmonizimin më të plotë të mundshëm me Tabelën e Përcaktimeve të ITU dhe Tabelën e Përcaktimit të Përbashkët Europian ECA.
ECA13	Administratat e CEPT–it janë të detyruara të marrin të gjitha masat praktike për të pastruar brezin 645–960 MHz nga caktimet për shërbimin e radionavigacionit aeronautik.
ECA14	Radiolokacioni kufizohet në kërkesat ushtarake për radarët e instaluar në anijet detare.
ECA15	Nuk përdoret

ECA15A	Nuk përdoret
ECA16	Përdorimi i brezit nga shërbimi i lëvizshëm është kufizuar për radio reletë taktike dhe aplikacionet e linqeve Video.
ECA16A	Përdorimi i brezit nga shërbimi i lëvizshëm është kufizuar për radio reletë taktike dhe aplikacionet SAP/SAB.
ECA17	Në nënbrezat, 5755–5765 MHz, 10.36–10.37 GHz, 10.45–10.46 GHz shërbimi amatorvepron në një bazë sekondare. Në caktimet për shërbime të tjera, administratave të CEPT–it u kërkohet, mundësisht të ruajnë këto nënbreza në një mënyrë të tillë që të lehtësojnë marrjen e emëtimeve amatore me fuqi minimal të densitetit të fluksit.
ECA17A	Përdorimi i brezit nga shërbimi i lëvizshëm është kufizuar në linqe Video.
ECA18	Nuk përdoret.
ECA19	Ky brez është përcaktuar për shërbimin e radio astronomisë. Administratat e CEPT janë të detyruara të marrin të gjitha hapat praktikë për të mbrojtur shërbimin e radio astronomisë nga interferencat e dëmshme. Emëtimet nga stacionet hapësinore, në këtë brez dhe në brezat fqinjë, mund të shkaktojnë interferencë të dëmshme serioze.
ECA20	Ky brez i shërbimit fiks është llogaritur për përdorim të përbashkët nga përdorues civile dhe jo civile. Çdo përdorim prioritar në respekt të kanaleve ose nënbrezave preferencial duhet të përcaktohen pas diskutimeve ndërmjet palëve të interesuara.
ECA21	Nuk përdoret
ECA22	Brezi 5 250 – 5 850 MHz përdoret për një gamë zbatimesh radiopërcaktimi që ndodhen Brenda shërbimeve të radionavigacionit dhe radiovendndodhjes. Ky brez do të jetë subjekt për konsiderata të mëtejshme të detajuara.
ECA23	Në nënbrezat 5660–5670 MHz (tokë–hapësirë), 5830–5850 MHz (hapësirë–tokë) dhe 10.45–10.50 GHz, shërbimi shtesë amator–satelit punon në një bazë sekondare dhe pa u shkaktuar interferencë shërbimeve të tjera. Në caktimin e shërbimeve të tjera, administratave të CEPT u kërkohet, kur është e mundur, të mirëmbajnë këto përcaktime në një mënyrë të tillë që të lehtësojnë marrjen e emëtimeve amatore me fuqi minimale të densitet të fluksit.
ECA24	Brezi 8500–10000 MHz përdoret për një gamë aplikimesh radiopërcaktimi që ndodhen brenda shërbimeve të radionavigacionit dhe radiovendndodhjes. Ky brez do të jetë subjekt për konsiderata të mëtejshme të detajuara së bashku me brezin 5250–5850 MHz (shih ECA22).
ECA25	Nuk përdoret
ECA26	Brezi 13.25–14.00 GHz përdoret për një gamë zbatimesh radiopërcaktimi që ndodhen brenda shërbimeve të radionavigacionit dhe radiovendndodhjes. Ky brez do të jetë subjekt për konsiderata të mëtejshme të detajuara.
ECA27	Nuk përdoret

ECA28	Administratat e CEPT–it nuk duhet të përhapin sisteme të reja të shërbimit fiks në brezin 11.7–12.5 GHz (ERC/DEC 00)08).
ECA29	Brezat e frekuencave 890–915/935–960 MHz, 880–890/925–935 MHz, 1710–1785/1805–1880 MHz, 1920–1980 MHz dhe 2110–2170 MHz janë të rezervuara vetëm për përdorim celular të lëvizshëm publik. Shërbime të tjera si shërbimi fiks duhet të lejohen vetëm në brezat e mësipërm ku bashkë–egzistenca me sistemet e lëvizshme publike është e mundur p.sh në zona me popullatë të shpërndarë ose zona rurale ku brezi i frekuencës nuk nevojitet për sistemet e lëvizshme celulare.
ECA30	Administratat kombëtare duhet të konsiderojnë koordinimin për zonat rreth siteve EISCAT, kur përdorin brezin 925–935 MHz për shërbimin elëvizshëm, duke përfshirë planifikimin ndërkombëtar për shërbimet ushtarake.SRD nuk duhet të përdorin këtë brez.
ECA31	Nuk përdoret
ECA32	Brezat 880–915 MHz dhe 925–960 MHz përdoren aktualisht për GSM (gjenerata e 2–të e sistemit të lëvizshëm tokësor) në shumicën e vendeve anëtare të CEPT dhe pritet të përdoren nga IMT, në varësi të kërkesës së tregut dhe skemave të licensimit kombëtar.
ECA33	Nuk përdoret
ECA34	Pjesë të brezave 450–457.5/460–467.5 MHz mund të përdoren gjithashtu për rrjetet publike egzistuese dhe në evolim në bazë kombëtare.
ECA35	Në Europë brezi 75.5–76 GHz është gjithashtu i përcaktuar për shërbimet Amator dhe Amator satelitor.
ECA36	Brezi i frekuencave, i cili është harmonizuar nga NATO dhe vendet anëtare të NATO–s, per perdorim ushtarak siç përcaktohet në Marrëveshjen e Përbashkët të NATO–s për Frekuencat e PërdorurA për Qëllime Civile/Ushtarake (NJFA) 2014. Shënim: Marrëveshjen e Përbashkët të NATO–s për Frekuencat e Përdorur për Qëllime Civile/Ushtarake – Ekstarkt për Zbulime Publike – 14 Shkurt 2017.
ECA37	Në Europë përcaktimi për shërbimin e lëvizshëm është i kufizuar në brezin 3400–3800 MHz.
ECA38	Administratat mund të zgjedhin të lejojnë MFCN për komandën dhe kontrollin dhe linqet payload të UA brenda brezit aktual të MFCN. Administratave u kërkohet të sigurojnë mbrojtje për sistemet dhe shërbimet e tjera ekzistuese në këto breza frekuencash.
ECA39	Administratat duhet të shmangin vendosjen e shërbimeve të lëvizshme me densitet të lartë, përfshirë dhe aksesin fiks pa tela me densitet të lartë në brezin e frekuencave 22.0-23.6 GHz (ECC/DEC/(18)06)

SHTOJCA 4

REKOMANDIME DHE VENDIME TË KONFERENCËS EUROPIANE TË POSTËTELEKOMUNIKACIONEVE (CEPT) ERC/ECC

ECC/DEC/(20)02	Përdorimi i harmonizuar i brezave të çiftuara të frekuencave 874.4-880.0 MHz dhe 919.4-925.0 MHz dhe i brezit të paçiftuar të frekuencës 1990-1910 MHz për RMR
ECC/DEC/(20)01	Mbi përdorimin e harmonizuar të brezit të frekuencës 5945-6425 MHz për Sisteme të Aksesit pa Tela përfshirë Rrjetet e Zonave Lokale Radio (WAS/RLAN)
ECC/DEC(19)04	Përdorimi i harmonizuar i spektrit, qarkullimi i lirë dhe përdorimi i stacioneve tokësore në bordin e avionëve që operojnë me rrjete GSO FSS dhe sisteme NGSO FSS në brezat e frekuencave 12.75-13.25 GHz (Tokë-hapësirë) dhe 10.7-12.75 GHz (hapësirë-Tokë).
ECC/DEC(19)03	Përdorimi i harmonizuar i kanaleve shtojcës 18 të rregulloreve radio (frekuencat transmetuese në brezin e lëvizshëm detar vhf)
ECC/DEC(19)02	Sistemet tokësore të lëvizshme në diapazonet e frekuencave 68-87.5 MHz, 146-174 MHz, 406.1-410 MHz, 410-430 MHz, 440-450 MHz dhe 450-470 MHz.
ECC/DEC/(18)06	Kushtet teknike të harmonizuara për Rrjete të Komunikimeve të Lëvizshme/ Fikse (MFCN) në brezin 24.25-27.5 GHz.
ECC/DEC/(18)05	Përdorimi i harmonizuar, përjashtimi nga licencimi individual dhe qarkullimi i lirë dhe përdorimi i Earth Stations In-Motion (ESIM) që veprojnë me sistemet satelitore NGSO FSS në brezat e frekuencës 10.7-12.75 GHz dhe 14.0-14.5 GHz.
ECC/DEC/(18)04	Përdorimi i harmonizuar, përjashtimi nga licencimi individual dhe qarkullimi i lirë dhe përdorimi i Earth Stations In-Motion (ESIM) që veprojnë me sistemet satelitore GSO FSS në brezat e frekuencës 10.7-12.75 GHz dhe 14.0-14.5 GHz.
ECC/DEC/(17)06	Përdorimi i harmonizuar i brezave të frekuencave 1427-1452 MHzdhe 1492-1518 MHz për Rrjete të Komunikimeve të Lëvizshme/Fikse Supplemental Downlink (MFCN SDL).
ECC/DEC/(17)04	Përdorim i harmonizuar dhe përjashtim nga licensimi individual i stacioneve fikse tokësore që veprojnë me sistemet satelitore NGSO FSS në brezat e frekeuencave 10.7-12.75 GHz dhe 14.0-14.5 GHz.
ECC/DEC/(16)02	Harmonizimi i kushteve teknike dhe brezave frekuencor për implementimin e sistemeve me brez të gjërë për sistemet (BB–PPDR) për mbrojtjen e publikut dhe shpëtimin nga katastrofat natyrore.
ECC/DEC/(16)01	Harmonizimi i brezit të frekuencave 76–77 GHz, karakteristikat teknike, shembuj nga licencimi individual, mbartja e lirë si dhe përdorimi i radarëve për dedektimin e pengesave për përdorimin e rotorcraft–eve.

ECC/DEC/(15)05	Harmonizimi i diapazonit të frekuencave 446.0–446.2 MHz, karakteristikat teknike, shembuj nga licencimi individual, mbartja e lirë si dhe përdorimi i aplikacioneve PMR analoge dhe numerike.
ECC/DEC/(15)04	Përdorimi i harmonizuar, qarkullimit të lirë dhe shembuj të autorizimit individual të stacioneve tokësore dhe stacioneve tokësore detare në platforma të lëvizshme (ESOMPs) që operojnë me sistemet fikse satelitore FSS në orbitën Jo–Gjeostacionare në diapazonin e frekuencës 17.3–20.2GHz, 27.5–29.1GHz dhe 29.5–30.0 GHz.
ECC/DEC/(15)03	Përdorimi i harmonizuar i sistemeve me brez të gjërë të komunikimeve direkte Ajër–Tokë (DA2GC) në brezin e frekuencës 5855–5875 MHz.
ECC/DEC/(15)01	Harmonizimi i kushteve teknike për rrjetet e komunikimeve i lëvizshëm/ fiks (MFCN) në brezin 694–790 MHz, duke përfshirë përdorimin e frekuencës së çiftuar (Frequency Division Duplex 2x30 MHz) si dhe përdorimin opsional të frekuencës së paciftuar (Supplemental Downlink),
ECC/DEC/(14)02	Kushtet rregullatore dhe teknike për përdorimin e harmonizuar të brezit 2300–2400 MHz në rrjetet e komunikimeve i lëvizshëm/ fiks.
ECC/DEC/(13)03	Përdorimi i harmonizuar i brezit të frekuencës 1452–1492 MHz për rrjetet Supplemental Downlink (MFCN SDL) të komunikimeve i lëvizshëm/ fiks.
ECC/DEC/(13)01	Përdorimi i harmonizuar, qarkullimi i lirë dhe përjashtimi nga licenca individuale e stacioneve tokësore mbi platforma të lëvizshme (ESOMPs) brenda brezit të frekuencave 17.3–20.2 GHz dhe 27.5–30.0 GHz.
ECC/DEC/(12)03	Kushtet e harmonizuara për aplikimet UWB në bordin e avionëve.
ECC/DEC/(11)06	Rregullimi i harmonizuar i frekuencave për rrjetet e komunikimeve të lëvizshme/fikse (MFCN) që operojnë në brezat 3400–3600 MHz dhe 3600–3800 MHz.
ECC/DEC/(11)03	Përdorimi i harmonizuar i frekuencave për pajisjet radio në brezin (CB).
ECC/DEC/(11)02	Radarët për kontrollin e nivelit (LPR) që operojnë në brezat e frekuencave 6–8.5 GHz, 24.05–26.5 GHz, 57–64 GHz dhe 75–85GHz.
ECC/DEC/(11)01	Mbrojtja e shërbimit satelitor për eksplorimin e tokës (EESS) në brezin 1400–1427 MHz.
ECC/DEC/(10)02	Përputhshmëria ndërmjet shërbimit fiks satelitor në brezin 30–31 GHz dhe shërbimit satelitor të eksplorimit të tokës (pasive) në brezin 31.3–31.5 GHz.
ECC/DEC/(10)01	Kushtet për ndarjen e brezit 10.6–10.68 GHz ndërmjet shërbimit fiks, shërbimit të lëvizshëm dhe shërbimit satelitor të eksplorimit të tokës (pasive).

ECC/DEC/(09)04	Përjashtimi nga licensimi individual dhe qarkullimi i lirë dhe përdorimi i terminaleve satelitore të lëvizshme vetëm transmetuese që operojnë në brezin 1613.8 – 1626.5 MHz në alokimet e shërbimit të lëvizshëm satelitor.
ECC/DEC/(09)03	Kushtet e harmonizuara për Rrjetet e Komunikimit Mobile / Fiks (MFCN) që operojnë në brezin 790-862 MHz.
ECC/DEC/(09)02	Harmonizimi i brezave 1610–1626.5 MHz dhe 2483.5–2500 MHz për përdorim nga sistemet në Shërbimin e Lëvizshëm Satelitor.
ECC/DEC/(09)01	Përdorimi i harmonizuar të brezit të frekuencave 63–64 GHz për Sistemet e Transportit Inteligjent (ITS).
ECC/DEC/(08)08	Përdorimi i harmonizuar i sistemit GSM në bordin e anijeve në brezat e frekuencave 900 MHz dhe 1800 MHz, si dhe përdorimin e sistemeve UMTS në brezin 2 GHz dhe sistemet LTE në brezat 1800 MHz dhe 2.6 GHz.
ECC/DEC/(08)05	Harmonizimi i brezave të frekuencave për implementimin eaplikimeve radio numerike për Mbrojtjen Publike dhe Lehtësimin e Fatkeqësive (PPDR) në brezat brenda diapazonit 380–470 MHz.
ECC/DEC/(08)01	Përdorimi i harmonizuar i Sistemeve Inteligjente për Transport (ITS) që lidhen me Sigurinë brenda brezit të frekuencave 5875–5925 MHz.
ECC/DEC/(06)13	Projektimi i brezave 880–915 MHz, 925–960 MHz, 1710–1785 MHz dhe 1805–1880 MHz për sistemet tokësore UMTS, LTE dhe WiMAX.
ECC/DEC/(06)10	Rregullimet tranzitore për shërbimin fiks dhe sistemet radio rele taktike në brezat 1980–2010 MHz dhe 2170–2200 MHz me qëllim lehtësimin e futjes së harmonizuar dhe zhvillimit të sistemeve ne shërbimin e lëvizshëm satelitor duke përfshirë dhe shtesat nga një Komponent Tokësor Plotësues.
ECC/DEC/(06)09	Projektimi i brezave 1980–2010 MHz dhe 2170–2200 MHz për përdorim nga sistemet në Shërbimin e Lëvizshëm Satelitor (MSS) duke përfshirë dhe shtesat nga një Komponent Tokësor Plotësues (CGC).
ECC/DEC/(06)07	Përdorimi i harmonizuar i sistemeve GSM dhe LTE në fluturim në brezat e frekuencave 1710–1785 dhe 1805–1880 MHz dhe sistemeve UMTS në fluturim në brezat 1920–1980 MHz dhe 2110–2170 MHz.
ECC/DEC/(06)05	Harmonizimi i brezave të frekuencave për t'u caktuar për operimin Ajër–Tokë–Ajër (AGA) të Sistemeve të Lëvizshme Tokësore Numerike për Shërbimet e Emergjencave.
ECC/DEC/(06)04	Përdorimi i harmonizuar me përjashtim të liçensimit individual dhe qarkullimit të lirë të pajisjeve që përdorin teknologjinë UWB në brezat poshtë 10.6 GHz.
ECC/DEC/(06)03	Përjashtimi nga Licensimi individual i terminaleve satelitore me e.i.r.p të lartë mbi 34 dBW që operojnë brenda brezave të frekuencave

	10.70–12.75 GHz ose 19.70–20.20 GHz hapësirë–Tokë dhe 14.00–14.25 GHz ose 29.50–30.00 GHz Tokë –hapësirë.
ECC/DEC/(06)02	Përjashtimi nga licensimi individual i terminaleve satelitore me e.i.r.p. të ulët (LEST) që operojnë brenda brezave 10.70–12.75 GHz ose19.7–20.2 GHz hapësirë–tokë dhe 14.00–14.25 GHz ose 29.50–30.00 GHz Tokë – Hapësirë.
ECC/DEC/(06)01	Përdorimi i harmonizuar i brezave 1920–1980 MHz dhe 2110–2170 MHz për rrjetet e komunikimeve fikse/të lëvizshme (MFCN) përfshirë sistemet tokësore IMT.
ECC/DEC/(05)11	Qarkullimi i lirë dhe përdorimi i Stacioneve Tokësore të Avionëve (AES) në brezat e frekuencave 14–14.5 GHz (Tokë –Hapësirë), 10.7–11.7GHz (Hapësirë–Tokë) dhe 12.5–12.75 GHz (Hapësirë –Tokë).
ECC/DEC/(05)10	Qarkullimi i lirë dhe përdorimi i Stacioneve Tokësore në bordin e Anijeve që operojnë në rrjetet e shërbimit fiks satelitor në brezat e frekuencave 14–14.5 GHz (Tokë –Hapësirë), 10.7–11.7 GHz (Hapësirë–Tokë) dhe 12.5–12.75 GHz (Hapësirë –Tokë).
ECC/DEC/(05)09	Qarkullimi i lirë dhe përdorimi i Stacioneve Tokësore në bordin e Anijeve që operojnë në rrjetet e shërbimit fiks satelitor në brezat e frekuencave 5925–6425 GHz (Tokë –Hapësirë), dhe 3700 –4200 MHz (Hapësirë–Tokë).
ECC/DEC/(05)08	Disponueshmëria e brezave të frekuencave për aplikacionet me Densitet të Lartë në Shërbimet Fikse Satelitore (hapësirë –Tokë dhe Tokë – hapësirë)
ECC/DEC/(05)05	Përdorimi i harmonizuar i spektrit për sistemet (MFCN) që operojnë brenda brezit 2500–2690 MHz.
ECC/DEC/(05)02	Harmonizimi i Planit të Frekuencave për përdorimin e brezit 169.4–169.8125 MHz.
ECC/DEC/(05)01	Përdorimi i brezit 27.5–29.5 GHz nga shërbimi fiks dhe stacionet Tokësore të pakoordinuara të shërbimit fiks satelitor (Tokë –hapësirë).
ECC/DEC/(04)10	Planifikimi i brezave të frekuencave për t'u caktuar për futjen e përkohshme të Radarëve Automatik me Diapazon të Shkurtër (SRR).
ECC/DEC/(04)09	Planifikimi i brezave 1518–1525 MHz dhe 1670–1675 MHz për Shërbimin e Lëvizshëm Satelitor.
ECC/DEC/(04)08	Përdorimi i harmonizuar i brezave të frekuencave 5 GHz për implementimin e Sistemeve të Aksesit pa Tela, duke përfshirë Rrjetet e Zonave Lokale Radio (WAS/RLANs).
ECC/DEC/(04)03	Planifikimi i brezit të frekuencave 77–81 GHz për përdorim nga Radarët Automativ me Diapazon të Shkurtër.
